vhs
DVV International

Education for Everyone. Worldwide.
Lifelong.

STUDIMI

për të Nxënit dhe Arsimin për të Rritur në Kosovë

DIE
German Institute for Adult Education
Leibniz Centre for Lifelong Learning

© 2021 DVV International
DVV International është Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Deutscher Volkshochschul-Verband eV (DVV), Shoqata Gjermane e Arsimit për të Rritur.

Botuar nga:
DVV International Kosova

Rr. Rexhep Mala nr. 26
10000 Prishtinë
Kosovë
www.dvv-international.ge
www.dvv-international.de

Redaktorë: Ramadan Alija, Maja Avramovska, Elisabeth Reichart, Sarah Widany

Autorë: Teuta Danuza, Andreas Pfanzelt, Hannah Pfanzelt

Grupi punues:
Emir Avdagic, Ramadan Alija, Maja Avramovska, Nana Chabukiani, Ester Hakobyan, Elisabeth Reichart, Biljana Mojsovska Manojlova, Lali Santeladze, Dr. Sarah Widany

Partner i projektit:
Instituti Gjerman për Arsim për të Rritur
Qendra e Lajbnicit për të Nxënit Gjatë Gjithë Jetës
Heinemannstraße 12-14
53175 Bonn
Gjermani
www.die-bonn.de

Ilustrimi i kopertinës: Mariam Samadashvili
Dizajni gra ik: Natia Mzekalashvili
Shtypja: "ORIENT" – Prishtina
ISBN: 978-9951-9077-0-5

Me përkrahjen e: Federal Ministry for Economic Cooperation and Development

Përmbajtja

Parathënie 84

Shkurtesa 88

Përmbledhje ekzekutive 89

Fushëveprimi dhe qasja e hulumtimit 92

I. Koncepti dhe terminologjia - të kuptuarit dhe perceptimi i konceptit të ARr-së 94

Konceptualizimet ndërkombëtare dhe të BE-së për NARr-in, të nxënit gjatë gjithë jetës dhe nxënësit e rritur 94

Të kuptuarit dhe perceptimi i konceptit të NARr-it në Kosovë 98

II. Profili i shtetit

Karakteristikat socio-ekonomike 102

Karakteristikat ekonomike 104

Sistemi politik 106

Sistemi arsimor 107

III. Zhvillimi historik i NARr-it në Kosovë 111

IV. Strukturat drejtuese dhe korniza ligjore 114

Strukturat drejtuese 114

Ligjet 115

Strategjitë dhe politikat 119

V. Financimi

Financimi i arsimit publik 122

Ofruesit privatë dhe sektori i shoqërisë civile 124

Projektet e donatorëve 125

VI. Institucionet dhe ofruesit

Ofruesit e arsimit formal për të rritur 126

Ofruesit e arsimit joformal për të rritur 128

VII. Programet 133

VIII. Pjesëmarrja dhe mospjesëmarrja

Anketa për Arsimin për të Rritur në Kosovë 138

IX. Personeli mësimdhënës dhe profesionalizimi 142

X. Konteksti ndërkombëtar 147

XI. Sfidat dhe zhvillimet në të ardhmen 151

XII. Konkluzionet dhe rekomandimet 153

Referencat 156

Maja Avramovska

Drejtore Rajonale
Kaukazi dhe Evropa Juglindore
DVV International

Dr. Elisabeth Reichart

Bashkëpunëtore Hulumtimi
DIE Bonn

Dr. Sarah Widany

Projektin e mbështeti fillimisht si Udhëheqëse e Departamentit të Sistemit dhe Politikave të DIE-s dhe më pas si profesoreshë zëvendësuese në Universitetin e Potsdamit

Të nderuar lexues,

Në vitin 2019, DVV International dhe DIE Bonn filluan planifikimin dhe zbatimin e një projekti kompleks rajonal, synimi i të cilit ishte të analizohej niveli më i avancuar në fushën e arsimimit dhe edukimit për të rritur (ARr), si dhe pjesëmarrja e të rriturve në arsim dhe trajnim (të nxënit formal, joformal dhe informal). Studimi cilësor u krye në Armeni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Gjeorgji dhe Kosovë, kurse anketa për arsimin për të rritur në Armeni, Gjeorgji dhe Kosovë.

Qëllimi i këtij projekti kompleks ishte kryerja e një analize gjithëpërfshirëse të sektorit të ARr dhe sigurimi i të dhënave që do të përdoreshin në fushën e krijimit të politikave dhe legjislacionit në sektorët e ARr, arsimit dhe trajnimit profesional, punësimit, të nxënit gjatë gjithë jetës dhe fushave të tjera relevante.

Studimet cilësore dhe sasiore dhe raportet e 7 vendeve u realizuan dhe përgatitën nga gjysma e dytë e vitit 2019 deri në qershor 2021. Së pari u fillua me kryerjen e studimit sasior dhe me sigurimin e rezultateve fillestare filloi edhe zbatimi i studimeve cilësore.

Në zhvillimin e strategjisë evropiane për të nxënit gjatë gjithë jetës,rol të rëndësishëm luan monitorimi i progresit përmes anketave të bazuara në të dhëna. Për vendet e përfaqësuara këtu (Armeni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Gjeorgji dhe Kosovë), studimet e paraqitura dhe anketat e ARr janë një

përpjekje thelbësore për të siguruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të nxënit e të rriturve, parakushteve dhe sfidave të tij.

Duke ndjekur nga afër Anketën për Arsimin e të rriturve (ARr - anketë e konsoliduar ndërkombëtare për të nxënit e të rriturve) dhe në koordinim me partnerët bashkëpunues dhe përmes përfshirjes së ekspertëve kombëtarë, u identifikuan specifikat kombëtare dhe nevojat për informata. Kështu, pyetësori standard u përshtat me rrethanat kombëtare dhe u plotësua me pyetje shtesë mbi qëndrimet ndaj të nxënit dhe motivimin, si dhe për nevojat arsimore dhe mbështetëse kundrejt ndryshimeve masive në tregun e punës. Duke reaguar ndaj pandemisë Covid-19 u shtuan me shpejtësi pyetjet mbi qasjen në arsim dhe të nxënit (digjital) gjatë pandemisë. Rezultatet e anketës u përgjigjen një sërë pyetjesh dhe ofrojnë informacion për shkallën dhe cilësinë e të nxënit të të rriturve. Si shpërndahen të nxënit dhe qëndrimet ndaj të nxënit në popullatën e rritur? Cilat grupe janë të përfshira më shumë apo më pak? A përdoren forma të veçanta të të nxënit nga grupe të ndryshme? Çfarë roli luajnë kushtet socio-ekonomike, p.sh. konteksti i punësimit apo vendbanimi në zonat rurale apo urbane?

Raportet cilësore të vendeve ofrojnë informacion shtesë të thelluar mbi kontekstin specifik kombëtar të sistemit arsimor, vendndodhjen dhe promovimin e ARr, të mbledhura në studime cilësore nga një ekip ekspertësh ndërkombëtarë dhe kombëtarë sipas një skeme standarde. Së bashku, të dy raportet përbëjnë një bazë të shkëlqyer për vendet pjesëmarrëse për të vlerësuar situatën aktuale në sfondin e objektivave të politikës arsimore dhe për të zhvilluar strategji politike për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të ARr.

Duke qenë se studimet janë kryer në katër vende sipas një skeme uniforme, krahasimi ofron mundësi shtesë për klasifikimin e situatës përkatëse kombëtare. Duke qenë se analiza dhe studime të tilla gjithëpërfshirëse për sektorin e ARr u kryen për herë të parë në të gjitha vendet e përfshira në këtë projekt, kemi besim se një numër institucionesh dhe organizatash qeveritare dhe joqeveritare në Armeni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Gjeorgji, Kosovë dhe më gjerë, do t'i shfrytëzojnë të dhënat dhe njohuritë nga këto studime.

Shpresojmë që këto raporte të ofrojnë një bazë për diskutime për zhvillimin e mëtejshëm të politikave dhe kështu të kontribuojnë për dizajn të bazuar në dëshmi të sistemit të ARr.

Shfrytëzojmë rastin t'i falënderojmë anëtarët e grupit punues së projektit, autorët dhe institutet hulumtuese për bashkëpunimin profesional dhe të frytshëm dhe rezultatet dhe arritjet e shkëlqyera, të cilat u arritën kryesisht gjatë periudhës sfiduese të pandemisë Covid-19.

Ju urojmë lexim të këndshëm!

Ramadan Alija
DVV International Kosovë
Drejtor ne nivel vendi

Parathënie

Studimi cilësor për arsimimin e të rriturve i kryer në Kosovë është dokument që për herë të parë i analizon aspektet cilësore të sistemit të arsimimit të të rriturve (ARr) në vend. Ky studim cilësor në Kosovë synon përmirësimin e kushteve në politikat, legjislacionin dhe financimin, si dhe profesionalizmin në praktikë dhe teori të ARr, dhe bashkëpunimin në mes të organizatave qeveritare dhe joqeveritare dhe ofruesve të tjerë të ARr në Kosovë.

Kosova përballet me një sërë sfidash në arritjen e arsimimit të përshtatshëm për të gjithë. Në Kosovë, qasja në dije dhe mësimnxënie gjatë gjithë jetës së njerëzve, është një nga sfidat dhe kushtet kryesore dhe më serioze në luftimin e varfërisë, në uljen e shkallës së papunësisë dhe në mundësimin e gjithëpërfshirjes sociale. Varfëria, përjashtimi social, dhe mungesa e shanseve për mundësi më të mira në jetë në arsimim dhe punësim, përbëjnë një kërcënim për stabilitetin e shoqërisë kosovare.

Në Kosovë ende nuk kuptohet vërtetë se shkathtësitë dhe njohuritë e përkrahura përmes programeve të arsimimit të të rriturve janë shumë të rëndësishme për rritjen ekonomike dhe zhvillimin shoqëror të nevojshëm. Arsimimi i të rriturve u siguron njerëzve qasje në dije dhe mësimnxënie tërëjetësore dhe krijon mundësi për ta shijuar zhvillimin kulturor, social dhe ekonomik.

Bazuar në analizën e situatës aktuale të ARr, ky studim cilësor identifikon disa rekomandime të gjera për zhvillimin afatmesëm dhe afatgjatë të ar-

simimit të të rriturve në Kosovë. Më e rëndësishmja do të jetë marrëveshja për kuptim të përbashkët terminologjik dhe konceptual të arsimimit të të rriturve në kuadrin e mësimnxënies tërëjetësore, e cila mund ta lehtësojë zhvillimin e një sistemi të pavarur të arsimimit të të rriturve në të ardhmen. Për më tepër, cilësia e ARr (arsimi profesional, edukimi qytetar, kurset e zhvillimit personal, programet e shkrim-leximit, programet e rehabilitimit, etj.) duhet të forcohen nga qeveria dhe autoritetet vendase përmes ndërgjegjësimit dhe stimulimit financiar. Realizimi i arsimimit të duhur për të rriturit për të gjithë në Kosovë, do të kërkojë si nga qeveria, akterët tjerë relevant, dhe shoqëria qytetare në Kosovë, që t'i koordinojnë përpjekjet e tyre.

Ky studim cilësor është kryer për përkrahjen e partnerëve tanë, në zhvillimin e mëtejshëm të ARr dhe krijimin e mundësive të reja për mësimnxënie, veçanërisht për grupet e pafavorizuara të popullsisë në Kosovë dhe mund të përdoret si bazë e shkëlqyeshme për përpunimin e dokumenteve të reja strategjike. Dokumenti aktual strategjik shtetëror "Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (2017-2021)" skadon në fund të vitit 2021, dhe duhet të rishikohen fushat prioritare dhe të analizohet performanca e institucioneve përkatëse në arritjen e objektivave dhe treguesve të përcaktuar për Strategjinë e re (2022-2026) e cila duhet të sigurojë një rrugë për shtrirjen e sukseseve të arritura dhe hapjen e fushave dhe çështjeve të reja ashtu që arsimi i të rriturve në Kosovë të afrohet me kornizat evropiane dhe rekomandimet ndërkombëtare për arsimin dhe mësimnxënien nga të rriturit (ARr).

Shkurtesa

ARr	Arsimi për të Rritur
NARr	Të Nxënit dhe Arsimi për të Rritur
UA	Udhëzim Administrativ
MTAP	Masat e Tregut Aktiv të Punës
AAAPARr	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur
QK	Qendra e Kompetencës
CONFINTEA	Konferenca Ndërkombëtare për Arsimin për të Rritur
ZHVP	Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
KAAPARr	Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur
DIE	Instituti Gjerman për Arsim për të Rritur
DVVI	Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Deutscher Volkshochschul-Verband e.V. (Shoqata Gjermane e Arsimit për të Rritur)
ECVET	Sistemi i Evropian i Krediteve për Arsim dhe Aftësim Profesional
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
EPALE	Platforma Elektronike për Arsim për të Rritur në Evropë
ETF	Fondacioni Evropian për Trajnime
BE	Bashkimin Evropian
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
AF	Arsimi Formal
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH
GRALE	Raporti Global për të Nxënit dhe Arsimin për të Rritur
TIK	Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit
ISCED	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit
NGjGjJ	Të Nxënit Gjatë Gjithë Jetës
AAK	Agjencia për Akreditim e Kosovës
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
DKA	Drejtoritë Komunale të Arsimit
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NEET	Jo në Arsim, Punësim dhe Aftësim
AJF	Arsim Joformal
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
OJQ	Organizatë joqeveritare
AZZH	Asistenca Zyrtare për Zhvillim
SP	Standardet Profesionale
PIAAC	Programi për Vlerësim Ndërkombëtar të Kompetencave të të Rriturve
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
RAE	Roma, Ashkali, dhe Egjiptas
NjNP	Njohja e të Nxënit Paraprak
OZHQ	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm
UIL	Instituti i UNESCO-s për të Nxënit gjatë gjithë Jetës
UNESCO	Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
VANJFI	Validimi i të Nxënit Joformal dhe Informal
QAP	Qendra e Aftësimit Profesional

Përmbledhje ekzekutive

Ky studim është porositur nga DVV International, Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Deutscher Volkshochschul-Verband e.V. (DVVI) dhe Instituti Gjerman për Arsimin për të Rritur (DIE). Ai ofron një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjes së sektorit të arsimit për të rritur (ARr) në Kosovë dhe identifikon zhvillimet dhe sfidat e kohëve të fundit. Studimi është pjesë e një serie prej katër studimeve të vendeve në rajonin e Evropës Juglindore dhe Kaukazit, ku DVVI ka avokuar në mënyrë aktive për sisteme të forta të arsimit për të rritur që nga fillimi i viteve 2000 (prej vitit 2000 në Bosnjë dhe Hercegovinë, prej vitit 2002 në Gjeorgji dhe Armeni, dhe prej vitit 2005 në Kosovë). Informacioni mbi temat e ndryshme të pasqyruara në këtë studim të vendit - terminologjia për ARr, profili i vendit, zhvillimi historik, korniza ligjore, financimi, ofruesit, programet, pjesëmarrja, profesionalizimi, konteksti ndërkombëtar - u mblodhën online duke përdorur hulumtime nga zyra, të cilat, në një hap të dytë, u verifikuan dhe u krahasuan me njohuritë praktike dhe përvojën në vend të pesë ekspertëve nacionalë përmes intervistave online. Analizat tregojnë progres të jashtëzakonshëm dhe zhvillime dinamike në sektorin e ARr-së të Kosovës, por gjithashtu identifikojnë hendekët që duhet të adresohen në të ardhmen.

Kundrejt sfondit të përkufizimeve të BE-së dhe UNESCO-s, ky studim ndjek një konceptim të gjerë të arsimit për të rritur, i cili konsideron të gjitha format e të nxënit dhe arsimit formal për të rritur (NARr) pas ciklit fillestar të arsimit (siç janë arsimi kompensues dhe arsimi dhe aftësimi profesional (AAP)) dhe të gjitha format e qëllimshme joformale dhe informale të aftësimit të mëtejshëm dhe të vazhdueshëm dhe arsimit dhe të nxënit në komunitet, popullor ose liberal që synojnë zhvillimin profesional ose personal.

Studimi tregon se për dallim nga terminologjia e BE-së, arsimi për të rritur në Kosovë është konceptuar kryesisht si arsim formal dhe joformal, dhe legjislacioni relevant përdor termin “Arsimi dhe aftësimi për të rritur”. Me Ligjin për Arsimin Parauniversitar (2011), Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (2013) dhe Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur (2013), arsimi për të rritur dhe AAP drejtohen nga një infrastrukturë solide ligjore. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPARr), janë institucionet kryesore politike për arsimin për të rritur. Objektivat strategjike të zhvillimit për ARr dhe AAP për vitet 2017-2021 përcaktohen në Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës. Nuk ka ndonjë strategji kombëtare të dedikuar posaçërisht për arsimin për të rritur. Ndërlidhja e ngushtë e ARr-së me arsimin fillestar formal e fsheh të kuptuarit ndërkombëtar se të nxënit gjatë gjithë jetës dhe NARr duhet idealisht

të shkojnë përtej perspektivës ekonomike ose të punësimit dhe gjithashtu të përfshijnë aspekte të të nxënit personal, qytetar dhe shoqëror.

Sipas buxhetit të shtetit të Kosovës të vitit 2019, shpenzimet publike për arsimin përbënin rreth 4.2% të shpenzimeve të përgjithshme të planifikuara të vendit. Nuk ka asnjë vijë specifike për arsimin për të rritur në buxhetin e shtetit. Gjatë viteve të kaluara, buxheti për AAP (i cili përfshin fondet për ARr) është rritur pak. PSAK 2017-2021 ka alokuar 3.8% (6.8 milionë euro) të buxhetit të përgjithshëm të arsimit në fushën prioritare "Arsimi Profesional dhe për të Rritur", shumë e cila kryesisht shpenzohet për pagat e mësimdhënësve dhe më pak për projekte të veçanta zhvillimore të cilat mund të jenë relevante për arsimin për të rritur, si zhvillimi i kurrikulës dhe zhvillimi i mësimdhënësve.

Ngjashëm me situatën në lidhje me legjislacionin, strukturat drejtuese dhe financimin, arsimi për të rritur nuk është i pavarur, por më tepër një komponent ndër-sektorial në sistemin arsimor në Kosovë. Në përgjithësi, ekzistojnë katër lloje të mjediseve institucionale, në të cilat ofrohet arsimi për të rritur në Kosovë: kualifikimi formal i mesëm ose pas atij të mesëm në shkollat e AAP-së, aftësimi profesional, zakonisht i lidhur me punën ose si masë e krijimit të vendeve të punës, i ofruar në qendrat e aftësimin profesional publike ose private, arsimi kompensues për ata që kanë braktisur shkollën në moshë të hershme, dhe të nxënit e të rriturve i llojeve të ndryshme, si aftësimi në gjuhë, TIK, artizanat, kurse arti, muzike ose kulture, të ofruara nga ofruesit privatë ose OJQ-të. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional në vendin e punës nuk njihet ende gjerësisht.

Analiza e hollësishme e pjesëmarrjes dhe mospjesëmarrjes në arsimin për të rritur në kontekstin kosovar është e vështirë për shkak të mungesës së një sistemi gjithëpërfshirës kombëtar të monitorimit dhe vlerësimit. Ka vetëm informata të fragmentuara për personat që marrin pjesë në programet e arsimit për të rritur. Të dhënat janë veç për numrin e pjesëmarrësve dhe, herë pas here, për grupmoshat. Informacioni i saktë rreth nxënësve të rritur, motivimit dhe preferencave të tyre, mund të pritet nga Anketa për Arsimin për të Rritur, e cila aktualisht po kryhet me ekspertizë dhe këshilla shoqëruese nga DVVI dhe Instituti Gjerman për Arsimin për të Rritur (DIE). Rezultatet e para pritet të publikohen në pranverën e vitit 2021.

Edhe pse ka hapësirë për përmirësim, zhvillimi i vazhdueshëm profesional në arsimin profesional ka marrë vëmendje në rritje në PSAK 2017-2021. Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës aktualisht ofron diplomë master për

mësimdhënësit e AAP-së “Master i Pedagogjisë për Shkollat Profesionale”. Nevoja e posaçme për kualifikim andragogjik mes trajnerëve ose mësimdhënësve për të rritur, në krahasim me kualifikimet pedagogjike, nuk është përfshirë në mënyrë të qartë në kornizën strategjike për zhvillimin profesional të mësimdhënësve në Kosovë. Andragogjia nuk ofrohet si një program diplome në universitet. Arsimtarëve për të rritur në Kosovë, me gjithë aftësinë e tyre në temën që japin, shpesh u mungojnë njohuritë metodologjike dhe didaktike dhe mjetet e punës me të rriturit. Deri më tani mungon të kuptuarit e përbashkët i standardeve profesionale dhe etike dhe orientimit shoqëror mes arsimtarëve për të rritur në sistemin formal dhe joformal të ARr-së, të kuptuar që thekson kërkesat e veçanta të profesionit të arsimit për të rritur.

Meqenëse Kosova nuk është anëtare e OKB-së, ajo nuk merr pjesë zyrtarisht në aktivitetet më të rëndësishme ndërkombëtare për NARr, siç janë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht OZHQ 4, dhe konferencat CONFINTEA të UNESCO-s. Sidoqoftë, institucionet e Kosovës janë të përkushtuara ndaj OZHQ-ve dhe përpiqen t’i përmbushin ato si pjesë e përpjekjeve të tyre për integrim evropian. Megjithatë, planet dhe veprimet konkrete për të zbatuar OZHQ-të mbeten përgjithësisht të kufizuara. Kosova është ende në mesin e vendeve me shkallën më të lartë të asistencës monetare ndërkombëtare për kokë. Ndër donatorët më të rëndësishëm ndërkombëtarë për zhvillimin e arsimit për të rritur në Kosovë janë Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim (përmes DVVI dhe GIZ), institucionet e BE-së, si dhe agjencitë për zhvillim të Luksemburgut dhe Austrisë.

Bazuar në analizën e situatës, studimi identifikon disa rekomandime të gjera për zhvillimin afatmesëm dhe afatgjatë të arsimit për të rritur në Kosovë. Më e rëndësishme do të jetë pajtimi për të kuptuarit e përbashkët terminologjik dhe konceptual të arsimit për të rritur në kuadrin e të nxënit gjatë gjithë jetës, çka mund të lehtësojë zhvillimin e një sistemi të pavarur të arsimit për të rritur në të ardhmen. Për më tepër, cilësitë jokomerciale dhe jomonetare të arsimit për të rritur (edukimi qytetar, programet e alfabetizmit, programet e rehabilitimit, kurset e zhvillimit personal) duhet të forcohen nga qeveria dhe autoritetet lokale përmes ngritjes së vetëdijes dhe stimujve financiarë. Në mënyrë që të ketë progres drejt një shoqërie të vërtetë të të nxënit, përpjekja kombëtare duhet të përqendrohet në rritjen e pjesëmarrjes së moshës mesatare dhe më të vjetër, si dhe grupeve të cenueshme në NARr, dhe drejt përdorimit të monitorimit dhe vlerësimit gjithëpërfshirës për zhvillimin e politikave dhe strategjive të bazuara në dëshmi.

Fushëveprimi dhe qasja e hulumtimit

Qëllimi i studimit është të sigurohet një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjes së sektorit të të nxënit dhe arsimit për të rritur në Kosovë dhe të identifikohet zhvillimet dhe sfidat e kohëve të fundit. Baza për strukturën e studimit është tabela gjithëpërfshirëse dhe udhëzuese e përmbajtjes e cila është zhvilluar nga DVVI dhe DIE. Studimi u krye nga një ekip studiuesish që kanë pasur bashkëpunim të ngushtë, të zgjedhur nga DVVI, i përbërë nga dy konsulentë ndërkombëtarë, znj. Hannah Pfanzelt dhe z. Andreas Pfanzelt, dhe një eksperte nacionale, znj. Teuta Danuza.

Qëllimi i studimit është të sigurohet një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjes së sektorit të të nxënit dhe arsimit për të rritur në Kosovë dhe të identifikohet zhvillimet dhe sfidat e kohëve të fundit. Baza për strukturën e studimit është tabela gjithëpërfshirëse dhe udhëzuese e përmbajtjes e cila është zhvilluar nga DVVI dhe DIE. Studimi u krye nga një ekip studiuesish që kanë pasur bashkëpunim të ngushtë, të zgjedhur nga DVVI, i përbërë nga dy konsulentë ndërkombëtarë, znj. Hannah Pfanzelt dhe z. Andreas Pfanzelt, dhe një eksperte nacionale, znj. Teuta Danuza.

Qasja metodologjike kombinoi hulumtimin intensiv me intervistat gjysmë të strukturuara të ekspertëve. Të dhënat dhe informacionet u mblodhën dhe u shtuan hap pas hapi gjatë gjithë procesit të hulumtimit. Në hapin e parë u shqyrtuan sistematikisht të dhënat ekzistuese, dokumentet dhe strategjitë qendrore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe literatura e siguruar nga DVVI dhe konsulentët nacionalë. Burimi kryesor i informacionit ishin të dhënat dytësore, të cilat ishin në dispozicion në nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, siç janë literatura akademike, dokumente analitike, përmbledhje politikash, dokumente vlerësimi, raporte dhe botime nga qeveritë, agjencitë ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile. Kudo që ishin të disponueshme, u morën parasysh edhe të dhënat parësore nga anketat ose bazat e të dhënave ndërkombëtare.

Qëllimi kryesor në fazën e parë të hulumtimit ishte mbledhja e të dhënave relevante sipas kapitujve të paracaktuar, si dhe identifikimi i hendekëve të njohurive dhe të dhënave. Portofolet paraprake të vendit krijuan bazat për mbledhjen e të dhënave cilësore në hapin vijues të hulumtimit. Drejtuar nga rezultatet e hulumtimit, u zhvilluan intervista gjysmë të strukturuara, sy më sy dhe përmes videocall, për t'i verifikuar nga jashtë, plotësuar dhe shtuar gjetjet paraprake të hulumtimit me njohuritë praktike dhe përvojën në vend të ekspertëve nacionalë për NARr. Këto intervista plotësuese ishin një burim vendimtar informacioni në lidhje me gjendjen e NARr-it, pasi informacioni online ishte i pakët. Bazuar në njohuritë dhe përvojën e ekspertëve, si partnerë të intervistimit u përzgjodhën gjithsej pesë ekspertë për NARr nga niveli makro, meso dhe mikro në Kosovë (përfshirë një ekspert nga zyra e vendit e DVVI në Kosovë). Për të gjitha intervistat u zhvilluan pyetësorët me pyetje udhëzuese, që u ndanë paraprakisht me të intervistuarit. Gjatë intervistave, këto pyetje shërbyen si një udhëzues i gjerë tematik. Intervistat kishin një

kohëzgjatje mesatare prej një ore, dhe u zhvilluan nga mesi i nëntorit 2020 deri në janar 2021.

Në një fazë të tretë të procesit të hulumtimit, të dhënat dhe informacionet e mbledhura me anë të hulumtimit dhe intervistave u ndan; n; grupe dhe u kthyen në tekst të shkruar. Komentet nga DIE, DVVI dhe ekspertët nacionalë drejtuan përgatitjen e dokumentit përfundimtar të studimit.

Studimi është strukturuar si më poshtë

Kapitulli I i kushtohet konceptit të NARr-it, duke përshkruar përdorimin dhe interpretimin në Kosovë, dhe lidhjen e tij me terminologjinë e UNESCO-s dhe Bashkimit Evropian (BE). Kapitulli II përshkruan strukturën e vendit me informata në lidhje me situatën aktuale socio-demografike, ekonomike, politike dhe arsimore. Zhvillimi historik i NARr-it, i përshkruar në Kapitullin III, ndihmon në kontekstualizimin e klasifikimit vijues të NARr-it në Kosovë. Ky i fundit rezulton nga një analizë gjithëpërfshirëse të rrethanave të nivelit aktual kombëtar makro (korniza ligjore, politikat dhe financimi), nivelit meso (institucionet, ofruesit, profesionalizimi dhe programet), dhe nivelit mikro (pjesëmarrja) për NARr, të pasqyruara në Kapitujt IV-IX. Përpjekjet ndërkombëtare (aktorët, projektet dhe angazhimet shtetërore) në lidhje me NARr në Kosovë shqyrtohen me kujdes në Kapitullin X. Rezultatet nga të gjithë kapitujt paraardhës informojnë identifikimin e sfidave dhe potencialeve aktuale për të ardhmen në Kapitullin XI. Kapitulli i fundit XII përmbledh vlerësimet, duke i kthyer në rekomandime të sakta për zhvillimin e ardhshëm të NARr-it në Kosovë.

I. Koncepti dhe terminologjia – të kuptuarit dhe perceptimi i konceptit të ARr-së

Konceptualizimet ndërkombëtare dhe të BE-së për NARr-in, të nxënit gjatë gjithë jetës dhe nxënësit e rritur

Shpesh, si arsim konsiderohet vetëm arsimi formal, arsimi i ofruar nga institucionet e arsimit parashkollor, fillor, të mesëm, profesional dhe të lartë për fëmijë, adoleshentë dhe të rritur të rinj. Megjithatë, ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut e ka theksuar disa herë se parimi kryesor i arsimit është universaliteti, duke ua dhënë të drejtën e arsimit të gjithëve, pavarësisht nga mosha.[1] Aspekti i vazhdueshëm i arsimit dhe të të nxënit, i cili është i rrënjosur në parimin e universalitetit në arsim, është i përmbledhur në konceptin e "të nxënit gjatë gjithë jetës" (NGjGjJ). Sipas Institutit të UNESCO-s për të Nxënit Gjatë Gjithë Jetës (UIL), një nga aktorët më të rëndësishëm ndërkombëtarë në këtë fushë, të nxënit gjatë gjithë jetës në thelb "bazohet në integrimin e të nxënit dhe të jetuarit duke mbuluar aktivitetet e të nxënit për njerëz të të gjitha moshave (fëmijë, të rinj, të rritur dhe të moshuar, qofshin vajza apo djem, gra apo burra), në të gjitha kontekstet e jetës (familja, shkolla, komuniteti, vendi i punës dhe kështu me radhë) dhe përmes një shumëllojshmërie modalitetesh (formale, joformale dhe informale) që së bashku plotësojnë një gamë të gjerë të nevojave dhe kërkesave të të nxënit".[2] Paragrafët e mëposhtëm përshkruajnë marrëdhëniet mes koncepteve të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe të nxënit dhe arsimit për të rritur, prezantojnë aktorët kryesorë ndërkombëtarë dhe iniciativat për të përmirësuar qasjen dhe ofrimin e mundësive për NGjGjJ dhe NARr, përmbledhin qëllimet e NARr-it, shpjegojnë modalitete të ndryshme dhe paraqesin kontekste të ndryshme të të nxënit.

Lidhja mes të nxënit gjatë gjithë jetës dhe të nxënit dhe arsimit për të rritur përcaktohet nga vizioni që, brenda universit të të nxënit gjatë gjithë jetës, NARr mbulon të gjitha format e arsimit dhe të nxënit që "synojnë të sigurojnë që të gjithë të rriturit të marrin pjesë në shoqëritë e tyre dhe botën e punës".[3] Kështu, NARr është një përbërës thelbësor i NGjGjJ-së, dhe, kur shikohet në lidhje me periudhën e mbuluar gjatë jetës, me sa duket është forma më substanciale dhe afatgjatë e arsimit. Prandaj, NARr, i përfshirë në konceptin më të gjerë të NGjGjJ-së, adreson një grup të veçantë nxënësish të rritur.

Në përgjithësi, një nxënës i rritur mund të konsiderohet si një "person që ndjek sistematikisht një formë të arsimit për të rritur, i përket një periudhe kronologjike pas adoleshencës dhe vendos vullnetarisht të jetë pjesë e procesit të të nxënit dhe mësimdhënies. Mosha e rritur karakterizohet nga lloje të ndryshme të pjekurisë, nga ajo biologjike, emocionale dhe psiko-sociale, tek ajo profesionale, kulturore dhe politike."[4] Kjo nënkupton që

[1] Nisma për të Drejtën për Arsim (2018). Ueb faqja për të nxënit dhe arsimin për të rritur

[2] UNESCO UIL (2014). Alfabetizmi dhe shkathtësitë bazë si themel për të nxënit gjatë gjithë jetës

[3] UNESCO UIL (2015). Rekomandimi për të Nxënit dhe Arsimin për të Rritur, f. 6

[4] Mavrak (2018). *Programi i Socializimit Ligjor - Manual për Arsimin për të Rritur. PH international: Sarajevë*

nxënësit e rritur janë një grup jashtëzakonisht heterogjen, i cili përcaktohet më pak nga mosha kronologjike sesa nga nevojat dhe motivet e të nxënit. Prandaj, "mosha e hyrjes" kur një person formalisht merr statusin e një të rrituri ndryshon mes vendeve dhe nuk lidhet domosdoshmërisht me moshën e pjekurisë ligjore.

Në nivelin global, UIL-i i UNESCO-s promovon NGjGjJ-në, dhe posaçërisht NARr-in, me programe dhe projekte të ndryshme. Ndër të tjera, ai ka instaluar "Observatorin Global të Njohjes, Validimit dhe Akreditimit të të Nxënit Joformal dhe Informal"[5] dhe monitoron zhvillimet e fundit në kornizat Kombëtare të Kualifikimeve. Shkëmbimi ndërkombëtar për avancimet në NARr lehtësohet në **Konferencat Ndërkombëtare për Arsimin për të Rritur (CONFINTEA)**[6] dhe progresi në NARr në mbarë botën vizualizohet rregullisht në **Raportet Globale për të Nxënit dhe Arsimin për të Rritur (GRALE)**. GRALE 3 jep përkufizimin vijues të arsimit për të rritur:

> "NARr përfshin të gjithë të nxënit formal, joformal dhe informal ose incidental dhe arsimimin e vazhdueshëm (si të përgjithshëm dhe profesional, ashtu edhe teorik dhe praktik) të ndërmarra nga të rriturit (siç përcaktohet ky term në çdo vend). Pjesëmarrësit në NARr zakonisht do të kenë përfunduar arsimimin dhe aftësimin e tyre fillestar dhe pastaj janë kthyer në një formë të të nxënit. Por në të gjitha vendet do të ketë të rinj dhe të rritur që nuk kanë pasur mundësi të regjistrohen ose të përfundojnë arsimin shkollor deri në moshën e parashikuar, dhe që marrin pjesë në programet e NARr-it, duke përfshirë edhe ato programe që i pajisin me shkathtësi alfabetizmi dhe shkathtësi bazë ose si një 'shansi i dytë' për të fituar certifikata të njohura.[7]"

Kur flitet për adresimin e ofertës dhe qasjes në NARr dhe harmonizimin e dispozitave të arsimit për të rritur në kontinentin evropian, institucionet e Bashkimit Evropian mund të konsiderohen nxitësit më të rëndësishëm. Politika e BE-së në fushën e arsimit aktualisht drejtohet nga **Korniza për Arsimin dhe Aftësimin 2020 (ET 2020)** dhe bazohet në qasjen e të nxënit gjatë gjithë jetës, e cila është përcaktuar në **Rezolutën e Këshillit të BE-së për të Nxënit Gjatë Gjithë Jetës**. Ngjashëm me përkufizimin e UNESCO-s të dhënë më lart, të nxënit gjatë gjithë jetës sipas BE-së:

> "Duhet të mbulojë të nxënit nga mosha parashkollore në atë të pas pensionit, duke përfshirë të gjithë spektrin e të nxënit formal, joformal dhe informal. Për më tepër, të nxënit gjatë gjithë jetës duhet të kuptohet si e gjithë veprimtaria e të nxënit e ndërmarrë gjatë gjithë jetës, me qëllim të përmirësimit të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave brenda një perspektive personale, civile, sociale dhe/ose të punësimit.[8]"

[5] Ueb faqja e UIL-it të UNESCO-s për Observatorin Global të Njohjes, Validimit dhe Akreditimit të të Nxënit Joformal dhe Informal

[6] Ueb faqja e UIL-it të UNESCO-s për Konferencat Ndërkombëtare për Arsimin për të Rritur (CONFINTEA)

[7] UNESCO UIL (2016). Raporti i 3të Global për të Nxënit dhe Arsimin për të Rritur, f. 29 dhe Schweighöfer, B. (2019). Arsimi për të Rinjtë dhe të Rritur në Agjendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Bon: DVV International

[8] Këshilli Evropian (2002). Rezoluta e Këshillit e 27 qershorit 2002 për të nxënit gjatë gjithë jetës. Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane C 163/1

Në fjalorthin e vet të termave kyçe të përdorura në politikën evropiane për arsimin dhe aftësimin, BE-ja e përkufizon arsimin për të rritur si "arsim i përgjithshëm ose profesional i ofruar për të rriturit pas arsimit dhe aftësimit fillestar", dhe në këtë mënyrë thekson ndryshimin mes arsimit dhe aftësimit fillestar dhe arsimit të vazhdueshëm ose të përgjithshëm për të rritur.[9]

Për ta mbështetur arsimin për të rritur në kuadër të NGjGjJ-së në veçanti, Këshilli i BE-së ka miratuar **Rezolutën për një Agjendë të ripërtërirë Evropiane për të Nxënit e të Rriturve**[10]. Rezoluta thekson nevojën për ta shtuar ndjeshëm pjesëmarrjen e të rriturve në të nxënit formal, joformal dhe informal, qoftë që të fitojnë shkathtësi pune, për qytetari aktive, ose për zhvillim dhe përmbushje personale. Një iniciativë e mëtejshme nga Këshilli ishte miratimi i një **Rekomandimi për Drejtimet e Rritjes së Kualifikimeve**[11] i cili synon të arrijë nivelet minimale të alfabetizmit, njohurive aritmetike dhe shkathtësive digjitale për të gjithë të rriturit. Komisioni Evropian ka krijuar një Grup Punues për arsimin për të rritur, i përbërë nga ekspertë, përfaqësues të partnerëve socialë dhe shoqërisë civile.

Për më tepër, ai ka ngritur **Platformën Elektronike për të Nxënit e të Rriturve në Evropë (EPALE)**, "një komunitet evropian, shumëgjuhësh, me anëtarësi të hapur, i profesionistëve të të nxënit të të rriturve, duke përfshirë arsimtarë dhe trajnerë për të rritur, staf udhëzues dhe mbështetës, studiues dhe akademikë dhe politikëbërës".

Siç tregohet nga përkufizimet dhe aktivitetet e mësipërme, qëllimet dhe objektivat e NARr-it në sferën e NGjGjJ-së janë të shumëfishta dhe mund të targetojnë nivele të ndryshme të shoqërisë. Në nivelin individual, NARr-i synon zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të secilit individ për të qenë një qytetar me përgjegjësi shoqërore, kritik dhe i pavarur, i cili është në gjendje t'i formësojë zhvillimet që ndodhin si në mjedisin personal ashtu edhe në atë profesional. Në nivelin shoqëror, një komunitet i të rriturve të vetëdijshëm dhe aktivë kontribuon në krijimin e të ashtuquajturës "shoqëri të të nxënit", ku të gjithë kanë mundësinë të mësojnë, të angazhohen dhe të marrin pjesë në shoqëri për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm dhe solidaritet mes njerëzve dhe komuniteteve. Në përgjithësi, NARr-i gjithëpërfshirës nxit një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik, i cili nga ana tjetër është i domosdoshëm për uljen e varfërisë, përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së përbashkët, dhe mbrojtjen e mjedisit.[12]

Qëllimet dhe objektivat e mësipërm mund të realizohen me lloje të ndryshme të NARr-it:

- **të nxënit kompensues dhe kualifikimi për shkathtësitë themelore** (siç janë alfabetizmi dhe njohuritë aritmetike), duke targetuar individë të cilët mund të mos i kenë fituar ato në arsimin ose aftësimin e tyre fillestar të mëparshëm,
- **arsimi dhe aftësimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi profesional**, duke targetuar të rriturit e interesuar për përvetësimin, përmirësimin

[9] CEDEFOP (2014). Terminologjia e politikës evropiane për arsimin dhe aftësimin (botimi i 2të)

[10] Këshilli Evropian (2011). Rezoluta e Këshillit për një agjendë të ripërtërirë evropiane për të nxënit për të rritur. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian C372/1

[11] Këshilli Evropian (2016). REKOMANDIMI I KËSHILLIT, i 19 dhjetorit 2016 për Drejtimet e Rritjes së Kualifikimeve: Mundësi të reja për të rriturit

[12] UNESCO UIL (2015)

ose përditësimin e njohurive, shkathtësive ose kompetencave në një fushë specifike në lidhje me mjedisin e tyre të punës,

- **arsimi në komunitet, popullor ose liberal** (gjithashtu edukimi i qytetarisë), i cili siguron edukim të përgjithshëm dhe mundësi të të nxënit për të rriturit në tema me interes të veçantë për ta për zhvillimin e tyre personal, për t'u marrë me çështje sociale dhe për të bërë një jetë të denjë.

Teksa arsimi bazë shoqërohet zakonisht me të nxënit formal, NARr i referohet të gjithë veprimtarisë së arsimit formal (AF), arsimit joformal (AJF) dhe të nxënit informal (AIF). Të gjitha format e arsimit përcaktohen në mënyrë gjithëpërfshirëse në Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Arsimit (ISCED).[13] Një dokument i dytë që ofron përkufizime të hollësishme të veprimtarive të të nxënit është "Manuali i Klasifikimit të Aktiviteteve të të Nxënit (CLA)" i nxjerrë nga Zyra Evropiane e Statistikave Eurostat.[14]

Arsimi dhe aftësimi formal ofrohet "i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe i planifikuar përmes organizatave publike dhe organeve të njohura private [që përbëjnë] sistemin e arsimit formal të një vendi".[15] Që një veprimtari e të nxënit të jetë formale, është vendimtare njohja e programit nga autoritetet relevante të arsimit ose institucionet e tjera që bashkëpunojnë me autoritetet arsimore kombëtare ose nën-kombëtare. AF zakonisht lidhet me drejtimin e vazhdueshëm të arsimit fillestar me orar të plotë deri në hyrjen e parë të një individi në tregun e punës. Sidoqoftë, ai mund të përfshijë edhe arsimim profesional me orar të pjesshëm, arsimim për njerëzit me nevoja të veçanta dhe lloje të tjera të arsimit për të rritur, pra, arsimim "për të gjitha grupmoshat me përmbajtje programi dhe kualifikime që janë ekuivalente me ato të arsimit fillestar". Në çdo rast, programet formale duhet të kenë një kohëzgjatje minimale prej një semestri studimesh me orar të plotë (ekuivalente me 30 ECTS).

Arsimi joformal, ngjashëm me arsimin formal, është "arsimi që është i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe i planifikuar nga një ofrues i arsimit". Sidoqoftë, karakteristika thelbësore e arsimit joformal është se ai është një "shtesë, alternative dhe/ose plotësim i arsimit formal brenda procesit të të nxënit gjatë gjithë jetës". Programet për AJF mund të çojnë në kualifikime, por në përgjithësi këto nuk njihen nga autoritetet arsimore si ekuivalente me kualifikimet formale. Në disa raste, kualifikimet formale mund të arrihen përmes programeve speciale të njohura për AJF. Për dallim nga arsimi formal, AJF ndjek domosdoshmërisht një rrugë të vazhdueshme të arsimimit dhe të të nxënit, dhe për këtë arsye është në gjendje të adresojë të gjitha grupmoshat, më shumë sesa programet e arsimit formal. Programet për AJF janë shpesh të natyrës afatshkurtër, me intensitet më të ulët të ofruar në punëtori, kurse, seminare, trajnime gjatë punës (të organizuara nga punëdhënësi me ndihmën e një instruktori) dhe mësime private. Kështu, AJF mund të shërbejë për të tri llojet e NARr-it të përmendura më lart: arsimi kompensues në formën e edukimit të alfabetizmit për të rinjtë dhe të rriturit ose arsimi formal-zëvendësues për fëmijët jashtë shkollës, zhvillimi i shkathtësive profesionale, dhe pro-

[13] UNESCO UIL (2012). Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit ISCED 2011, f. 11f

[14] Eurostat (2016). Manuali i klasifikimit të aktiviteteve të të nxënit (CLA) botimi 2016

[15] Po aty.

gramet për shkathtësitë jetësore dhe zhvillim social, politik ose kulturor.[16]

Për fundi, të nxënit informal mbulon të gjitha ato "forma të të nxënit që janë të qëllimshme ose të synuara, por nuk janë të institucionalizuara"[17]. Ndryshe nga arsimi në mjedise formale dhe joformale, **të nxënit informal** është shumë më pak i strukturuar dhe i organizuar. Mund të ndodhë në kontekste të jetës së përditshme brenda familjes, në vendin e punës, në komunitetin lokal, përmes punës vullnetare, në hapësirën digjitale, muze apo biblioteka. Përmbajtja e të nxënit zgjidhet vetë për të përmbushur qëllimet e të nxënit ose për të ndjekur zhvillimin shoqëror, dhe ritmi i të nxënit zakonisht drejtohet nga vetë personi.

Andaj, NARr-i, duke përfshirë të gjitha format e edukimit dhe të të nxënit për të rriturit, përfiton nga zhvillimet e fundit të rëndësishme në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, veçanërisht në lidhje me qasjen dhe përfshirjen. Me Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), hapen dhe individualizohen mjediset e arsimit sy më sy dhe të nxënit formal dhe joformal, dhe mundësohet të nxënit e individualizuar përmes përdorimit të pajisjeve mobile, rrjeteve sociale digjitale dhe kurseve online kudo dhe në çdo kohë.

Kundrejt sfondit të përkufizimeve të BE-së dhe UNESCO-s, ky studim ndjek një pamje të gjerë mbi arsimin për të rritur, e cila konsideron të gjitha format e organizuara të të nxënit të të rriturve pas ciklit fillestar të arsimit (siç janë rikualifikimi, AAP i mëtejshëm ose i vazhdueshëm) dhe të gjitha format e qëllimshme të arsimit dhe të nxënit joprofesional, në komunitet, popullor ose liberal me qëllim zhvillimin profesional ose personal.[18] Në tekstin e mëtejmë, termi të nxënit dhe arsimi për të rritur (NARr) do të përdoret në mënyrë që të shprehë të gjitha dimensionet relevante të këtij sektori.

Të kuptuarit dhe perceptimi i konceptit të NARr-it në Kosovë

Qeveria e Kosovës e përshkruan arsimin për të rritur si pjesë integrale të sistemit arsimor dhe jep kritere konkrete të përkufizimit, të cilat kryesisht janë në përputhje me konceptualizimin ndërkombëtar. Të gjithë shtetasit mbi moshën 15 vjeç onsiderohen nxënës të rritur.

> "Arsimi dhe aftësimi për të rritur nënkupton të gjithë të nxënit dhe aftësimin publik dhe privat të ofruar për të rriturit dhe/ose për të rinjtë mbi 15 vjeç, të cilët kanë të drejtë të ndjekin programet e të nxënit të krijuara për të rriturit. Arsimi dhe aftësimi për të rritur është pjesë integrale e sistemit arsimor në Kosovë. Arsimi dhe aftësimi për të rritur mund të ofrohet në institucione publike dhe private.[19]"

[16] UNESCO UIL (2012), p. 11f

[17] Po aty.

[18] Duke devijuar nga përkufizimi i NARr-it i dhënë në GRALE-n e 3-të, i cili përfshin gjithashtu të nxënit rastësor në NARr, ky raport përqendrohet vetëm në edukimin e qëllimshëm dhe aktivitetet e të nxënit, siç përcaktohen në ISCED dhe CLA.

[19] Portali Shtetëror i Republikës së Kosovës, të nxënit për të rritur

Objektivi i përgjithshëm i arsimit për të rritur në Kosovë është krijimi i një mjedisi mundësues për të rinjtë dhe të rriturit, i cili siguron qasje në mundësi cilësore të të nxënit themelor, i cili rrit njohuritë dhe kompetencat e popullatës së rritur, dhe promovon qasje të barabartë në aftësime cilësore për të pafavorizuarit dhe pakicat. Një sistem funksional i arsimit për të rritur në Kosovë ka për qëllim të kontribuojë në krijimin e një shoqërie të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe në përmirësime të dukshme në jetën e njerëzve. "Prioritetet e nën-sektorit për të rritur përqendrohen në fushat kryesore vijuese: qasja dhe barazia, përmirësimi i cilësisë, partneritete të përmirësuara, zhvillimi i kapaciteteve dhe forcimi i të nxënit gjatë gjithë jetës".[20]

Kufijtë themelorë të arsimit për të rritur në Kosovë përcaktohen në Ligjin Nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës.[21] Aktivitetet arsimore dhe trajnuese publike dhe private të siguruara për të rriturit përmblidhen nën termin "Arsimi dhe aftësimi për të rritur" (AARr). Të nxënit gjatë gjithë jetës përkufizohet shkurtimisht si "të gjitha aktivitetet e të nxënit të ndërmarra gjatë gjithë jetës për zhvillimin e njohurive, kompetencave dhe kualifikimeve". Ky konceptim është përgjithësisht në përputhje me atë ndërkombëtar, megjithëse nuk arrin të theksojë faktin se të nxënit në mënyrë ideale duhet të shkojë përtej perspektivës ekonomike ose të punësimit dhe të përfshijë aspekte të të nxënit personal, qytetar dhe shoqëror.

Ligji bën dallimin mes arsimit formal, joformal dhe informal. Sidoqoftë, përkufizimet mbahen mjaft të shkurtra. Pa shembuj të qartë, diferenci-mi mes formave të arsimit mbetet mjaft i paqartë, një aspekt që ka të ngjarë të shkaktojë keqkuptime konceptuale. Lind një farë konfuzion terminologjik nga përdorimi i këmbyeshëm i fjalëve "arsim", që në kuptimin e duhur përfaqëson përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive në një mjedis të strukturuar, institucional, të qëllimshëm, duke përfshirë një kurrikulë dhe ndërveprimin e mësimdhënësve dhe nxënësve, dhe "të nxënit", që potencialisht ndodh kudo dhe në çdo kohë, i cili është një proces individual ose kolektiv, kryesisht i vetë-përcaktuar, dhe nuk kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e kritereve ose mësimdhënësve formalë.

Në përputhje me konceptimet ndërkombëtare, arsimi formal kuptohet si arsim i strukturuar, i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe që çon në kualifikimin formal. **Arsimi formal** mund të ofrohet në mjedise të strukturuara siç janë "një institucion arsimor ose profesional/aftësues ose në punë". Ligji nuk e lidh qartësisht arsimin formal me arsimin fillestar ose arsimin bazë kompensues. Sidoqoftë, në praktikë, arsimi formal për të rritur në Kosovë barazohet me arsimin bazë ose atë kompensues, me të cilin të rriturit mund të kompensojë me nivelet 2, 3 dhe 4 të ISCED dhe Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

Ekzistojnë dy përkufizime të gjera të parapara për arsimin joformal, të cilat nuk janë qartësisht të dallueshme konceptualisht. Nga njëra anë, ligji përshkruan **arsimin joformal** si të nxënit "tjetër nga ai i ofruar përmes programeve të mbuluara nga përkufizimi i "arsimit formal" të parapara në këtë ligj". Nga ana tjetër, ai përmend **arsimin dhe aftësimin joformal** i cili është i qëllimshëm dhe

[20] Likaj, R. et al. (2015). Sfidat dhe arritjet në arsimin për të rritur në Kosovë

[21] Kuvendi i Republikës së Kosovës (2013b) Ligji Nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 2, 21 janar 2013, Prishtinë

"i referohet arsimit që ka aktivitete të përcaktuara qartë, por që nuk është emërtuar në mënyrë të qartë si arsim (duke iu referuar objektivave të të nxënit, kohës ose mbështetjes së të nxënit)". Përkufizimet nuk i referohen qëllimit dhe vendit të të nxënit dhe as karakteristikës së rëndësishme të funksionimit shtesë, në mënyrë alternative ose plotësuese ndaj arsimit formal, ose mundësisë për të çuar në kualifikim formal.[22]

Andaj, nuk duhet të na habisë konfuzioni për atë që do të thotë në të vërtetë arsimi joformal për të rritur në kontekstin kosovar. Sidoqoftë, ajo që bëhet e qartë në kapitujt vijues të këtij studimi është se në praktikë arsimi joformal për të rritur kuptohet si arsim i ofruar si në qendrat publike të aftësimit profesional (QAP) të menaxhuara nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) dhe përmes ofruesve të aftësimit publik dhe privat. Ofruesit shtetërorë të AJF-së njihen dhe akreditohen nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) dhe certifikatat e tyre njihen në përputhje me sistemin e kredive në Kosovë dhe nga disa vende të huaja. Edhe pse aftësime të tilla mund të çojnë në kualifikime formale në KKK në nivelet 3 dhe 4, ato nuk konsiderohen forma të arsimit formal. Programet e AJF-së janë targetojnë individë që kërkojnë kualifikime, rikualifikime, zhvillime profesionale në mënyrë që të hyjnë në tregun e punës, të mbajnë profesionin ose të përparojnë në shkallët e karrierës. Kështu, AJF në Kosovë është i lidhur ngushtë me arsimimin dhe aftësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin profesional, ndërsa më pak vëmendje i kushtohet edukimit qytetar.

Të nxënit informal definohet si **"arsim informal"** në Ligj. Kuptimi në thelb pasqyron konceptimin ndërkombëtar, pasi ai përfshin aktivitetet e të nxënit në sferat private ose shoqërore të cilat nuk janë të strukturuara ose të autorizuara.

Siç u sugjerua më lart, në praktikë, arsimi dhe aftësimi për të rritur në Kosovë është i lidhur fort me arsimin dhe aftësimin profesional dhe kontekstin ekonomik. Mbështetja e zhvillimit të karrierës konsiderohet si "pjesë e integruar e të nxënit gjatë gjithë jetës" dhe parim udhëzues i AAP-së.[23] Një institucion qendror në kontekstin e AAP-së është Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimi për Rritur. AAAPARr-ja është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zhvillimin e AAP-së, si dhe aftësimin për të rritur (për një përshkrim më të plotë të rolit të AAAPARr-së në arsimin për të rritur shih Kapitullin IV). Lidhja e fortë e arsimit për të rritur me arsimin dhe aftësimin profesional mund t'i atribuohet shkallës së lartë të papunësisë gjatë dekadave të kaluara dhe strategjisë së qeverisë për ta trajtuar këtë sfidë përmes rritjes së nivelit të arsimit të përgjithshëm për të rritur.

Plani Strategjik i Arsimit i Kosovës (PSAK) 2017-2021 pranon mungesën e një sistemi efektiv dhe të hapur për arsimin për të rritur:

> "Një nga sfidat kryesore në sektorin e arsimit është ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm për promovimin e arsimit për të rritur dhe të nxënit gjatë gjithë jetës, dhe sigurimi i fondeve për këtë prioritet. Aktualisht nuk ka asnjë skemë financimi ose formulë financimi për arsimin për të rritur. Funksionimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të […] AAAPARr-së si dhe Këshillit të saj

[22] Përkufizimi i arsimit joformal i dhënë në Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional është formuluar ndryshe.

[23] Kuvendi i Republikës së Kosovës (2013a) Ligji Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 7, 26 mars 2013, Prishtinë

> është një sfidë dhe është një parakusht për krijimin e një qasje më koherente për arsimin për të rritur. Për më tepër, nuk ka kapacitete të stafit për të adresuar nevojat e arsimit për të rritur dhe zbatimi i prioriteteve të këtij nën-sektori bëhet kryesisht në kuadër të arsimit profesional dhe nga organizatat joqeveritare dhe bizneset.[24] ”

E njëjta strategji nënvizon rëndësinë e ofrimit të mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për qytetarët që nuk kanë përfunduar arsimin e tyre bazë, ata që nuk kanë ndonjë kualifikim ose ata që duan të rikualifikohen për qëllime punësimi ose ndryshimi të karrierës.

Kjo përmbledhje e shkurtër dhe kapitujt vijues sugjerojnë që arsimi për të rritur në Kosovë është konceptuar kryesisht si arsim formal dhe joformal. Ai realizohet përmes arsimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional si dhe të nxënit kompensues dhe kualifikimit për shkathtësitë themelore. Komponenti i arsimit në komunitet, popullor ose liberal i arsimit për të rritur dhe kontributi i tij i mundshëm pozitiv në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, nuk ka marrë ende vëmendje të konsiderueshme në debatin e politikave.

[24] Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2016). Plani Strategjik i Arsimit i Kosovës 2017-2021

II. Profili i shtetit

Kosova është një vend i vogël, pa dalje në det, në Evropën juglindore. Kufijtë e saj janë me Shqipërinë në jugperëndim, me Malin e Zi në veriperëndim, me Serbinë në verilindje dhe Maqedoninë në jug, dhe mbulon një sipërfaqe totale toke prej 10,905,25 km². Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina.

Karakteristikat socio-ekonomike

Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit nga viti 2011, në Kosova banojnë 1.78 milionë banorë, nga të cilët pjesa më e madhe (92.9%) janë shqiptarë etnikë. Serbët, që kryesisht jetojnë në Kosovën veriore dhe enklava të vogla në jug, përbëjnë 1.5% të popullsisë dhe në këtë mënyrë përbëjnë pakicën më të madhe etnike. Pakicat më të vogla etnike të përbëra nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas (RAE) përbëjnë 5.6% të popullsisë. Gjatë viteve të fundit, pjesa e popullsisë së shqiptarëve të Kosovës është rritur vazhdimisht, edhe për shkak të faktit se shumë serbë të Kosovës janë larguar nga vendi për arsye politike.

Kosova ka dy gjuhë zyrtare: shqip dhe serbisht. Për t'iu qasur diversitetit gjuhësor në vend, gjuhët e pakicave si turqishtja, boshnjakishtja dhe romishtja kanë statusin e gjuhës zyrtare në nivelin lokal. Përveç gjuhës së tyre amtare, rreth 30% e popullatës kosovare flasin serbisht ose anglisht, 14% flasin gjermanisht, 6% turqisht, 5.8% boshnjakisht, 3.4% shqip, 3% frëngjisht dhe 0.3% romisht.[25]

Me kushtetutë, Kosova është shtet laik i cili promovon neutralitetin në çështjet fetare dhe lirinë fetare. Shoqëria e saj është kryesisht laike, pasi identiteti kombëtar është më tepër i zhvilluar sipas origjinës etnike sesa përkatësisë fetare. 96% e popullsisë (kryesisht shqiptarë të Kosovës) praktikojnë një formë të moderuar të Islamit, fetë e tjera të praktikuara janë ortodoksia serbe, katolicizmi, protestantizmi dhe judaizmi.[26]

Qytetarët e Kosovës janë krahasimisht të rinj, me moshë mesatare 30.2 vjeç. 28% e popullsisë janë më të rinj se 15 vjeç, pothuajse 50% janë më të rinj se 25 vjeç, dhe vetëm 7% janë 65 vjeç e lart. Për ta krahasuar, përqindja mesatare e fëmijëve nën 15 vjeç në 27 vendet e Bashkimit Evropian (BE-27) është 15%. 51.19% e popullsisë janë femra. Mesatarisht njerëzit arrijnë moshën 76.7 vjeç para se të vdesin, gratë priren të jetojnë më gjatë (79.4 vjet).

Sipas të dhënave të regjistrimit nga viti 2011, 73% e popullsisë 10 vjeç e lart kanë kryer të paktën nëntë vjet shkollim (diplomë të shkollës së mesme të ulët) (shih Figurën 1). Një pjesë domethënëse e popullsisë prej 6% nuk ka kryer arsim formal. Në përgjithësi, arritjet arsimore janë të lidhura ngushtë me vendndodhjen gjeografike, origjinën etnike dhe gjininë (shih pjesën 4. Sistemi Arsimor). Sipas Anketës së Grupimeve me Tregues të Shumëfishtë të UNICEF-it (MICS) në vitin 2020, 2.8% e popullsisë mes 15 dhe 49 vjeç vlerësohet të jetë analfabete.[27] Nivelet më të larta të alfabetizmit prej 99.4% arrihen mes të rinjve, nga 15 deri 24 vjeç. Nivelet e alfabetizmit ulen

[25] Ueb faqja e Komisionerit të Gjuhëve të Kosovës

[26] Bertelsmann Stiftung (2018). BTI Raporti i Vendit - Kosova. Gütersloh: Bertelsmann Stiftung, f. 9

[27] Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF-i (2020). Anketa e Grumbullimit të Treguesve të Shumëfishtë në Kosovë 2019-2020 dhe Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2019-2020, Raporti i Gjetjeve të anketës. Prishtinë: UNICEF

mes atyre që kanë kryer shkollë të mesme të ulët si nivelin e tyre më të lartë të arsimit. Për më tepër, analfabetizmi është më i përhapur në mesin e komuniteteve RAE. Vetëm 63.8% e grave RAE dhe vetëm 56% e grave RAE me arsim fillor ose të mesëm të ulët si niveli i tyre më i lartë arsimor, dinë të lexojnë dhe të shkruajnë.

FIGURA 1 Nivelet e arsimit në mesin e popullatës 10 vjeç e lart (në vitin 2011)



Burimi: Prezantimi i autorëve bazuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (2011). Treguesit kryesorë të arsimit 2011.

61% e popullsisë kosovare jeton në zona rurale jashtë kryeqytetit Prishtinë. Ka një trend drejt migrimit nga zonat rurale në zonat urbane dhe periferike. Në përgjithësi, shteti regjistron një dendësi të popullsisë prej 163.42 banorë për km2. Numrat e popullsisë janë në rritje (p.sh. numrat e lindjeve i tejkalojnë vdekjet) por me një ritëm në rënie, në vitin 2018 zyra e statistikave regjistroi një rritje natyrore të popullsisë prej 7.7 për 1000 banorë. Kurse migrimi neto ka pasur ndryshime të mëdha gjatë dekadës së fundit, me një tendencë negative, (p.sh. më shumë njerëz emigruan nga Kosova sesa imigruan në Kosovë).

Kosova ka një diasporë të madhe të qytetarëve që jetojnë jashtë. Ishte veçanërisht konflikti i dhunshëm në periudhën mes viteve 1997 dhe 1999 që nxiti shumë njerëz të largohen nga vendi.[28] Vala e fundit e emigrimit u regjistrua në periudhën 2014/15 kur rreth 100,000 shtetas kosovarë kërkuan azil në BE.[29] Në vitin 2018, pothuajse 35,000 shtetas nga Kosova morën lejen e tyre të parë të qëndrimit në vendet e BE-së, 3,295 persona aplikuan për azil në BE për herë të parë.[30] Aktualisht, numri i qytetarëve kosovarë që jetojnë jashtë vlerësohet të sillet ndërmjet 700,000 dhe 800,000.[31] Migrantët kosovarë janë vendosur kryesisht në Gjermani, të ndjekur nga Zvicra, Italia, Austria dhe Sllovenia.[32] Arsyet kryesore për migracionin ndërkombëtar ishin dhe janë aspektet ekonomike dhe sociale. Për shkak të papunësisë së lartë kombëtare, migrantët për herë të parë janë mjaft të rinj dhe në moshë pune, gjë që rezulton në një reduktim të ofertës së krahut të punës brenda vendit.

[28] UNDP (2016). Raporti për Zhvillimin Njerëzor të Kosovës 2016

[29] Quirezi, B. (2015). Emigrimi nga Kosova i vitit 2015 drejt Bashkimit Evropian: kush, pse dhe si. Prishtinë: Fondacioni Friedrich-Ebert

[30] Eurostat (2020e). Statistikat mbi migracionin, lejet e qëndrimit, shtetësinë dhe azilin për vendet e zgjerimit, botimi 2020

[31] Judah, T. (2019). Fati demografik i Kosovës duket shumë i njohur. Portali Reporting Democracy

[32] Möllers, J. et al. (2017). Studim mbi migracionin rurale dhe migracionin e kthimit në Kosovë, Punim Diskutimi, 166. Halle (Saale): Instituti Leibniz i Zhvillimit Bujqësor në Ekonomitë në Tranzicion (IAMO), f. 14

Flukset më të mëdha të imigracionit u regjistruan në 1999, 2000 dhe 2010, kur Kosova u pajtua për riatdhesim në shkallë të gjerë të qytetarëve me disa vende. Shumica e imigrantëve kishin shtetësi kosovare dhe kryesisht vinin nga Gjermania, Serbia dhe Zvicra.

Për refugjatët, Kosova është kryesisht një vend tranzit. Në vitin 2019, 320 individë kërkuan azil në Kosovë, nga të cilët 33 morën vendim pozitiv.[33] Një sfidë e madhe është zhvendosja e zgjatur e brendshme. Edhe pse ndërmjet viteve 2000 dhe 2019 në Kosovë ose brenda vendit janë kthyer më shumë se 28,000 persona të zhvendosur[34] rreth 16,200 mbeten të zhvendosur brenda Kosovës (kryesisht serbë, por edhe shqiptarë dhe RAE).[35]

Në kohën e regjistrimit të fundit të popullsisë në 2011, rreth 40% e të gjitha familjeve ishin pa kompjuter ose qasje online, më shumë se dy të tretat e tyre në zonat rurale. Që atëherë, ka ndodhur zhvillim i shpejtë. Në vitin 2019, 93% e të gjitha familjeve kishin qasje online nga shtëpia (që është 3% më shumë se mesatarja e BE-27). 61% e të gjitha familjeve kishin qasje në një kompjuter personal.[36]

Me një rezultat prej 0.741 dhe e renditur në vendin e 85-të (në vitin 2016) Kosova i përket vendeve më pak të zhvilluara në rajonin e Evropës Juglindore dhe renditet pranë Shqipërisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës. Në vitin 2017, koeficienti Gini ishte 29 (mesatarja e BE-27 ishte 30 në 2019).[37] Zhvillimi i vendit pengohet nga nivelet e larta të varfërisë, performanca e dobët e sektorit privat në krijimin e vendeve të punës, si dhe një lidhje e theksuar mes papunësisë dhe përjashtimit socio-ekonomik.[38]

Karakteristikat ekonomike

Përkundër shifrave mjaft konstante të rritjes ekonomike pozitive prej 4% të BPV-së ndërmjet viteve 2015 dhe 2019 (madje pa rënie të mëdha gjatë krizës financiare globale) Kosova kategorizohet si një vend me të hyra të mesme të ulëta dhe një nga vendet më të varfra në Evropë.[39]

Në vitin 2018, BPV-ja e Kosovës (me çmimet aktuale) kapi 6 miliardë euro, shumë poshtë mesatares së BE-27 me 13,484 miliardë euro Në mënyrë të ngjashme, vlera e BPV-së prej 3,740 euro për kokë është e ulët në krahasim ndërkombëtar, edhe pse është se është rritur më shumë se dyfishi mes viteve 2008 dhe 2018 (rritje prej 110%).[40]

Me një tendencë në rritje prej vitit 2015, shifrat e borxhit kombëtar arritën në 1.2 milion euro në 2019 (rreth 17% e BPV-së), një vlerë e cila është relativisht e ulët në krahasimin me BE-27 (79.9% në vitin 2018).[41][42] Vlera e ulët mund t'i atribuo-

[33] Komisioni Evropian (2020). Raporti për Kosovën 2020.
[34] UNHCR (2019). Fakte për Kosovën
[35] UNHCR (2018). Profilizimi i Personave të Zhvendosur Brenda Kosovës
[36] Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019b). Rezultatet e anketës mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit 2019 dhe Eurostat (2020b). Vendet e zgjerimit - statistikat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit
[37] Koeficienti Gini mat pabarazinë e të hyrave në një shoqëri. Një vlerë prej 0 do të thotë barazi e përsosur (të gjithë kanë të njëjtat të hyra), një vlerë prej 100 pabarazi e përsosur (të gjitha të hyrat janë në pronësi të një personi).
[38] UNDP (2016)
[39] Banka Botërore (2020). Perspektiva Makro e Varfërisë Kosovë tetor 2020
[40] Eurostat (2020d). Vendet e zgjerimit - zhvillimet e fundit ekonomike
[41] Ministria e Financave dhe Transfereve (2019). Buletini Vjetor 2019 për Borxhin Publik
[42] Eurostat (2020a). Vendet e zgjerimit - statistikat e financave

het historisë së shkurtër të shtetit me vendimmarrje të pavarur politike, por sidoqoftë është shqetësuese. Për shkak të një baze të dobët eksportesh, Kosova përballet me një deficit tregtar mjaft të madh prej 29.2% të BPV-së. Në të njëjtën kohë Kosova mund të mbështetet në investime të huaja direkte të qëndrueshme dhe një sasi të madhe të remitancave, që përfaqësojnë rreth 15% të BPV-së. Në përgjithësi, ekonomia e Kosovës aktualisht drejtohet më shumë nga remitancat, konsumi dhe importet, sesa nga investimet, tregtia dhe eksportet. Kjo tendencë pengon diversifikimin ekonomik dhe ul stimujt e punësimit.[43]

Në vitin 2018 shërbimet përbënin 58.5% të vlerës së shtuar bruto në Kosovë. Teksa industria zinte 21.8%, ndërtimi si dhe bujqësia, pylltaria dhe peshkimi kontribuuan përkatësisht me 10.8% dhe 8.9%.

Investimet e pamjaftueshme, mungesa e vendeve të punës cilësore dhe mospërputhjet mes niveleve të arsimit dhe nevojave të tregut të punës, kanë rezultuar në papunësi të konsiderueshme dhe pasivitet të lartë veçanërisht në mesin e popullatës femërore. Vetëm 20% e grave të moshës mes 20 dhe 64 vjeç janë ekonomikisht aktive, domethënë ose të punësuara ose të papuna. [44] Në vitin 2019, vetëm 30% e fuqisë punëtore ishte e punësuar (46% e burrave dhe 13.9% e grave). Burrat punojnë në sektorin e ndërtimit, tregtisë dhe energjisë elektrike, gratë më tepër në arsim, shëndetësi dhe punë sociale dhe tregti. Veçanërisht për gratë, niveli arsimor është vendimtar për punësimin, pasi shkalla e punësimit të tyre rritet në 50% me arsimin e lartë.

Rreth një e katërta e fuqisë punëtore kosovare është e papunë, duke rezultuar në një shkallë papunësie prej 25%, e cila është dukshëm më e lartë për gratë (34%). Papunësia është më e zakonshme për njerëzit pa arsim formal dhe zvogëlohet me arsimin e lartë, veçanërisht tek burrat. Shkalla e papunësisë së grave mbetet më e lartë se 30%, pavarësisht nga niveli arsimor. Kryesisht është rinia që preket nga papunësia, pothuajse 70% e të gjithë personave të papunë në Kosovë janë nën moshën 35 vjeç. Në të njëjtën kohë, shkalla e papunësisë për këtë grupmoshë qëndron në 40% (52% për femrat, 35% për meshkujt).[45]

Punësimi i lartë i të rinjve është pjesërisht i lidhur me mundësitë e kufizuara për të rinjtë për të ndjekur arsimin e mëtejshëm dhe masat e aftësimit. për pasojë, përqindja e të rinjve të moshës 15 deri 24 vjeç jo në punësim, arsim dhe aftësim (NEET) përbënte 27.4% në vitin 2017. Të rejat janë në risk më të lartë për t'u bërë pjesë e grupit NEET (31.4%).[46] Sipas Raportit të Zhvillimit Njerëzor të Kosovës 2016 faktorët vendimtar për NEET janë gjinia, mosha, arsimi dhe madhësia e familjes. Përveç kësaj, marrja e remitancave rrit gjasat e pasivitetit.[47]

[43] Bertelsmann Stiftung (2018)

[44] Eurostat (2020c). Vendet e zgjerimit - statistikat e tregut të punës

[45] Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019a). Anketa e Fuqisë Punëtore 2019

[46] Viertel, E. (2019). Politikat për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor në Kosovë - Vlerësimi i Procesit të ETF të Torinos

[47] UNDP (2016), f. 41.

Shkalla e lartë e papunësisë shkakton nivele dukshëm të larta të varfërisë në Kosovë.[48] Në vitin 2017, 18% e popullsisë jetonte nën kufirin e varfërisë kombëtare prej 1.85 euro, 5.1% jetonte në varfëri të skajshme (me më pak se 1.31 euro në ditë). Gratë (18.9%), fëmijët (22.8%), njerëzit që jetojnë në zonat rurale (në vitin 2017 64.8% e popullsisë së varfër jetonin në zonat rurale), njerëzit që ishin të papunë (25.5%) dhe njerëzit vetëm me arsim fillor (21.6%) janë në risk më të lartë për të qenë të varfër. Shkalla më e ulët e varfërisë është regjistruar në mesin e familjeve që kryesisht marrin paga dhe mëditje nga sektori publik (7%) dhe remitanca nga jashtë (11%). Në risk më të lartë të varfërisë janë familjet në varësi të punës ditore (29.3%) dhe pensioneve (29.3%). Shkalla më e lartë e varfërisë vërehet tek familjet që varen nga ndihma sociale (këtu shkalla e varfërisë është 80.2%). Në vitin 2017, anëtarët e familjeve që varen nga pagat dhe mëditjet nga sektori privat përbënin kategorinë më të madhe të popullsisë së varfër (34.7%).

Sistemi politik

Gjatë kohës së Republikës Jugosllave, Kosova i përkiste Republikës së Serbisë. Ishte provincë autonome me të drejta të ngjashme me republikat e tjera të Jugosllavisë. Në vitet 1980, shqiptarët e Kosovës filluan të kërkonin statusin e një republike konstituive për provincën e tyre autonome, duke nisur protesta në vitin 1981. Tensionet etnike mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës mbetën të larta gjatë gjithë dekadës. Ato rezultuan në rritjen e kundërshtimit serb ndaj autonomisë së konsiderueshme të provincave dhe sistemit joefektiv të konsensusit në nivelin federal në të gjithë Jugosllavinë, i cili u pa si një pengesë për interesat serbe. Në 1989 Serbia e privoi Kosovën nga autonomia e saj dhe vendosi një regjim shtypës ushtarak në rajon. Të gjithë shqiptarët e Kosovës duhej të linin pozitat e tyre në shërbimin publik dhe krahina drejtohej drejtpërdrejt nga Beogradi. Pas përpjekjes së pasuksesshme për të rezistuar në mënyrë paqësore, antagonizmi mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve rezultoi në luftë në vitin 1998. Ndërhyrja ushtarake e NATO-s arriti t'i jepte fund konfliktit në vitin 1999 dhe me Rezolutën 1244 të OKB-së[49] u formua një administratë ndërkombëtare. Nga viti 1999 deri në vitin 2008, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbante përgjegjësi civile mbi territorin, ndërsa prania e NATO-s në Kosovë (Forca e Kosovës, ose KFOR) ishte përgjegjëse për sigurinë e brendshme. E stimuluar dhe mbikëqyrur nga OKB-ja, Kosova zhvilloi strukturat e vetëqeverisjes dhe Kuvendi i Kosovës e shpalli pavarësinë në vitin 2008. Që nga ajo kohë, Kosova është njohur si shtet i pavarur nga 116 shtete (shumica e vendeve anëtare të BE-së, dhe më shumë se gjysma e shteteve anëtare të OKB-së). Teksa Serbia ende nuk e pranon zyrtarisht sovranitetin e Kosovës, të dy shtetet janë deklaruar për normalizim të marrëdhënieve të tyre me Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2014 dhe pas mosmarrëveshjeve mbi taksat kohët e fundit gjithashtu ranë dakord të normalizonin marrëdhëniet e tyre ekonomike.[50]

Deri më sot, Kosova nuk është anëtare e OKB-së për shkak të vetos së Kinës dhe Rusisë. As aplikim për anëtarësim në UNESCO në vitin 2015 nuk pati sukses. Sidoqoftë, Kosova është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankës Botërore dhe Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës.

[48] Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Banka Botërore (2019). Varfëria e Konsumit në Republikën e Kosovës

[49] Misioni i OKB-së në Kosovë (1999). Rezoluta e Kombeve të Bashkuara 1244

[50] Bertelsmann Stiftung (2018), f. 5

Sa i përket marrëdhënieve me institucionet e BE-së, Kosova ka statusin e të një kandidati të mundshëm për anëtarësim në BE. Dialogu politik dhe bashkëpunimi politik BE-Kosovë përcaktohen në "Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit" (MSA), e cila hyri në fuqi në vitin 2016. Agjenda e Reformave Evropiane (ARE) udhëzon procesin e reformave në Kosovë, duke zbatuar veprime prioritare në fushat e qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, konkurrueshmërisë, punësimit dhe arsimit.[51] Nga "Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimit" (IPA II) Kosova ka marrë mbështetje bilaterale prej BE-së në shumën prej 573 milionë eurosh mes viteve 2014 dhe 2020.

Nga ana administrative shteti i Kosovës ndahet në 7 rajone, 38 komuna dhe 1,469 vendbanime. Është i organizuar në mënyrë unitare me dy nivele të qeverisjes, një në nivelin qendror dhe një në nivelin lokal (komunal).[52] Komunat mbajnë tre lloje të kompetencave: kompetencat vetanake, kompetencat e zgjeruara dhe ato të deleguara, duke përfshirë autonominë financiare për kompetencat brenda përgjegjësisë së tyre. Arsimi është pjesë e kompetencave të zgjeruara të qeverisjes lokale.[53] Sidoqoftë, kompetencat de-facto devijojnë, pasi sipas raporteve, kuvendet komunale kanë kompetenca të dobëta buxhetore efektive dhe qeverisja lokale dobësohet nga ndikimi i tepërt politik nga niveli kombëtar.[5455] Teksa Kosova synon t'i integrojë komunat me shumicë serbe në sistemin e saj institucional, ato komuna mbajnë të drejta të gjera për autonominë dhe de-facto veprojnë kryesisht përtej kontrollit të institucioneve të qeverisë shtetërore.

Kushtetuta e vitit 2008 ka krijuar një republikë demokratike parlamentare shumë-partiake në Kosovë. [5657] Presidenti është kreu zyrtar i shtetit, i zgjedhur nga dy të tretat e Kuvendit për një mandat prej pesë vjetësh. Asambleja njëdhomëshe (Kuvendi) përbëhet nga 120 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejt përmes një sistemi zgjedhor përfaqësimi proporcional. 20 vendet e tjera janë të rezervuara për serbët e Kosovës dhe përfaqësuesit e tjerë të bashkësive etnike. Shefi i qeverisë është kryeministri. Kryeministri zgjidhet për një mandat katër vjeçar nga të paktën një shumicë prej dy të tretave në Kuvend.

Zgjedhjet e fundit (të parakohshme) parlamentare në Kosovë u mbajtën në shkurt 2021. Partia e qendrës së majtë Vetëvendosje e udhëhequr nga Albin Kurti i fitoi zgjedhjet me gati 50% të votave. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e qendrës së djathtë mori 17% të votave dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e qendrës së djathtë doli e treta me 13% të votave.

Sistemi arsimor

Me zbatimin e PSAK 2017-2021 Kosova ka bërë progres në përmirësimin e qasjes në arsim dhe cilësinë e sektorit të arsimit. Sidoqoftë, cilësia e përgjithshme e arsimit mbetet shqetësim.[58]

[51] Komisioni Evropian (2020).
[52] Ueb faqja e Komitetit Evropian të Rajoneve, Kosova Kandidate Potencial
[53] Ueb faqja e Komitetit Evropian të Rajoneve, Arsimi i Kosovës
[54] Komisioni Evropian (2020)
[55] Krasniqi, G. (2019). Kosova. Qendra Ndërkombëtare Suedeze për Demokraci Lokale (ICLD)
[56] Ueb faqja e Freedom House, Kosova 2020
[57] Komisioni Evropian (2020)
[58] Po aty.

Niveli i arsimit parashkollor është i ulët dhe në Programin e fundit të OECD për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) Kosova renditet e 3-ta nga fundi.[59] Sipas Indeksit të Kapitalit Njerëzor të Bankës Botërore "fëmijët në Kosovë mund të presin të përfundojnë 12.8 vjet në shkollim parafillor, fillor, të mesëm deri në moshën 18 vjeç. Sidoqoftë, kur vitet e shkollimit përshtaten për cilësinë e të nxënit, kjo është e barabartë vetëm me 7.7 vjet, pra hendeku i të nxënit është prej 5.1 vjetësh".[60]

Shpenzimet publike për arsimin kapën 4.2% të BPV-së në vitet 2018 dhe 2019, një shumë më e ulët se ato të fqinjëve rajonalë dhe që kryesisht shkon për paga dhe mëditje të personelit arsimor. Për shkak të pjesës së madhe të të rinjve në shoqëri, Kosova shpenzon vetëm 13% të të hyrave për kokë banori për secilin nxënës në arsimin fillor dhe të mesëm (mesatarja e BE-së sillet rreth 20%).[61]

Sistemi arsimor në Kosovë është i strukturuar sipas niveleve të ISCED dhe përfshin arsimin parashkollor (moshat 0-5 vjeç), parafillor (mosha 5 vjeç deri në fillore), arsimin fillor për klasat 1-5 (moshat 6-10), të mesëm të ulët për klasat 6-9 (mosha 11-14), të mesëm të lartë për klasat 9-12 (mosha 15-18), dhe arsimin i lartë që ofron programe bachelor 3-4 vjetore dhe master 1-2 vjetore. Arsimi i mesëm i lartë është i ndarë në gjimnaze dhe shkolla të arsimit profesional.[62][63]

FIGURA 2 Struktura e Sistemit Arsimor në Kosovë



Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2016), f. 20.

Në Kosovë karriera arsimore e fëmijëve e ka fillimin të vështirë, pasi ka vetëm 44 kopshte publike të shpërndara në 23 nga 38 komuna. Përkatësisht, shkalla e regjistrimit në parashkollor është e ulët. Meqenëse arsimi fillor dhe i mesëm i ulët janë të detyrueshëm në Kosovë, nivelet e regjistrimit janë relativisht të larta (shih Tabelën 1). Hendeku gjinor në regjistrim shfaqet gjatë arsimit të mesëm të lartë, pasi përqindja e femrave pa arsim të mesëm të lartë është 23.4% më e lartë se ajo e meshkujve, çka tregon nivele më të larta braktisjeje për vajzat sesa për djemtë e moshës

[59] OECD (2019). Rezultatet e PISA 2018 - Përmbledhje të Kombinuara Ekzekutive

[60] Banka Botërore (2018). Nëse Kosova vepron tani, fëmijët e saj të lindur sot mund të jenë më të shëndetshëm, më të pasur, më produktivë. Njoftim për Shtyp, 11 tetor 2018

[61] Banka Botërore (2017). Republika e Kosovës Diagnostikimi Sistematik i Vendit, f.104

[62] Aliu, L. (2018). Analiza e Sistemit Arsimor në Kosovë. Prishtinë: Fondacioni Friedrich-Ebert

[63] Komisioni Evropian (2017). Vështrim i përgjithshëm i sistemit të arsimit të lartë në Kosovë

15-18 vjeç.[64] Në përgjithësi vajzat dhe gratë janë të nënpërfaqësuara në të gjitha nivelet arsimore përveç gjimnazit dhe universitetit, ku ato përbëjnë përkatësisht 58% dhe 53% të trupave studentore.[65]

Arsimi në Kosovë kryesisht kryhet në shkollat publike. Në periudhën 2017/2018, 89% e të gjithë fëmijëve, nxënësve dhe studentëve frekuentuan institucionet arsimore publike. Pjesa më e lartë e frekuentimit në institucionet private është e regjistruar në nivelin universitar (36%).[66]

TABELA 1 Shkalla e regjistrimit dhe numri i institucioneve arsimore publike/private

	Shkalla e pjesëmarrjes neto	Numri i institucioneve arsimore publike	Numri i institucioneve arsimore private
Para-shkollor	15%	44	88
Para-fillor	83.8%		
Fillor	96.1%	927	10
I mesëm i ulët	93.7%		
I mesëm i lartë	86.8%	123	
Arsimi i Lartë		9	30

Burimi: Prezantimi i autorëve bazuar në Komisionin Evropian (2020), Agjencinë e Statistikave të Kosovës (2018), Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF (2020).

Kur flitet për zgjedhjen e drejtimit të arsimit të mesëm të lartë, arsimi dhe aftësimi profesional (AAP) shpesh konsiderohen si alternativa e dytë. Arsimi në gjimnaz dhe universitar konsiderohen më të vlefshëm për hyrjen në tregun e punës.[67] Për shumë nxënës, AAP-ja kthehet në mundësi vetëm nëse nuk i plotësojnë kriteret e hyrjes në gjimnaz. Në periudhën 2018/2019, rreth 50% e të gjithë nxënësve të nivelit të mesëm të lartë zgjodhën programet e AAP-së. Një pjesë e madhe e të diplomuarve nga AAP-ja (97%) i vazhdojnë studimet dhe regjistrohen në arsimin e lartë, çka tregon se kualifikimet e AAP-së kanë vlerë të ulët në tregun e punës. Në përgjithësi, sistemi i AAP-së në Kosovë ka nevojë për kurse më praktike dhe të aplikuara dhe bashkëpunim të mbështetur publikisht me subjektet e biznesit. Teksa shumica e mësimdhënësve në shkollat e AAP-së janë të kualifikuar, ka mangësi në zhvillimin e mëtejshëm profesional dhe materialin e mësimdhënies dhe të nxënit (shih Kapitullin IX).[68]

Kosova sapo ka filluar të zbatojë Kornizën e saj Kombëtare të Kualifikimeve, e cila është zhvilluar kryesisht në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK). KKK dhe AKK janë themeluar me Ligjin Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare. Procesi i zhvillimit të KKK-së ka filluar në 2009. Është aprovuar dhe botuar në vitin 2011. Në vitin 2017 u shqyrtua me mbështetjen e DVVI dhe në vitin 2020 u botua dhe aprovua një manual zbatimi.[69] AKK-ja ka përgjegjësinë e përgjithshme të zbatimit për KKK-në dhe është kryesisht përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve të arsimit dhe aftësimit profesional. Teksa Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve të arsimit të përgjithshëm, Agjencia për Akreditim e Kosovës (AAK) është përgjegjëse për kualifikimet

[64] Komisioni Evropian (2020)
[65] Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018). Statistikat e Arsimit në Kosovë
[66] Po aty.
[67] Aliu (2018)
[68] Komisioni Evropian (2020), f. 85.
[69] Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (2020). Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

e arsimit të lartë. Kosova nuk është pjesë e procesit të Bolonjës, por planifikon të anëtarësohet në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).[70]

Arritjet arsimore në Kosovë janë ende të lidhura me statusin socio-ekonomik dhe përkatësinë etnike. Të dhënat më të fundit nga MICS 2020 i UNICEF-it[71] tregojnë se fëmijët nga familjet më të pasura kanë më shumë gjasa të ndjekin programe arsimore në të gjitha nivelet. Hendeku mes niveleve të frekuentimit për fëmijët nga familjet më të varfra dhe më të pasura rritet me rritjen e niveleve të arsimit. Të dhënat sugjerojnë që vetëm 70% e fëmijëve nga kuintili më i varfër ndjekin arsimin e mesëm të lartë krahasuar me 96% nga kuintili më i pasur. Mosregjistrimi për fëmijët nga familje të cilat përcaktohen si të varfra është rreth 7% në arsimin fillor, me dallime në rritje në nivelet më të larta të arsimit. Ngjashëm me statusin socio-ekonomik të familjes, frekuentimi i shkollës, veçanërisht në nivelin e mesëm të lartë, lidhet me arritjet arsimore të nënave. Teksa 97% e fëmijëve nënat e të cilëve kanë kryer arsimin e lartë frekuentojnë shkollat e mesme të lartë, përqindja ulet në 87% për fëmijët nënat e të cilëve kanë kryer arsimin e mesëm të ulët.

Me zbatimin e PSAK 2017-2021, autoritetet kosovare bëjnë përpjekje për të rritur numrin e fëmijëve RAE në arsimin bazë dhe të mesëm përmes ofrimit të bursave, aktiviteteve të vetëdijesimit dhe krijimit të qendrave të të nxënit. Deri më tani ka 83 qendra të të nxënit që veprojnë në 20 komuna.[72] Është bërë përparim në lidhje me rritjen e qasjes në arsimin fillor për fëmijët nga komunitetet RAE. Teksa në vitin 2014[73] vetëm 68% e fëmijëve RAE (92% e të gjithë fëmijëve) frekuentuan klasën e parë të shkollës fillore (60% meshkuj, 76% femra), raporti i frekuentimit neto u rrit në 84% (96% e të gjithë fëmijëve) në vitin 2020. Sidoqoftë, ende ekziston një hendek në arsimin e mesëm të ulët, ku raporti i frekuentimit neto të fëmijëve RAE është 63.7% krahasuar me 93.7% të të gjithë fëmijëve. Shkalla e përfundimit të nivelit të mesëm të lartë për të rinjtë nga komunitetet RAE arrin 23.8% krahasuar me 87.2% tek të gjithë fëmijët.

Në vitin 2020 Kosova karakterizohet nga një strukturë relativisht e re e popullsisë, nivele të larta të papunësisë dhe pasivitetit, veçanërisht në mesin e grave, dhe për rrjedhojë të rinjtë janë të gatshëm ta lënë vendin për të gjetur një punë më të denjë jashtë vendit. Oferta e larmishme e programeve të të gjitha llojeve dhe formave të arsimit dhe të nxënit për të rritur, ka treguar që shkakton efekte pozitive të mirëqenies për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik. Siç u përmend më herët, të nxënit gjatë gjithë jetës rrit jo vetëm cilësinë e jetës shoqërore dhe pjesëmarrjen. Kështu ulen edhe pabarazitë shoqërore, pasi fëmijët e prindërve të arsimuar (më tej) marrin mbështetje më të mirë. Aftësimi i mëtejshëm për më tepër rrit produktivitetin ekonomik dhe fleksibilitetin e një vendi për t'iu përgjigjur nevojave të tregut të punës. Sidomos gratë mund të përfitojnë nga aftësimet e mëtejshme që ndërtojnë kapacitetet e tyre dhe rrisin vetëbesimin dhe vullnetin për pjesëmarrje. Kapitujt vijues eksplorojnë gjendjen e arsimit për të rritur në Kosovë nga këndvështrime të ndryshme për të nxjerrë konkluzione në lidhje me sfidat dhe potencialet për zhvillimin e Kosovës në të ardhmen.

[70] CEDEFOP (2019). Inventari Evropian i Kosovës në KKK 2018

[71] Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF-i (2020).

[72] Mehmeti, S. et al. (2019). Vlerësimi afatmesëm: Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017 - 2021 Prishtinë: KEEN, f. 16ff

[73] Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF-i (2014). 2013-2014 Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë* Anketa e Grupimeve me Tregues të Shumëfishtë, Raport Përmbledhës

III. Zhvillimi historik i NARr-it në Kosovë

Pas Luftës së Dytë Botërore, si pjesë e ish Jugosllavisë, Kosova kishte një strukturë të ngjashme arsimore me vendet fqinje, përfshirë arsimin për të rritur. Sistemi arsimor përbëhej nga arsimi fillor, arsimi i mesëm dhe universiteti për të rinjtë nga mosha 18 vjeç.[74] Nga vitet 1970 e tutje, arsimi në Kosovë ofrohej zyrtarisht në tri gjuhë (serbisht, shqip dhe turqisht) dhe fëmijët me prejardhje të ndryshme etnike mësonin në të njëjtat objekte. Arsimi për të rritur në Kosovë ofrohej në "shkollat e natës, njësitë e arsimit për të rritur në shkolla të rregullta dhe qendra arsimore në industri dhe ndërmarrje të tjera".[75]

Gjatë viteve 1980, me vdekjen e Titos dhe fillimin e regjimit të Millosheviçit, shqiptarët e Kosovës u diskriminuan gjithnjë e më shumë.[76] Vazhdimësia relative në arsim u ndërpre në periudhën mes viteve 1990 dhe 1999, kur autoritetet serbe i dëbuan shqiptarët nga pjesë të mëdha të sistemit arsimor formal për arsye politike. Arsimi për shqiptarët, veçanërisht në nivelet e arsimit të mesëm dhe të lartë, duhej të organizohej në shkolla dhe shtëpi private.[77] Fakti që vetëm serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera (turqit dhe boshnjakët) iu lejohej qasja në arsim në objektet publike krijoi të ashtuquajturin "sistem paralel të arsimit". Sistemi paralel i arsimit u vetëfinancua kryesisht nga diaspora e shqiptarëve të Kosovës.[78] Nuk ka informacion në dispozicion në lidhje me ofrimin e arsimit joformal dhe arsimit për të rritur gjatë asaj periudhe.

Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, Kosova përjetoi një periudhë të ndryshimeve të rëndësishme sociale, ekonomike dhe politike, të cilat patën ndikim të madh në sistemin e arsimit, përfshirë arsimin për të rritur. Vendi duhej të përballej me shkatërrimin e luftës dhe kishte mungesë të strukturave funksionuese të qeverisjes. Struktura e përbashkët e përkohshme administrative nën kujdesin e UNMIK-ut e centralizoi sistemin arsimor kosovar. Me zgjedhjet e para kombëtare u krijuan institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dhe disa kompetenca në lidhje me menaxhimin e arsimit u transferuan në komuna, për shembull administrimi i objekteve arsimore (shih gjithashtu Kapitullin II). Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm, i miratuar në 2002, ishte akti i parë i legjislacionit që u miratua.[79] Ligji nuk e përshkruan të nxënit e të rriturve si të tillë, por përfshiu ofrimin e arsimit bazë dhe rrjedhimisht edhe ofrimin e arsimit kompensues dhe arsimit profesional.

Sistemi arsimor i pasluftës ishte qartësisht i orientuar drejt zhvillimit të një politike themelore arsimore dhe krijimit të një strukture qeverisëse, duke përfshirë zhvillimin e infrastrukturës shkollore, ringjalljen e rrjetit institucional dhe gjithashtu zhvillimin e një koncepti të ri arsimor dhe një

[74] Llunji, V. (2013). Sfidat e arsimit për të rritur në Kosovë

[75] Po aty, f. 3.

[76] Llapi, G. & Peterson, C. (2015). Arsimi i ndërprerë: Kosova 1980-1999. Punim i prezantuar në Para-Konferencën Ndërkombëtare (të 64-t, Oklahoma City, OK, 15-17 nëntor 2015) të Komisionit për Arsimin Ndërkombëtar për të Rritur (CIAE).

[77] Kastrati, A. (2016). Roli i arsimit për formimin e identitetit mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës: Zbatimi i qasjes së verbër ndaj dallimeve për vendosjen e regjimit të shtetësisë në një shoqëri multi-kulturore. *Gazeta Evropiane e Shkencave Sociale, Edukimit dhe Hulumtimit, 3 (1), f. 146-153*

[78] Llunji, V. (2013)

[79] Kuvendi i Republikës së Kosovës (2002). Ligji Nr. 2002/2 për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë. Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Nr. 8, 15 dhjetor 2006, Prishtinë

kornize të kurrikulës bërthamë. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe Agjencisë Daneze për Zhvillim Ndërkombëtar (DANIDA), themeloi Qendrat e Aftësimit Profesional në shtatë rajone të Kosovës për të ofruar aftësim për të rritur për punëkërkuesit e regjistruar, të cilat veprojnë prej vitit 2000.[80] Në këtë fazë, arsimi për të rritur nuk ishte i rregulluar dhe ishte i organizuar kryesisht me iniciativa të ofruesve privatë dhe organizatave joqeveritare (OJQ). Ofrimi i arsimit për të rritur nga ofruesit privatë kryesisht targetonte plotësimin e kërkesave të ekonomisë së tregut duke kualifikuar dhe rikualifikuar të rriturit, ndërsa sektori i OJQ-ve u përqendrua kryesisht në edukimin qytetar.

Në vitin 2005 u zhvillua një strategji për arsimin për të rritur, që mbulon periudhën dhjetë vjeçare mes 2005 dhe 2015, me qëllim që të mbështetej zhvillimi ekonomik i vendit dhe të ulej varfëria duke rregulluar dhe përmirësuar ofrimin e ARr-së. Sidoqoftë, për shkak të mungesës së partneritetit shoqëror, burimeve të pamjaftueshme financiare dhe angazhimit të pamjaftueshëm të MASHT-it për ta mbështetur këtë sektor, strategjia nuk rezultoi në zbatim të kënaqshëm të aktiviteteve.[81]

Që në vitin 2005, vetëqeverisja e përkohshme miratoi Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve[82] duke synuar të rregullojë ofrimin e arsimit për të rritur, duke përfshirë të nxënit kompensues dhe aftësime të tjera për të rriturit, të cilat nuk ishin rregulluar ende me ligjet për arsimin fillor dhe të mesëm, arsimin e lartë dhe arsimin dhe aftësimin profesional. Edhe pse ligji përcaktonte qëllimin për të promovuar të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë individët, në këtë aspekt ai ka dështuar. Ligji ka përshkruar një kornizë për të përmbushur ekskluzivisht nevojat e Ministrisë së Arsimit në lidhje me të nxënit e të rriturve. Ai nuk ka arritur të parashikojë nevoja të ndryshme të të rriturve në shoqëri, siç janë zhvillimi kulturor dhe shoqëror, demokracia, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, toleranca dhe mirëkuptimi, si parakushte thelbësore për përfshirjen në transformimin demokratik, shoqëror dhe ekonomik. Për më tepër, programet joformale të ofruara nga ministritë e tjera nuk ishin të rregulluara me këtë ligj.

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, i miratuar në të njëjtin vit me Ligjin për ARr, synonte rregullimin e sistemit të arsimit dhe aftësimit profesional formal në përputhje me nevojat e vendit për zhvillim ekonomik dhe social, përfshirë ndryshimet ekonomike dhe teknologjike, kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e individëve, duke optimizuar përdorimin e burimeve financiare, njerëzore dhe të infrastrukturës gjatë tranzicionit drejt një ekonomie tregu. Kjo kornizë nuk parashikonte rregullimin e ofrimit të AAP-së joformale.

Në vitin 2008, me shpalljen e pavarësisë, vendi ishte i etur për ta zhvilluar kornizën e vet kushtetuese dhe legjislative për të përmbushur kryesisht parimet dhe standardet thelbësore evropiane. Në sektorin e arsimit për të rritur, zhvillimi është ndikuar kryesisht nga qëllimet e specifikuara në Strategjinë e Lisbonës, Deklaratën e Kopenhagës dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve që synonin të rrisnin cilësinë në AAP, për t'u mundësuar individëve të fitojnë shkathtësitë e nevojshme për tregun e punës dhe, më e

[80] Intervistë me përfaqësues të MPMS-së

[81] Intervistë me ekspert të ARr-së

[82] Kuvendi i Republikës së Kosovës (2005). Ligji Nr. 02/L-24 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur

rëndësishmja, ta bëjnë të nxënit gjatë gjithë jetës një mjet për të mbështetur punësimin e tyre. Në përgjithësi, në sektorin e arsimit, prioritetet u zhvendosën nga infrastruktura në rritjen e cilësisë së arsimit dhe aftësimit.

Prandaj, ishte e nevojshme të përmirësohej korniza e politikave dhe legjislacionit dhe të kalohej drejt një forme të strukturës së drejtimit në shumë nivele në arsim. Në vitin 2008, u miratua Ligji për Kualifikimet Kombëtare[83] dhe që nga ajo kohë ai ka shërbyer si një mjet kryesor i reformës në arsim dhe aftësim në Kosovë, përfshirë ARr-në. Ai ka krijuar KKK-në si mekanizëm kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve. Për më tepër, ai futi qasjen e rezultateve të të nxënit në të gjitha nivelet e arsimit, një sistem kreditesh në AAP, njohjen e të nxënit paraprak (NjNP) dhe sigurimin e cilësisë së AAP-së.

Duke synuar arritjen e arsimit gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e cilësisë së ofrimit të arsimit dhe aftësimit, qeveria e Kosovës, në koordinim me MASHT-in dhe me angazhimin e të gjithë palëve të tjera relevante të interesit, ka hartuar dhe aprovuar Planin e parë Strategjik të Arsimit të Kosovës që mbulon periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2016. Procesi është mbështetur në mënyrë thelbësore nga komuniteti ndërkombëtar. Plani ka mbështetur një qasje zhvillimore në të gjithë sektorin duke përshkruar analizat, sfidat, objektivat strategjikë, aktivitetet dhe rezultatet e pritura në tetë programe kryesore prioritare. Arsimi për të rritur ishte një nga tetë prioritetet. Objektivi i përgjithshëm i ARr-së ishte të sigurohet arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë, përfshirë grupet më të pafavorizuara, në bashkëpunim me shoqërinë civile, në mënyrë që të rriturit të pajisen me njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme. Rishikimi i Ligjit për arsimin për të rritur deri në vitin 2016 ishte një nga synimet.

Andaj, siç përshkruhet në PSAK dhe me qëllim që të harmonizimit me kërkesat e KKK-së, Ligji për AAP dhe Ligji për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve u rishikuan dhe miratuan nga Kuvendi në vitin 2013. Përkundër iniciativës për ta përmirësuar situatën e ARr-së në Kosovë, ligji i rishikuar nuk i instaloi parakushtet e nevojshme për të krijuar një sistem holistik të arsimit për të rritur që do të mundësonte përparimin individual, përmirësimin e cilësisë së jetës, nxitjen e krijimtarisë dhe inovacionit mes nxënësve të rritur, dhe do të mundësonte marrjen e njohurive dhe zhvillimin e shkathtësive për të arritur ndryshime ekonomike, teknike dhe teknologjike, kulturore dhe sociale. Ai e mbulon ARr-në vetëm pjesërisht dhe plotëson nevojat themelore të arsimit të rregulluar për të rritur (si formal ashtu edhe joformal), ngjashëm me ligjin e mëparshëm (shih gjithashtu Kapitullin IV).

Iniciativa të mëtejshme u ndërmorën për ta përmirësuar administrimin e ARr-së duke rritur përfshirjen e palëve të interesit në nivele të ndryshme për hartimin dhe zbatimin e politikave. Në këtë drejtim, u krijuan një numër agjencish ekzekutive dhe bordesh të ndryshme këshillimore si: AKK-ja, AAAPARr-ja, Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (KAAPARr) dhe APRK-ja.

Kapitulli vijues i përshkruan në më shumë detaje politikën dhe peisazhin institucional të arsimit për të rritur në Kosovë.

[83] Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008). Ligji Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare

IV. Strukturat drejtuese dhe korniza ligjore

Strukturat drejtuese

Struktura drejtuese e arsimit për të rritur në Kosovë është mjaft komplekse. Detyrat dhe përgjegjësitë janë të ndara mes disa palëve të interesit në nivelin qendror dhe lokal.

Institucioni kryesor përgjegjës për mbikëqyrjen e arsimit për të rritur në Kosovë është **Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**. Ajo mbikëqyr planifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e politikave të arsimit për të rritur. Për më tepër, MASHT-i është përgjegjëse për zhvillimin e kurrikulave të AAP-së dhe ARr-së, aftësimin e mësimdhënësve në shërbim dhe monitorimin e cilësisë së ofrimit të arsimit. MASHT-i është gjithashtu përgjegjës për listimin e ofruesve privatë të AAP-së dhe ARr-së dhe administrimin e provimit të maturës shtetërore. Kohët e fundit, në departamentin e AAP-së është themeluar një divizion për të nxënit gjatë gjithë jetës. Sidoqoftë, përkundër Ligjit specifik ekzistues për arsimin për të rritur, ARr-ja mbetet pa departament të veçantë në ministri dhe trajtohet si pjesë e AAP-së ose arsimit kompensues për të rritur.

Misioni i **Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve** (MKRS) është të fuqizojë të rinjtë dhe të krijojë një mjedis mbështetës për zhvillimin e tyre shoqëror dhe personal. Qëllimi është krijimi i mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje të të rinjve në jetën aktive shoqërore, dhe ofrimi i shërbimeve të cilat mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore, duke respektuar karakteristikat individuale të të rinjve.

Përpjekjet për arsimin për të rritur në sektorin e arsimit plotësohen me aktivitetet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. MPMS-ja është përgjegjëse për zhvillimin e politikave të punësimit dhe aftësimit në vend. Ajo zhvillon dhe monitoron zbatimin e masave të tregut aktiv të punës për punëkërkuesit e papunë.

Në nivelin lokal, **Departamentet Komunale të Arsimit (DKA)** janë përgjegjëse për të menaxhuar shkollat e AAP-së përfshirë rekrutimin e stafit, administrimin e objekteve arsimore, administrimin e buxhetit të shkollave, pagimin e pagave, dhe ndërtimin e kapaciteteve të mësimdhënësve, instruktorëve dhe administratorëve.

Inspektorati Shtetëror i Arsimit është përgjegjës për inspektimet pedagogjike dhe administrative të ofruesve publikë dhe privatë të AAP-së. Sidoqoftë, funksionimi i tij pengohet nga numri i kufizuar i inspektorëve në të gjithë vendin.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është një agjenci e pavarur nën mbikëqyrjen e MASHT-it. Ai është përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm strategjik të KKK-së, duke përfshirë zhvillimin e politikave në lidhje me llojet e kualifikimeve, sistemin e krediteve dhe njohjen e të nxënit paraprak. Veç kësaj, ai menaxhon sigurimin e cilësisë së pjesës të AAP-së të KKK-së, çka përfshin verifikimin e standardeve të punës, validimin, aprovimin dhe regjistrimin e kualifikimeve, si dhe akreditimin dhe monitorimin e ofruesve për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar kualifikimet e

lartpërmendura. Po kështu, në lidhje me NjNP-në, përveç zhvillimit të politikës së përgjithshme për KKK-në, ai mbulon sigurimin e cilësisë së NjNP-së në AAP, posaçërisht akreditimin dhe monitorimin e ofruesve për ta zbatuar NjNP-në në kualifikimet e AAP-së.

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur është përgjegjëse për administrimin dhe drejtimin e Institucioneve publike për Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (IAPARr) në lidhje me burimet financiare dhe njerëzore, si dhe objektet dhe infrastrukturën në përputhje me legjislacionin. Aktualisht, AAAPARr-ja mbikëqyr gjashtë Qendra të Kompetencës, por asnjë shkollë të AAP-së. Veç tyre, nën përgjegjësinë e saj janë edhe koordinimi i studimeve në lidhje me AAP-në dhe ARr-në dhe angazhimi i partnerëve socialë në AAP dhe ARr. Megjithatë, deri më tani kanë munguar rezultatet domethënëse.

Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin për të Rritur është një organ këshillimor trepalësh i përbërë nga përfaqësues të ministrive relevante, ofruesve të AAP-së dhe partnerëve socialë. Një funksion kryesor i KAAPARr është të sigurojë këshilla për Ministrin e Arsimit për politikat e AAP-së dhe ARr-së. Veç kësaj, ai aprovon standardet e punës në nivelin kombëtar, duke përcjellë procesin e verifikimit nga AKK-ja.

Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës ofron aftësim profesional për punëkërkuesit e regjistruar si pjesë e masave të tyre të tregut aktiv të punës. Aftësimi ofrohet në shtatë qendra të aftësimit profesional në mbarë vendin. QAP-të rajonale ofrojnë aftësime në profile të ndryshme profesionale, që variojnë nga 20 ditë në 6 muaj. Këto aftësime ofrohen falas. Në qendrat e tyre ofrohet edhe NjNP-ja.

Partnerët socialë ishin plotësisht të përfshirë në hartimin e politikave kombëtare dhe dispozitave ligjore. Ata janë pjesë e organeve drejtuese të lidhura me AAP-në dhe ARr-në siç janë: AKK, AAAPARr, KAAPARr dhe shkollat. Për më tepër, ata janë përgjegjës për zhvillimin e standardeve të punës: standardet e punës janë pikënisje për përcaktimin e kualifikimeve dhe rrjedhimisht zbatimin e validimit në AAP. Sidoqoftë, rezultatet mbeten të dobëta kur flitet për zbatimin e politikave dhe përfshirjen e tyre të drejtpërdrejtë në ofrimin e arsimit.

Ligjet

Siç është treguar në Kapitullin I, arsimi për të rritur në Kosovë është i lidhur ngushtë me arsimin dhe aftësimin profesional. Deri më tani AAP-ja dhe arsimi për të rritur në Kosovë rregullohen nga një infrastrukturë solide ligjore e cila përfshin ligjet e mëposhtme:

Ligji Nr.04/L-032 - 2011 për Arsimin Para-Universitar

Ligji Nr. 04/L-138 – 2013 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional

Ligji Nr. 04/L-143 – 2013 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur

Ligji Nr. 03/L-068 – 2008 për Arsimin në Komuna

Ligji Nr. 03/L-060 – 2008 për Kualifikimet Kombëtare

Ligji Nr. 03/L-018 – 2008 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore

Ligji për Arsimin Parauniversitar[84] përshkruan qëllimet dhe parimet kryesore të ofrimit të arsimit parauniversitar në Kosovë, si dhe përgjegjësitë e nivelit qendror, komunal dhe shkollor në fushat e planifikimit, ofrimit dhe monitorimit të arsimit publik. Qëllimi i këtij ligji është të "rregullojë arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga nivelet ISCED 0 deri në 4, përfshirë arsimin dhe aftësimin për fëmijët dhe të rriturit që marrin kualifikime në këto nivele". Arsimi për të rritur i rregulluar nga ky ligj supozohet të jetë sipas niveleve 3 deri 4 të ISCED. Ai parashikon arsim profesional dhe për të rritur për personat e rritur dhe të rinj mbi moshën pesëmbëdhjetë vjeç, të cilët plotësojnë kërkesat për të ndjekur kurrikulat e arsimit për të rritur. Dispozitat për arsimin dhe aftësimin për të rritur, siç janë qëllimi i tij, ofrimi, kurrikulat dhe fondet, përcaktohen në nenin 12. Neni përcakton se qëllimi i arsimit dhe aftësimit për të rritur është t'u sigurojë të rriturve njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme sipas kornizës së të nxënit gjatë gjithë jetës. Ai përcakton nevojën për një akt nënligjor për t'i përcaktuar më tej kurrikulat, vlerësimin, kohëzgjatjen e arsimit, kriteret dhe tarifat e regjistrimit, kriteret specifike për licencimin dhe financimin e ofruesve të ARr-së dhe kualifikimin e stafit të mësimdhënies.

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional[85] përcakton parimet kryesore për sektorin e AAP-së në Kosovë. Ato përfshijnë krijimin e lidhjeve me tregun e punës, si dhe gjithëpërfshirjen, qasjen dhe zhvillimin e arsimit dhe aftësimit profesional si pjesë e integruar e të nxënit gjatë gjithë jetës. Më tej, me krijimin e KAAPARr-it dhe AAAPARr-së në nivel kombëtar dhe bordeve trepalëshe drejtuese në nivelin e ofruesit, ai mbështet dialogun social mes AAP-së dhe partnerëve socialë në nivel kombëtar dhe të ofruesve. Vlerësimi i Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës (2011-2016)[86] ka konkluduar se ekziston nevoja për rregullim më të mirë të kornizës kurrikulare për AAP-në, autonominë financiare të shkollave, praktikat dhe aftësimin e mësimdhënësve.

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur përfshin arsimin formal, joformal dhe informal të personave mbi moshën 15 vjeç. Ligji përshkruan përgjegjësitë, fushëveprimin, ofrimin (përfshirë ofruesit, kandidatët, regjistrimin e kandidatëve, vlerësimin, certifikimin dhe programet/kualifikimet), sigurimin e cilësisë, validimin e të nxënit informal dhe joformal, administrimin dhe financimin e ofrimit të arsimit për të rritur në Kosovë. Prandaj, arsimi dhe aftësimi për të rritur mund të organizohet dhe sigurohet nga institucione publike, private, publike-private, shoqëri, ndërmarrje, organizata joqeveritare dhe persona fizikë. Ekziston një dallim i qartë mes ofrimit të ARr-së formale dhe joformale ose informale kur flitet për sigurimin e cilësisë: të gjithë ofruesit formalë të ARr-së duhet të regjistrohen dhe licencohen nga MASHT-i. Sidoqoftë, ofruesit joformalë që ofrojnë programe që çojnë drejt kualifikimit sipas KKK-së, duhet të akreditohen nga AKK-ja para se të licencohen nga MASHT-i. Kur flitet për financimin, arsimi kompensues për të rritur për nivelet 1 dhe 2 të ISCED është falas (shih Kapitullin V për më shumë informacion në lidhje me financimin e arsimit për të rritur në Kosovë).

[84] Kuvendi i Republikës së Kosovës (2011). Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17, 16 shtator 2011, Prishtinë

[85] Kuvendi i Republikës së Kosovës (2013a)

[86] Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2015). Raporti i Vlerësimit – Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016

Ligji për Arsimin në Komuna ua jep përgjegjësinë komunave kur flitet për arsimin parauniversitar, përfshirë AAP-në. Ai përcakton kompetencat që kanë komunat në lidhje me administrimin, financat dhe rekrutimin e stafit dhe zhvillimin e kapaciteteve në kuadër të shkollave.

Ligji për Kualifikimet Kombëtare përcakton objektivat dhe strukturën e KKK-së. Për më tepër, ai përcakton strukturën drejtuese si një organ me shumë palë interesi përgjegjës për zhvillimin strategjik të KKK-së. Zbatimi i KKK-së është i ndarë mes një numri institucionesh në varësi të sektorit të arsimit, p.sh. arsimi dhe aftësimi i përgjithshëm, i lartë dhe profesional. AKK-ja është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së pjesëve të AAP-së dhe ARr-së të KKK-së, me funksionet e mëposhtme: validimi dhe aprovimi i kualifikimit, akreditimi institucional i ofruesve të AAP-së, dhe sigurimi i cilësisë së certifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve. Objektivat e ligjit janë përmirësimi i njohjes së kualifikimeve në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit formal dhe joformal, për të siguruar që kualifikimet i plotësojnë nevojat e tregut të punës, rregullimi i kualifikimeve, vlerësimit dhe certifikimit, në bazë të cilësisë dhe standardeve, përmirësimi i qasjes në vlerësim, duke përfshirë njohjen e të nxënit paraprak, bërja e sistemit të kualifikimeve fleksibël dhe transparent, si dhe përmirësimi i mundësive për përmirësim dhe transferim për të gjithë.

Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore[87] rregullon qëllimin, përmbajtjen, kriteret dhe administrimin e provimit përfundimtar të Maturës shtetërore për nxënësit që mbarojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe nxënësit që vijnë nga shkollat e AAP-së. Neni 5 u jep kandidatëve nga arsimi për të rritur të drejtën që të marrin pjesë në provim. Pragu kalues i provimit të Maturës është 40%. Kalimi i provimit u lejon nxënësve të vazhdojnë rrugën e tyre arsimore në institucionet e arsimit të lartë.

Ligji për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës themelon Agjencinë e Punësimit, e cila vepron nën kornizën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ai përcakton rolin dhe funksionin e saj kundrejt zbatimit të politikave të punësimit, tregut të punës dhe aftësimit të zhvilluara nga MPMS-ja.

Strategjitë dhe politikat

Ekzistojnë një numër strategjish dhe politikash që formësojnë ofrimin e ARr-së në Kosovë. **Strategjia Kombëtare për Zhvillim** 2016-2021[88] paraqet vizionin e Kosovës për rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm, dhe përshkruan politikat dhe masat qeveritare për ta arritur këtë vizion. Kapitulli “Kapitali Njerëzor” përcakton nevojën për të përmirësuar lidhjet mes ofrimit të arsimit dhe kërkesave të tregut të punës duke zhvilluar një Sistem Kombëtar të Parashikimit të Shkathtësive dhe kualifikimeve të rezultateve të të nxënit bazuar në standardet profesionale. Qëllimi kryesor është të zhvillohet një fuqi pune e kualifikuar, kompetente dhe fleksibile, e cila është në gjendje të konkurrojë në tregjet e punës kombëtare, rajonale dhe globale. Shërbimet dhe institucionet e të nxënit gjatë gjithë jetës përmenden si aktorë kyç përveç shkollave të AAP-së dhe shërbimeve të punësimit.

[87] Kuvendi i Republikës së Kosovës (2015). Ligji Nr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 2, 8 janar 2016, Prishtinë

[88] Qeveria e Republikës së Kosovës (2016). Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH)

Në vitin 2016, Qeveria e Kosovës miratoi **Planin e dytë Strategjik të Arsimit të Kosovës.**[89] PSAK është udhërrëfyesi kryesor për zhvillimin e sektorit të arsimit për periudhën 2017-2021. Ai përcakton prioritetet kryesore të sistemit arsimor që përfshijnë përmirësimin e modelit të drejtimit të arsimit, arsimin gjithëpërfshirës dhe cilësor, sigurimin e cilësisë bazuar në standardet e BE-së, aftësimin e mësimdhënësve dhe menaxherëve, përafrimin e arsimit dhe aftësimit profesional me nevojat e tregut të punës, dhe rritjen e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë. Për sa i përket AAP-së dhe arsimit për të rritur, fokusi është në përmirësimin e relevancës së programeve shkollore për nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin e kapaciteteve për menaxhimin e arsimit për të rritur.

Strategjia Kombëtare Sektoriale për Punësimin 2018-2022 bazohet në programin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe kapitullin për Kapitalin Njerëzor, si dhe në objektivat e vendosura nga MPMS-ja. Ajo mbështet qartësisht masat për të rritur punësimin përmes masave të tregut aktiv të punës (MTAP). Një sërë objektivash dhe masash synojnë të përmirësojnë qasjen gjithëpërfshirës në punë përmes ofrimit të aftësimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit, nxitjes së vetë-punësimit përmes politikave efektive të tregut të punës, dhe promovimit të përfshirjes dhe kohezionit social. Janë zhvilluar dhe aprovuar edhe plani përkatës i veprimit, si dhe mjetet e monitorimit dhe vlerësimit.[90]

Strategjia Kombëtare për Rininë 2019-2023[91] synon të zhvillojë dhe koordinojë politikat ndër-sektoriale për të rinjtë në arsim, punësim, shëndetësi, kulturë, dhe të përmirësojë pjesëmarrjen e të rinjve në jetën shoqërore dhe proceset e vendimmarrjes. Një nga objektivat kryesorë strategjikë është promovimi i punësimit të të rinjve përmes zhvillimit të arsimit joformal dhe të nxënit informal. Kjo përfshin mbështetjen e organizatave rinore që ofrojnë aktivitete të arsimit joformal dhe aktivitete të vetëdijesimit për promovimin e arsimit joformal.

Plani i veprimit për rritjen e punësimit të të rinjve 2018 - 2021[92] është një plan tre vjeçar ndër-sektorial për të rritur punësimin dhe për të përmirësuar punësueshmërinë e të rinjve. Ai synon të rrisë qasjen e tyre në tregun e punës përmes ofrimit të shërbimeve cilësore të punësimit (udhëzime për karrierën dhe shërbime këshillimi), masave të punësimit aktiv dhe zhvillimit të ndërmarrësisë. AAP-ja supozohet të harmonizohet më nga afër me kërkesat e tregut të punës, si dhe synohet të rritet cilësia e të nxënit praktik në shkollë dhe praktika profesionale jashtë shkollës.

Për të rritur përfshirjen sociale të komuniteteve të margjinalizuara në shoqëri, qeveria ka zhvilluar **Strategjinë dhe Planin e Veprimit për përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë e Kosovës 2017-2021**[93]. Aty përshkruhen objektivat dhe masat kryesore të politikës në fushën e arsimit, punësimit, mirëqenies

[89] Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2016)

[90] Qehaja, L. (2019). Zbatimi i Strategjisë Sektoriale të MPMS-së në vitet 2018 dhe 2019 - Raporti i Vlerësimit Afatmesëm. Prishtinë: KEEN

[91] Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (2019). Strategjia për Rininë 2019-2023

[92] Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (2017). Plani i veprimit: Rritja e Punësimit të të Rinjve 2018-2020

[93] Qeveria e Republikës së Kosovës (2017). Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021

sociale, shëndetit dhe strehimit. Përmirësimi i qasjes në aftësimin profesional dhe punësimin dhe rritja e niveleve të pjesëmarrjes në arsim për komunitetet Rom dhe Ashkali, janë ndër masat e përshkruara në strategji.

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve[94] është mjeti kryesor i reformës kur flitet për të gjithë sistemin arsimor në Kosovë, pasi lidh ofrimin e arsimit me nevojat e tregut të punës. Ajo është miratuar në vitin 2011 nga bordi drejtues i AKK-së dhe është plotësisht funksionale që nga ajo kohë. KKK përfshin një kornizë me tetë nivele të bazuar në rezultatet e të nxënit që synojnë të përfshijnë kualifikimet dhe modulet (pjesët e kualifikimit) të fituara në të gjitha llojet e konteksteve të të nxënit, formale, joformale dhe informale. Ajo përfshin të nxënit gjatë gjithë jetës si parimin kryesor udhëzues duke i mundësuar individit të përparojë horizontalisht dhe vertikalisht përgjatë niveleve të KKK-së. Për më tepër, KKK-ja lehtëson akumulimin dhe transferimin e rezultateve të të nxënit duke u bashkangjitur kualifikimeve një sistem kreditesh.

KKK-ja aprovon dhe regjistron 5 lloje të kualifikimeve si më poshtë:

1. Kualifikimet e Arsimit të Lartë: dizajnuar bazuar në parimet e Kornizës së Bolonjës
2. Kualifikimet e Arsimit të Përgjithshëm: të dizajnuara sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës
3. Kualifikimet e Kombinuara Kombëtare: module të kombinuara bazuar në Standardet Kombëtare Profesionale me rezultatet që lidhen me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës
4. Kualifikimet Kombëtare Profesionale: hartuar bazuar në Standardet Kombëtare Profesionale
5. Kualifikimet e bazuara në Standardet Ndërkombëtare: të dizajnuara në bazë të standardeve të njohura ndërkombëtarisht të cilat (ende) nuk janë miratuar si standarde kombëtare në Kosovë
6. Kualifikimet e Përshtatura: të dizajnuara në përputhje me nevojat operacionale të një organizate, agjencie ose ndërmarrjeje të veçantë.

Kualifikimet Kombëtare Profesionale, Kualifikimet e bazuara në Standarde Ndërkombëtare dhe Kualifikimet e Përshtatura targetojnë të rriturit që janë të gatshëm të fitojnë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca profesionale të lidhura me një profesion specifik ose rol pune. Ato kanë një diapazon të vlerave të krediteve sipas Sistemit Evropian të Krediteve për Arsim dhe Aftësim Profesional (ECVET) sipas moduleve që përbëjnë kualifikimin. Ofrimi bëhet nga një spektër ofruesish të ndryshëm të akreditуar, të cilët i vlerësojnë dhe certifikojnë kandidatët në mënyrë që të marrin kualifikimet e lartpërmendura.

KKK-ja është lidhur me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve në vitin 2016 duke hartuar dhe prezantuar një raport referimi tek Grupi Këshillëdhënës i KEK-ut. Kjo mundësoi transparencën dhe lehtësoi krahasimin e kualifikimeve të regjistruara në KKK me sisteme dhe kontekste të ndryshme të kualifikimeve në vendet e BE-së.

Sigurimi i cilësisë së kualifikimeve

Para se një kualifikim të aprovohet dhe regjistrohet në KKK, ai duhet t'i nënshtrohet një procesi të validimit dhe regjistrimit përmes një organi rregullator përkatës në varësi të llojit të kualifikimit. Kualifikimet e AL-së akreditohen nga Agjencia për

[94] Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (2020)

Akreditim të Arsimit të Lartë të Kosovës, ndërsa kualifikimet e tipit AAP (Kualifikimet Kombëtare Profesionale, Kualifikimet bazuar në Standarde Ndërkombëtare dhe Kualifikimet e Përshtatura) validohen, aprovohen dhe regjistrohen nga AKK-ja. Po kështu, institucionet ose ofruesit që synojnë të ofrojnë çdo lloj kualifikimi të KKK-së, duhet të plotësojnë disa kritere të cilësisë. Të gjithë ofruesit (publik dhe privat) duhet të akreditohen, institucionet e AL-së nga AAALK-ja dhe ofruesit e AAP-së nga AKK-ja. Ofruesit privatë, në një hap të dytë, duhet të aplikojnë edhe për licencë nga divizioni i MASHT-it për arsim dhe aftësim privat. Një përjashtim nga sigurimi i cilësisë bëhet për kualifikimet e arsimit të përgjithshëm, pasi ato nuk i nënshtrohen akreditimit.

Të gjitha institucionet dhe ofruesit që dëshirojnë të kërkojnë validimin dhe aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e programeve të tyre, duhet të respektojnë procedurat e specifikuara në Udhëzimin Administrativ (UA) Nr. 35/2014. Për të aplikuar për procesin e vlerësimit të kualifikimeve të AAP-së dhe akreditimit duhet të përmbushen kriteret e mëposhtme: duhet të dorëzohet formati i kualifikimit (programi i studimit) me përmbajtjen e moduleve dhe rezultatet e të nxënit duhet t'i bashkëngjiten një sistemi të krediteve, si dhe duhet të bazohen në nevojat e tregut të punës (standardi profesional). Duhet të jenë vendosur procedurat e brendshme të sigurimit të cilësisë, si dhe burime të përshtatshme (njerëzore, financiare, pajisje teknologjike), një vizion strategjik dhe udhëheqje.

Kohëzgjatja e procesit të akreditimit, siç rregullohet nga UA, mund të zgjasë deri në 6 muaj pas datës së aprovimit nga Bordi Drejtues i AKK-së që e ka filluar procesin e akreditimit. Data e dorëzimit të kërkesës tek ekzekutivi i AKK-së nuk konsiderohet si fillimi i procesit.

Njohja e të nxënit paraprak

Një parakusht qendror për formimin e një shoqërie të vërtetë të të nxënit, është krijimi i një sistemi që u lejon individëve të dokumentojnë ato që kanë mësuar jashtë sistemit arsimor formal (që zakonisht dokumentohet zyrtarisht) që të jenë në gjendje ta përdorin për avancimin e karrierës së tyre dhe për arsim dhe aftësim të mëtutjeshëm.[95] Kjo duhet të përfshijë dokumentacionin e të nxënit të marrë në mënyra joformale dhe informale.

Njohja e të nxënit paraprak në Kosovë rregullohet nga Udhëzimi Administrativ Nr. 31/2014 për NjNP dhe kryhet në harmoni dhe pajtueshmëri me Rekomandimin e Këshillit Evropian për Validimin e të Nxënit Joformal dhe Informal (VANJFI).[96] Kjo mbështet zbatimin e Rekomandimit për Drejtimet e Rritjes së Kualifikimeve të Këshillit Evropian duke mundësuar hyrjen në arsimin e mëtejshëm për: të rritur me shkathtësi të ulëta, të rritur që dëshirojnë të kthehen në mësim, punëkërkues që kërkojnë njohjen e shkathtësive të fituara në punë ose në komunitetin e tyre, kandidatë që synojnë të përmirësojnë kualifikimet e tyre, kandidatë që kërkojnë të rikualifikohen, kandidatë që mbajnë certifikata që nuk njihen në shkallë vendi dhe që synojnë të marrin një kualifikim të vendosur në KKK.

Janë zhvilluar politikat udhëzuese dhe kornizat ligjore për njohjen e të nxënit paraprak

[95] Ueb faqja e CEDEFOP Projekti për validimin e të nxënit joformal dhe informal

[96] Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (2017). Politikat dhe procedurat për njohjen e të nxënit paraprak (NjNP) në Republikën e Kosovës, f. 11

nga arsimi i lartë dhe AAP-ja, duke përfshirë si AAP-në fillestare (IAAP) ashtu edhe AAP-në e vazhdueshme (AAPV), por jo për arsimin e përgjithshëm. Sidoqoftë, kur flitet për zbatimin, sektori i AAP-së, dhe posaçërisht i AAPV-së (aftësimi për të rritur), është prioritizuar në mënyrë që të mbështesë hyrjen e individëve në tregun e punës ose avancimin në këtë treg. Nga MASHT-i janë zhvilluar dhe nënshkruar disa akte nënligjore të nevojshme në vitin 2019 për të mundësuar zbatimin e NjNP-së posaçërisht për Kualifikimet Kombëtare Profesionale.

NjNP-ja është në përputhje me KKK-në dhe prandaj të nxënit paraprak mund të validohet vetëm brenda kornizës së kualifikimeve të aprovuara dhe të regjistruara në KKK. Rezultatet e të nxënit janë pikat referuese për NjNP-në dhe ato mundësojnë marrjen e kualifikimeve të pjesshme ose të plota. Procesi i NjNP-së përbëhet nga katër faza: identifikimi, dokumentimi, vlerësimi dhe certifikimi i rezultateve të të nxënit, të mbështetur nga udhëzimet dhe këshillimet e praktikuesve të NjNP-së, siç janë koordinatorët, mentorët dhe vlerësuesit e brendshëm dhe të jashtëm. NjNP-ja mund të zbatohet vetëm nga institucionet e akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Për t'u akreditуar për të zbatuar NjNP, institucionet duhet të përmbushin kritere specifike, siç janë praktikuesit e caktuar të validimit dhe mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë. Deri më sot, asnjë ofrues nuk është akreditуar për të zbatuar NjNP, veçse pak ofrues kanë aplikuar për të marrë akreditim.

Në shkurt 2020, Kosova ka qenë vendi i 11-të që ka dorëzuar raportin unik për validimin e Grupit Këshillimor të KEK-ut.[97] Raporti është vlerësuar si i qartë dhe ofron një strukturë të mirë nga diskutuesit.

Pasqyra e ligjeve, politikave dhe strukturave drejtuese në arsimin për të rritur tregon se zhvillimi i kapitalit njerëzor është fushë prioritare për qeverinë e Kosovës. Janë bërë shumë përpjekje për ta zhvilluar KKK-në, si dhe NjNP-në dhe procedurat e sigurimit të cilësisë, të cilat i bëjnë rezultatet e të nxënit transparente dhe u lejojnë nxënësve të përparojnë në nivele të ndryshme të KKK-së (madje edhe në mënyrë jo të vazhdueshme). Pavarësisht politikave ekzistuese dhe rregullimeve ligjore të vendosura, struktura e përgjithshme e drejtimit dhe ndërlidhja e ngushtë e arsimit për të rritur me AAP-në, duket se pengon zhvillimin e arsimit për të rritur si sektor i pavarur i arsimit. Ankorimi i arsimit për të rritur në AAP mbart rrezikun e lidhjes së arsimit për të rritur në mënyrë të njëanshme me aftësimin profesional, aftësimin fillestar dhe zhvillimin profesional. Deri më sot nuk është pranuar dhe shfrytëzuar plotësisht vlera e shtuar e arsimit joformal shtesë dhe aktiviteteve të të nxënit për zhvillimin personal, shoqëror dhe gjithashtu ekonomik nga këndvështrimi i të nxënit gjatë gjithë jetës.

[97] Shtetet Anëtare kishin mundësinë të paraqisnin një raport unik vullnetar mbi zbatimin prej tyre të aranzhimeve të validimit bazuar në Rekomandimin e vitit 2012 (Rekomandimi i Këshillit i 20 dhjetorit 2012 për validimin e të nxënit joformal dhe informal (2012/C 398/01)) për Grupin Këshillimor të KEK-ut deri në vitin 2018. Raportet vlerësohen nga kolegët e tjerë përfaqësues të dy vendeve të tjera anëtare, të ashtuquajturit diskutues.

V. Financimi

Arsimi për të rritur në Kosovë financohet nga një numër burimesh, siç janë buxheti publik, investimet e sektorit privat, sektori i shoqërisë civile, fondet e donatorëve dhe vetë nxënësit e rritur. Për nxënësit e rritur, arsimi bazë kompensues për të rritur (në nivelet KKK 1 dhe 2) është falas dhe shpenzimet mbulohen nga buxheti publik, siç thuhet në nenin 19 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur. Aftësimet për punëkërkuesit në QAP janë falas. Arsimi dhe aftësimi i mëtejshëm në institucionet e AAP-së duhet të mbulohet nga vetë nxënësit e rritur, ose aftësimi bashkëfinancohet nga punëdhënësi. Aktivitetet e arsimit joformal gjithashtu duhet të paguhen nga vetë nxënësit. Nëse ofruesit marrin mbështetje financiare nga donatorë ndërkombëtarë, programet mund të ofrohen me kosto më të ulët ose falas.

Financimi i arsimit publik

Kur flitet për financimin publik të arsimit për të rritur, për shpenzimet nuk ndahet një vijë e veçantë buxhetore dhe programet e arsimit për të rritur zakonisht planifikohen dhe buxhetohen si pjesë e ofertës së sektorëve të tjerë të arsimit dhe aftësimit. Në përgjithësi, arsimi për të rritur financohet si pjesë e arsimit të përgjithshëm dhe AAP-së. Mbledhja e të dhënave në lidhje me shifrat e sakta të shpenzuara në sektorin e arsimit për të rritur, është sfiduese. Për pasojë, kjo pjesë përqendrohet në përshkrimin e burimeve financiare në kuadër të organeve qeveritare përgjegjëse.

Në Kosovë arsimi parauniversitar financohet kryesisht nga buxheti publik. Granti arsimor planifikohet nga MASHT-i dhe bazohet në numrin e nxënësve në arsimin bazë dhe të mesëm. Buxheti publik u transferohet komunave bazuar në numrin e nxënësve për shkolla, dhe komunat e alokojnë buxhetin nëpër shkolla. Ekzekutimi i buxhetit të arsimit, përfshirë prokurimet dhe pagesat, është i vendosur në nivelin komunal.[98] Për shkak të menaxhimit joefikas financiar në komuna, buxheti i alokuar shpesh nuk arrin në shkolla. Megjithëse komunat kanë vija specifike buxhetore për arsimin, përfshirë atë të përgjithshëm dhe AAP, është shumë e zakonshme që buxheti të alokohet në vija të tjera buxhetore të mallrave dhe shërbimeve. Prandaj, në vend që të përdoret për nevojat e shkollave, buxheti përfundon duke u përdorur për nevojat e tjera komunale, si p.sh. infrastruktura.

Krahasuar me vendet e tjera të BE-së dhe në bazë të pjesës së madhe të të rinjve në popullsi, shpenzimet e qeverisë për arsimin mbeten në një nivel mjaft të ulët në Kosovë. Në vitin 2018, shpenzimet publike për arsimin arritën në 4.22% të BPV-së dhe 13.7% të shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë. Kjo pasqyron një rënie të lehtë krahasuar me vitet e mëparshme. Mesatarisht, qeveria shpenzoi 684 euro për nxënës në arsimin parauniversitar në vitin shkollor 2017/2018. Pjesa më e madhe e shpenzimeve publike ishte dedikuar për pagat e mësimdhënësve (rreth 90%). Sipas Rishikimit Afatmesëm të PSAK-ut, nuk ka asnjë ndryshim në shumat e shpenzuara për gjimnaze dhe shkolla profesionale, përkundër nevojës për shpenzime shtesë për mësim praktik në shkollat profesionale. Për më tepër, nuk ka buxhet të paraparë zyrtarisht për projekte të veçanta zhvillimore, siç janë zhvillimi i kurrikulës dhe zhvillimi i mësimdhënësve.[99]

Gjatë viteve të kaluara, buxheti për AAP është rritur pak. Shpenzimet për AAP si përqindje e shpenzimeve për arsim u rritën nga 8.5% në

[98] Qeveria e Republikës së Kosovës (2019). Procesi i Torinos 2018–2020 Kosova - Raporti Kombëtar, f. 71

[99] Mehmeti, S. et al. (2019), f. 55-56

2014 në 9.6% në 2017. Shpenzimet për AAP si përqindje e shpenzimeve qeveritare mbetën të qëndrueshme në 1.4%. Ngjashëm me arsimin e përgjithshëm, shpenzimet shtesë në sektorin e AAP-së u janë atribuuar pothuajse tërësisht pagave të mësimdhënësve. Pagat dhe mëditjet si përqindje e shpenzimeve të AAP-së janë rritur nga 89.3% në 2014 në 95.7% në 2017. Kjo nënkupton që vetëm një diferencë e vogël e buxhetit u mbetet komunave për të mbuluar shpenzimet themelore të shkollave.[100] PSAK 2017-2021 cakton 3.8% (6,772,946 euro) të buxhetit të përgjithshëm për fushën prioritare "Arsimi Profesional dhe për të Rritur".[101]

Përmes tarifave shkollore për nxënësit e rritur, shkollat e AAP-së mund të gjenerojnë të ardhura vetanake, të cilat mund të arrijnë në 5,000 deri në 6,000 euro në vit (bazuar në UA Nr. 11/2011). Në këtë mënyrë shkollat mund të financojnë një pjesë të shpenzimeve të tyre për paga, mallra dhe shërbime.[102] Sidoqoftë, fondet e gjeneruara derdhen në vijën e buxhetit komunal dhe shkollat kanë nevojë për aprovim nga DKA-të për t'i përdorur fondet e gjeneruara. Shkollat nuk kanë autonomi financiare.

Kostot e frekuentimit dhe përfundimit të një programi të arsimit për të rritur në një shkollë AAP janë si më poshtë:[103]

- 100 deri 130 euro për një vit shkollor
- 50 euro për aftësim praktik
- 10 euro për një provim të diferencuar
- 30 euro për provimet dhe certifikatat përfundimtare

Komunat janë të detyruara të sigurojnë fonde për mirëmbajtjen e infrastrukturës "atje ku ka arsim të zhvilluar dhe të organizuar për të rriturit" (neni 19 Ligji për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur).

Kanalet e financimit të AKK-së

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është organi rregullator për ofrimin e arsimit për të rritur në Kosovë dhe si i tillë i takon financim publik si burimi kryesor i buxhetit. Buxheti për AKK-në alokohet për shpenzimet në lidhje me verifikimin e standardeve profesionale, për validimin e kualifikimeve për t'u aprovuar në KKK, dhe për akreditimin e ofruesve. Proceset e lartpërmendura parashikojnë angazhimin e 2-3 ekspertëve të jashtëm të fushës në baza afatshkurtra me maksimumi 5 ditë pune secili për procesin e verifikimit të SP-ve[104] dhe zakonisht 3 ditë pune për validimin e kualifikimeve dhe akreditimin e ofruesve të AAP-së.[105] Tarifa e ditës së ekspertit është 100 euro. Mesatarisht, kostoja për verifikimin e SP-ve është 1,000 - 2,000 euro, ndërsa procesi i validimit dhe akreditimit të ofruesve të AAP-së kushton mes 600 - 1,200 eurove, varësisht nga madhësia e panelit (p.sh., numri i ekspertëve) dhe llojet e ekspertëve (nacional ose rajonal).

Ofruesit e akredituar të ARr-së

Të gjithë ofruesit e arsimit për të rritur (si publik ashtu edhe privat) duhet të paguajnë një tarifë tek AKK për procesin e validimit të kualifikimeve në KKK dhe akreditimin e tyre për t'i ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këto kualifikime. Kostot e procesit të akreditimit llogariten nga menaxhmenti

[100] Qeveria e Republikës së Kosovës (2019), f. 73

[101] Qeveria e Republikës së Kosovës (2019), f. 73

[102] Mehmeti, S. et al. (2019), f. 148

[103] Udhëzimi Administrativ 11/2011 i MASHT-it Për pjesëmarrjen e frekuentuesve në arsim dhe aftësim për të rritur

[104] Udhëzimi Administrativ 28/2014 i MASHT-it për kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit profesional

[105] Udhëzimi Administrativ 23/2014 i MASHT-it për kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë

i AKK-së bazuar në madhësinë e panelit të ekspertëve (3 ose më shumë ekspertë) dhe llojin e ekspertëve (nacional, rajonal ose ndërkombëtar). Kostot për procesin e validimit të kualifikimeve dhe akreditimit të ofruesve janë si më poshtë:[106]

- 50 euro për validim
- 2 euro për kredit për validimin e moduleve/ kualifikimeve, dhe 1.20 euro për validimin e moduleve/kualifikimeve bazuar në standardet kombëtare
- 600 euro për akreditimin fillestar të institucionit që zbaton NjNP (300 euro për riakreditimin)
- 100 euro për ekspertët lokalë për ditë pune (kjo do të thotë që pagesa minimale për një panel me tre ekspertë që punojnë për tri ditë secili do të ishte 900 euro, dhe maksimumi 1,200 euro për katër ekspertë që punojnë për tri ditë secili)
- 200 euro për ekspertët rajonalë për ditë pune (kjo do të thotë që pagesa minimale për një panel me tre ekspertë që punojnë për tri ditë secili do të ishte 1,800 euro, dhe maksimumi 2,400 euro për katër ekspertë që punojnë për tri ditë secili)

Kështu, kostot totale mund të shkojnë nga 1,500 deri në 5,000 euro për një akreditim në varësi të faktorëve të përmendur më lart. Në përgjithësi, AKK fillimisht kërkon që ekspertët lokalë të organizojnë dhe koordinojnë procesin e akreditimit. Vetëm kur ka mungesë të ekspertizës lokale, AKK-ja angazhon ekspertizë rajonale në fushën e kërkuar.

Krahasimi i kostove të ofruesve me shpenzimet e AKK-së tregon se AKK-ja gjeneron të ardhura. Sidoqoftë, të hyrat e gjeneruara kthehen përsëri në buxhetin më të gjerë të qeverisë dhe AKK-ja nuk është në gjendje t'i përdorë të hyrat e krijuara me procesin e lartpërmendur.

Agjencia e Punësimit dhe QAP-të

Arsimi për të rritur për punëkërkuesit e regjistruar që ofrohet nga Qendrat e Aftësimit Profesional të Agjencisë së Punësimit mbulohet nga fonde publike ose në disa raste nga fonde të donatorëve. Sidoqoftë, ofrimi i arsimit për të rritur në QAP nuk llogaritet me një vijë të veçantë buxhetore. Në vend të kësaj, fondet e dedikuara për ofrimin e ARr-së buxhetohen si pjesë e vijës buxhetore për mallra dhe shërbime.

Buxheti i përgjithshëm për APRK-në përcaktohet nga Ministria e Financave. Sipas një raporti që vlerëson zbatimin e Strategjisë së Sektorit të Punësimit të MPMS-së, buxheti i APRK-së arrin në 0.13% të BPV-së (7.9 miliardë euro), që është i ulët krahasuar me mesataren e OECD prej 0.56%.[107]

Buxheti është i centralizuar, në kuptimin që planifikohet nga vetë QAP-të, por shpenzimet duhet të aprovohen nga Agjencia e Punësimit. Mungesa e një vije buxhetore të veçantë dhe centralizimi i privon QAP-të nga diskrecioni i tyre buxhetor dhe fuqia vendimmarrëse, dhe në këtë mënyrë pengon funksionimin e tyre efikas. Kjo gjithashtu sfidon bashkëpunimin me donatorë të ndryshëm, pasi ata hezitojnë të alokojnë fonde në një vijë buxhetore që nuk i dedikohet posaçërisht ofrimit të arsimit për të rritur. Buxheti i shpenzuar nga QAP-të për ofrimin e kurseve varet nga profili profesional, por ai mund të shkojë nga 100 euro (administratë) deri në 300 euro (ndërtim) për kandidat.[108] Nxënësit e rritur i ndjekin kurset falas.

Ofruesit privatë dhe sektori i shoqërisë civile.

Nxënësit e rritur që marrin pjesë në programe arsimore ose aftësuese të ofruara nga ofruesit privatë

[106] Po aty.

[107] Qehaja, L. (2019), f. 25

[108] Intervistë me përfaqësues të QAP-it

i mbulojnë vetë shpenzimet. Të ardhurat e krijuara përbëjnë pjesën më të madhe të buxheteve të ofruesve privatë. Për një program aftësimi të nivelit 5, për shembull në TIK, në një institucion privat të aftësimit, nxënësit duhet të paguajnë një tarifë shkollimi prej rreth 2,800 euro në vit. Kostot llogariten në bazë të shpenzimeve për pajisje, licenca softuerësh, mirëmbajtje dhe trajnerë.[109]

Aktorët e shoqërisë civile dhe organizatat joqeveritare zakonisht janë të orientuara nga qëllimi jofitimprurës dhe synojnë ofrimin e ofertave arsimore në nivelin më të ulët të mundshëm, ose idealisht falas për nxënësit e tyre. Temat e tilla si demokratizimi, të drejtat e njeriut dhe integrimi i grupeve të targetuara të cenueshme, si pakicat, kryesisht financohen nga donatorët. Në disa raste, ka fonde qeveritare të alokuara përmes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe Ministrisë së Rinisë, Kulturës dhe Sporteve. Mungesa e fondeve të sigurta është problem madhor për OJQ-të dhe organizatat e shoqërisë civile. Shumë OJQ ende nuk kanë zhvilluar kapacitete për të aplikuar për fonde nga qeveria ose donatorët ndërkombëtarë ose për të krijuar të ardhura vetanake. Kjo i bën ofertat e tyre të brishta dhe të paqëndrueshme.[110] Rritja e pavarësisë financiare (përmes financimit ndërkombëtar ose krijimit të të ardhurave vetanake) jo vetëm që mund të sigurojë vazhdimësi për ofertat arsimore, por edhe t'i rrisë stimujt për të investuar në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve dhe trajnerëve, dhe nga ana tjetër të forcojë cilësinë e arsimit.

Projektet e donatorëve

Për shkak të kufizimeve buxhetore, shumë shkolla dhe qendra të AAP-së, si dhe OJQ-të, varen nga mbështetja e donatorëve për zhvillimin e programeve të tyre të arsimit për të rritur. DVV International është një aktor udhëheqës dhe kryesor kur flitet për mbështetjen e drejtpërdrejtë të arsimit për të rritur (shih Kapitullin VI për një përshkrim më të hollësishëm të aktiviteteve të arsimit për të rritur nga DVVI në Kosovë). Ajo mbështet ofruesit e arsimit për të rritur, siç janë QAP-të, për zhvillimin teknik të kurrikulave për programe specifike aftësimi (rrobaqepësi ose furrtari për shembull) dhe përmes shpërblimit të trajnerëve profesionistë. Për shembull, me mbështetjen e donatorëve financiarë, krijohet mundësia për ta përditësuar harduerin e tyre të vjetëruar për TIK.[111] Organizata të tjera ndërkombëtare mbulojnë ARr-në, por shpesh vetëm në kuadër të një programi më të madh të AAP-së ose arsimit bazë. Një numër i projekteve të ndryshme me financim ndërkombëtar janë duke zbatuar aktivitete që përfshijnë arsimin për të rritur, siç janë: ALLED II, GIZ ose EYE (shih Kapitullin X për një pasqyrë më gjithëpërfshirëse të angazhimit të donatorëve ndërkombëtarë në sektorin e arsimit për të rritur në Kosovë).

Informacioni i mbledhur në këtë kapitull nënvizon brishtësinë e sistemit kosovar të arsimit për të rritur kur flitet për bazat financiare. Për shkak të kufizimeve buxhetore dhe burimeve të pakta publike, ofruesit publike të ARr-së janë të kufizuar në kapacitetet e tyre për t'i përmirësuar burimet njerëzore dhe njohuritë, për të rritur profesionalizimin ose për të zhvilluar kurrikula të arsimit për të rritur. OJQ-të i sigurojnë ofertat e tyre me fonde afatshkurtra dhe të pasigurta nga donatorët ndërkombëtarë. Aktualisht, sistemi duket se e ka vështirë të jetë i vetë-qëndrueshëm dhe është kryesisht i mbyllur për zhvillim dhe inovacion.

[109] Intervistë me ofrues privat të aftësimit

[110] Intervistë me përfaqësues të OJQ-së

[111] Intervistë me përfaqësues të QAP-it

VI. Institucionet dhe ofruesit

Në Kosovë, arsimi për të rritur është në përputhje të ngushtë me sistemin e arsimit dhe aftësimit profesional. Sistemi i AAP-së është paraparë të jetë i qasshëm për të gjithë qytetarët, duke ofruar aftësime për ata që kanë braktisur shkollën në moshë të hershme, nxënësit e nivelit të mesëm të lartë, si dhe të rriturit. Sipas Ligjit për AAP, aktivitetet e AAP-së supozohet të përqendrohen në 1. "zhvillimin e kompetencave dhe aftësimin për punësimin e individëve", 2. "krijimin e kulturës së përgjithshme dhe profesionale në përputhje me parimet e të nxënit gjatë gjithë jetës", dhe 3. "njohjen e kompetencave të individëve bazuar në standardet e nivelit relevant të punës".

Ofruesit e AAP-së në Kosovë mund të veprojnë në sistemin formal të arsimit si dhe në sistemin joformal. Nxënësit e rritur që kanë përfunduar një program arsimor formal mund të hyjnë në tregun e punës, të fillojnë arsimin pas nivelit të mesëm ose arsimin e lartë në universitet, në varësi të nivelit të kualifikimit të programit. Kualifikimet formale të AAP-së mund të merren në kuadër të sistemit të arsimit në arsimin e mesëm të lartë në shkollat profesionale (klasat 10 - 12) dhe në arsimin dhe aftësimin profesional pas nivelit të mesëm në kolegje (kjo është për studentët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë). Kurse të diplomuarit e AAP-së joformale ose programeve të tjera të arsimit për të rritur mund të vazhdojnë vetëm në tregun e punës.[112]

AAP-ja joformale përbëhet nga

- **aftësimi profesional,** zakonisht i lidhur me vendin e punës ose si masë e krijimit të vendeve të punës, i ofruar në qendrat e aftësimit profesional publike ose private ose në vendin e punës
- **arsimi kompensues për të rritur**, i drejtuar ndaj atyre që kanë braktisur shkollën në moshë të hershme; përmbajtja e të nxënit rrjedh nga programet e arsimit formal, zakonisht të ofruara nga shkollat
- **të nxënit për të rritur i llojeve të ndryshme**, siç janë aftësimi për gjuhë, TIK, artizanat, arte, muzikë ose kulturë, kurse ofrohen nga ofrues privatë ose OJQ.

Grupi i ofruesve të arsimit dhe aftësimit profesional dhe për të rritur është i larmishëm, nga ofruesit e mesëm të lartë te institucionet private, OJQ-të dhe shoqatat profesionale.

- **Shkollat e Arsimit Profesional**, mund të jenë publike ose private dhe ofrojnë arsim dhe aftësim formal
- **Kolegjet e arsimit të mesëm pas nivelit të mesëm** janë vetëm institucione private
- **Qendrat e Kompetencës** janë publike dhe ofrojnë AAP fillestare dhe të vazhdueshme për të rinjtë dhe të rriturit
- **Qendrat e Aftësimit Profesional** janë publike, menaxhohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ofrojnë AAP të vazhdueshme për punëkërkuesit
- **Ofruesit publikë ose privatë të aftësimeve, OJQ-të**, ofrojnë arsim dhe aftësim joformal

Ofruesit e arsimit formal për të rritur

Kualifikimet formale në **shkollat dhe kolegjet e AAP-së** janë për nivelet 3 deri në 5 të KKK-së.

[112] Danuza, T., Mehmeti, F. & Saqipi, B. (2016). Raporti i Referencës i KEK-ut i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve të Kosovës, f. 16

Niveli 3 përfundon me plotësimin e klasave 10 dhe 11, prej këtu studentët mund të hyjnë në tregun e punës ose të vazhdojnë arsimin e AAP-së. Niveli 4 arrihet me përfundimin e klasës 12. Pasi të përfundojë klasa 12, nxënësit kanë të drejtë të japin provimin e Maturës dhe pastaj të fillojnë me arsimin e lartë. Përndryshe, nxënësit hyjnë në tregun e punës ose vazhdojnë në nivelin pas atij të mesëm të AAP-së. Kualifikimet e nivelit 5 mund të arrihen me programe një ose dy vjeçare në **kolegjet e AAP-së pas arsimit të mesëm**, të cilat i pajisin studentët me ekspertizë të lartë, dhe u japin të drejtën për të vazhduar me arsimin e lartë. Janë 68 shkolla të arsimit profesional në Kosovë që ofrojnë programe arsimore të nivelit 3 dhe 4 të KKK-së në fushat e arteve dhe shkencave humane, administrim biznesi dhe juridik, TIK, inxhinieri, prodhim dhe ndërtim, bujqësi, peshkim, pylltari dhe veterinari, shëndetësi dhe mirëqenie, dhe shërbime. Shkollat e AAP-së janë institucione arsimore të licencuara, të cilat i arsimojnë nxënësit e tyre sipas kurrikulave të aprovuara nga MASHT-i. Shkollat publike të AAP-së operohen nga DKA-të. Deri më sot ka nëntë ofrues që ofrojnë, vlerësojnë dhe certifikojnë kualifikimet pas nivelit të mesëm ose të nivelit 5 të akreditуar nga AKK-ja.[113] Kolegjet e AAP-së ofrojnë aftësime për shembull në profesionet shëndetësore, dizajn veshjesh, shkenca teknike të aplikuara dhe TIK. Dy shembuj të kolegjeve të AAP-së pas arsimit të mesëm janë Kolegji Evropian i Kosovës dhe Kolegji Universum.

Kolegji Evropian i Kosovës[114] është një institucion privat i arsimit të lartë. Ai operon një qendër për zhvillimin e karrierës dhe punësimit dhe një qendër aftësimi dhe testimi. Grupet e targetuara janë studentë të të gjitha niveleve dhe të punësuar nga institucione të sektorit publik ose privat ose organizata joqeveritare.

Kolegji Universum[115] është një kolegj privat për arsimin e lartë që ofron programe studimi nga niveli profesional në nivelin master. Zhvillimi i kolegjit si një qendër për të nxënit gjatë gjithë jetës është pjesë e misionit të tij.

Siç u përmend më herët, cilësia e arsimit në shkollat dhe kolegjet e AAP-së, nga shumë qytetarë konsiderohet ende inferiore ndaj arsimit të lartë. Sipas raportit më të fundit të vlerësimit të Procesit ETF të Torinos, kjo është për shkak të faktit se profilet e të nxënit në shkollat e AAP-së nuk përputhen me nevojat e tregut të punës dhe nuk korrespondojnë me vendet e lira të punës. Për më tepër, edhe pse fokusi duhet të jetë në të nxënit praktik dhe të bazuar në punë, përmbajtja e arsimit mbetet teorike. Shkollat dhe mësimdhënësit kanë vështirësi për të organizuar aftësim praktik për shkak të mungesës së pajisjeve dhe shkathtësive pedagogjike për mësimdhënien në praktikë. Shpesh drejtorët e shkollave janë të mbingarkuar me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e shkollës.[116]

Qendrat e Kompetencës janë shkolla pas nivelit të mesëm publike jo të larta të AAP-së që ofrojnë aftësime të specializuara në një fushë profesionale dhe kualifikime nga niveli 4 deri në 5 i KKK-së. QK-të ofrojnë programe të rregullta tre vjeçare si dhe kurse të shkurtra.[117]

[113] Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, pasqyra e Institucioneve të Akredituara për kualifikime në KKK

[114] Ueb faqja e Kolegjit Evropian të Kosovës

[115] Ueb faqja e Kolegjit Universum

[116] Viertel, E. (2019)

[117] Zymberi, F. et al. (2018). Analizë dhe hulumtim për kualifikimet e arsimit të nivelit 5 në shkollat e AAP-së në Republikën e Kosovës

Tani funksionojnë gjashtë QK:

- SHMP "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë me profil TIK[118]
- SHMP "11 Marsi" në Prizren
- QK në Skenderaj
- QK në Malishevë me profil ekonomik
- QK në Ferizaj me profile shëndetësore dhe mjekësore, së fundmi miratoi një program të nivelit 5 për asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta
- QK në Prizren me profile të ekonomisë, tregtisë, udhëtimeve dhe turizmit, prej vitit 2017 me një program të nivelit 5 për këshilltar karriere

QK-të menaxhohen nga AAAPARr-ja. Kurrikula në QK është dizajnuar të jetë më e bazuar në kompetenca sesa në përmbajtje. Një nga karakteristikat e tyre kryesore është marrëdhënia e tyre e ngushtë me sektorin e biznesit, çka u lejon të ofrojnë aftësime praktike dhe të lidhura me punën. Krijimi i QK-ve është financuar kryesisht nga donatorë ndërkombëtarë. Kjo është arsyeja pse për dallim nga shkollat e AAP-së, QK-të zakonisht kanë "punëtori të pajisura mirë, mësimdhënës dhe instruktorë të mirë-trajnuar", "ambiente të shkëlqyera, lidhje të mira me tregun e punës dhe supozohet të shërbejnë si model për shkollat profesionale në Kosovë".[119] Dy QK kanë krijuar partneritete zyrtare publike-private (QK Ferizaj, QK Prishtinë). Vitet e ardhshme do të tregojnë nëse QK-të mund të mbështeten pa investime të gjera ndërkombëtare. PSAK 2017-2021 parashikon rregullore për të mundësuar krijimin e fondeve nga të hyrat vetanake për QK-të dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional për menaxherët dhe stafin e mësimdhënies të QK-ve.

Ofruesit e arsimit joformal për të rritur

Përveç shkollave, kolegjeve dhe QK-ve që përfaqësojnë kryesisht sektorin formal dhe fillestar të AAP-së, ekziston sektori joformal publik i AAP-së, i përfaqësuar kryesisht nga tetë **Qendra të Aftësimit Profesional** të menaxhuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës të Kosovës. [120] QAP-të ofrojnë aftësim dhe riaftësim për punëkërkuesit e regjistruar, të papunët dhe marrësit e shërbimeve të udhëzimit në karrierë. Për më tepër, QAP-të janë përgjegjëse për njohjen e të nxënit paraprak, monitorimin e ofruesve të tjerë të aftësimit, përgatitjen e planeve individuale të aftësimit, si dhe certifikimin. Tetë QAP-të janë të vendosura në shtatë rajonet: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë dhe Doljane (pjesa veriore e Mitrovicës). QAP-të ofrojnë gjithsej 69 punëtori për 30 profesione të ndryshme me fokus në aftësimin praktik (aftësimet përbëhen nga 30% teori dhe 70% praktikë). Nxënësit mund të zgjedhin mes dy programeve: aftësim institucional ose të kombinuar. Aftësimi institucional zhvillohet në QAP, ai ndërthur zhvillimin profesional me shkathtësitë praktike. Qëllimi i këtij aftësimi është të rritë perspektivat personale të punësimit ose të ruajë punësimin. Për aftësimin e kombinuar, QAP-të kanë krijuar partneritete aftësimi me bizneset. Përmbajtja teorike përcillet në QAP, përmbajtja praktike në kuadër të ndërmarrjeve (për këtë pjesë nxënësit pajisen me material teorik nga QAP-të). Të gjitha aftësimet zhvillohen në kuadër të një sistemi fleksibël dhe modular, me module që shtrihen për 3-6 muaj, dhe lëshohet një certifikatë përfundimtare bazuar në testimin pas secilit modul, si dhe një test përfundimtar.

[118] Njoftim për shtyp nga LuxDev "KOSOVË - Rritja e Shkollës Teknike Gjin Gazulli në një Qendër të re të Kompetencës (QK) për TIK në Prishtinë"

[119] Qeveria e Republikës së Kosovës (2019)

[120] Ueb faqja e Agjencisë së Punësimit e Republikës së Kosovës, Qendrat e Aftësimit

Përkundër organizimit qendror, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ndërmjet QAP-ve dhe mes QAP-ve dhe shkollave të AAP-së është mjaft i ulët dhe ndodh kryesisht në drejtim të shkëmbimit të përvojës dhe vendimmarrjes në kuadër të bordit rajonal të shkollës. Objektet, pajisjet dhe burimet e tjera nuk ndahen. Një partner i intervistuar raporton se një QAP ka krijuar bashkëpunim me vendin fqinj Shqipërinë për t'u lejuar qytetarëve të marrin pjesë në aftësime në QAP dhe anasjelltas.[121]

Një avokues i shquar joqeveritar dhe institucional i të nxënit gjatë gjithë jetës dhe arsimit joformal për të rritur në Kosovë është **DVV International** me zyrën e vet lokale në Prishtinë.[122] E angazhuar në mënyrë aktive në Kosovë prej vitit 2005, DVVI Kosova përpiqet për përmirësimin dhe zgjerimin e ofertave të arsimit për të rritur, për përmirësimin e kornizave politike dhe ligjore për arsimin për të rritur (më e rëndësishmja përmes ligjit për arsimin për të rritur, ligjit për arsimin dhe aftësimin profesional, dhe Planeve Strategjike të Arsimit në Kosovë), si dhe për integrimin e përpjekjeve të arsimit për të rritur me luftën kundër varfërisë. Përveçse për publikun e gjerë, DVVI Kosova ofron aktivitete të targetuara për gratë (veçanërisht nga zonat rurale), personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat etnike. Puna e DVVI Kosova përfshin disa pika fokusi:

a) Programet e arsimit dhe të aftësimit për të rritur për individë dhe OJQ në fushat e zhvillimit të shkathtësive dhe qytetarisë demokratike. Dy aktivitete të kohëve të fundit përfshinin, për shembull, një aftësim për trajnerë mbi të drejtat e njeriut dhe qytetarinë demokratike (së bashku me Qendrën për Arsimi të Kosovës (KEC)) dhe zhvillimin e shkathtësive për ndërmarrëse femra për t'i zhvilluar dhe mbajtur aktivitetet e tyre të biznesit gjatë pandemisë COVID-19. Në janar, personat me aftësi të kufizuara kanë marrë pjesë në një aftësim për TIK.
b) Aftësimi i mësimdhënësve dhe trajnerëve për metodat dhe didaktikën e arsimit për të rritur në përputhje me Curriculum GlobALE (shih Kapitullin IX). Pesë module të Curriculum GlobALE për arsimin për të rritur në Kosovë janë botuar së fundmi.
c) Përmirësimi i kurrikulave dhe programeve për arsimin për të rritur. Si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19 dhe mangësive të digjitalizimit, DVVI Kosova mbështeti dy Qendra të Kompetencës me ofrimin e platformave të të nxënit online për shkathtësitë për TI dhe Marketing. DVVI Kosova gjithashtu kontribuon në zhvillimin e standardeve profesionale dhe kurseve modulare për Qendrat Rinore, shkollat e AAP-së, QK-të ose QAP-të.
d) Bashkëpunim më i mirë mes ministrive, OJQ-ve dhe institucioneve private të aftësimit, përmes konferencave dhe aktiviteteve të rrjetëzimit, siç është java e të nxënit gjatë gjithë jetës, e cila u jep palëve të ndryshme të interesit nga politika, institucionet arsimore dhe shoqëria civile mundësinë për të diskutuar rëndësinë e arsimit për të rritur si pjesë e të nxënit gjatë gjithë jetës, për të zbuluar zhvillime inovative dhe reaguar ndaj sfidave aktuale.
e) Kualifikimi i vendimmarrësve për të avancuar financimin e ARr-së përmes buxhetit publik, për të rritur cilësinë e NARr-it dhe për të siguruar pjesëmarrje jodiskriminuese. Në tetor 2020 DVVI Kosova, së bashku me AKK-në, organizuan një seminar për ndërtimin e kapaciteteve për praktikuesit në fushën e NjNP-së. Së bashku me AKK-në ka zhvillu-

[121] Intervistë me përfaqësues të QAP-it

[122] Ueb faqja e DVV International në Kosovë

ar “Udhëzimet dhe Programin për Njohjen e Koordinatorëve, Mentorëve dhe Vlerësuesve të të Nxënit Paraprak”[123]

f) Lidhja me qasjet rajonale dhe ndërkombëtare (siç janë Akademia Rajonale Andragogjike (ARA), Konferencat Ndërkombëtare mbi Arsimin për të Rritur dhe kërkesat që dalin nga procedurat e anëtarësimit në BE). Me zbatimin e Anketës për Arsimin për të Rritur në Kosovë, DVVI kontribuon në të kuptuarit e gjendjes së arsimit për të rritur dhe krahasueshmërinë ndërkombëtare (shih Kapitullin VIII).

Pas viteve të angazhimit, DVVI Kosova është e lidhur mirë me palët kryesore të interesit politike (MASHT, MPMS, MKRS, AAAPARr, APRK, AKK), institucionet arsimore (Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës) si dhe shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare të donatorëve.

Përkrah DVV International Kosova, një numër institucionesh dhe organizatash më të mëdha dhe të vogla, publike dhe private, janë ofrues aktivë të arsimit për të rritur në Kosovë, një përzgjedhje e të cilave do të paraqitet në vijim:

Ofruesit privatë

Cacttus Education është një shembull i mirë për ofruesit e suksesshëm komercialë të arsimit për të rritur. Cacttus është specializuar në fushën e ofrimit të shkathtësive për TIK. Ajo operon dy linja biznesi: a) aftësim profesional për institucionet qeveritare, ndërmarrjet më të mëdha ose sektorin bankar, b) shkollën private të AAP-së. Ajo ofron një program studimi dy vjeçar për TIK dhe ishte institucioni i parë që u akreditua zyrtarisht nga MASHT-i dhe AKK-ja në KKK-në e re. Ndërkohë, në Cacttus aftësohet gjenerata e 7-të e studentëve.

Në Kosovë janë një numër i **shkollave të gjuhëve** të cilat janë akredituar për të ofruar aftësime gjuhësore për njerëz të të gjitha moshave. Ndër shkollat e gjuhëve të akredituara nga AKK janë New Age School, Smart Center, Oxford Studio, ECO-Education Oxford, Britanica-ELT, The Cambridge School dhe School of English Language.

Punëdhënësit, firmat ose ndërmarrjet mund të jenë palë të rëndësishme të interesit për zhvillimin e shkathtësive të orientuara nga tregu i punës. Disa kompani operojnë qendrat e tyre të aftësimit me kurse aftësimi të akredituara nga AKK, siç është Telekomi i Kosovës me Qendrën e Aftësimit dhe Zhvillimit, dhe gjithashtu Korporata Energjetike e Kosovës ka një Qendër Aftësimi - KEK. Megjithatë, përgjithësisht punëdhënësit kosovarë nuk janë të lidhur mirë me sistemin arsimor. Sipas gjetjeve nga studimi STEP i Bankës Botërore, mesatarisht vetëm një në pesë punëdhënës është në kontakt të rregullt me sistemin arsimor. Shkëmbimi është më i shpeshtë në degë me potencial më të madh punësimi, siç janë kompanitë shtetërore ose të huaja dhe firmat më të mëdha. Qëllimi i ndërveprimit lidhet kryesisht me ofrimin e praktikave dhe aftësimin e punëtorëve. Shkëmbimi strategjik, për shembull në zhvillimin e kurrikulës, është më i rrallë. Shumica e firmave nuk u ofrojnë të punësuarve të tyre mundësi për zhvillim profesional. Firmat e huaja ose shtetërore kanë më shumë gjasa të ofrojnë aftësime (në punë, të brendshme ose të jashtme).[124]

[123] Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (2018). Udhëzime dhe Programi për Njohjen e Koordinatorëve, Mentorëve dhe Vlerësuesve të të Nxënit Paraprak

[124] Banka Botërore (2019). Raporti i Vendit për Kosovën: Gjetjet nga anketa e shkathtësive drejt punësimit dhe produktivitetit. Uashington, DC: Banka Botërore.

Ofruesit publikë

Këndi Amerikan në Prishtinë[125] është një seksion i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, i bashkëfinancuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. Këndi Amerikan në Prishtinë angazhohet për të vendosur një ndërlidhje kulturore ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara përmes ofrimit të qasjes në literaturë, aftësimit në gjuhën angleze dhe ligjëratave.

Për të lehtësuar shkëmbimin ndërmjet të rinjve që kërkojnë punësim dhe ndërmarrjeve, **Oda Ekonomike e Kosovës** operon platformën online www.aap-oek.org.

Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë (APPK)[126] synon riintegrimin socio-ekonomik të grupeve të ndryshme të targetuara përmes këshillimit, aftësimit, certifikimit, ndërmjetësimit në punë dhe aftësimit për ndërmarrësi.

Ofruesit jofitimprurës

Balkan Sunflowers (BSFK)[127] operon pesë qendra të të nxënit për fëmijë në katër komuna. Programet e saj synojnë të rrisin përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve, ashkalive dhe egjiptasve në arsim dhe në jetën qytetare në Kosovë. BSFK ofron aftësim dhe zhvillim profesional për stafin, vullnetarët dhe aktivistët në terren.

Qendra e aftësimit Diakonie[128] ofron aftësim me kosto të ulët për të rinjtë dhe të rriturit nga grupe të cenueshme për t'i përgatitur për tregun e punës. Disa nga kurset e saj janë akreditуar nga AKK-ja.

Shoqata Getting Competent[129] bashkon trajnerë, arsimtarë, organizata të aftësimit për shkathtësi, përfaqësues nga firma ose biznese dhe individë të tjerë të interesuar në AAP, për të nxitur të nxënit, komunikimin dhe shkëmbimin reciprok. Getting Competent operon një Akademi të Shkathtësive[130] ku pjesëmarrësit mund të përmirësojnë shkathtësitë e tyre personale dhe profesionale për tregun e punës.

Qendra për Arsim e Kosovës[131] është një organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar në vitin 2000 nga Fondacioni Soros. Për të avancuar cilësinë e arsimit, KEC angazhohet në aftësimin e mësimdhënësve (metodologji dhe udhëheqje), hulumtime arsimore dhe këshillime në arsim. Ajo zbaton aftësime të trajnerëve për arsimin për të rritur dhe kurse të edukimit qytetar dhe është partnere e bashkëpunimit për disa organizata ndërkombëtare.

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGGK) përfshin 158 organizata anëtare dhe partnerë dhe angazhohet në përmirësimin e qasjes në arsim për grupet etnike të pakicave, luftimin e stereotipeve gjinore dhe ofrimin e arsimit në lidhje me temat e feminizmit dhe shëndetit të grave.

Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë (PEN)[132] është një organizatë rinore joqeveritare e cila

[125] Ueb faqja e Këndit Amerikan në Prishtinë
[126] Ueb faqja e Agjensionit të Përkrahjes së Punësimit Kosovë
[127] Ueb faqja e Balkan Sunflowers
[128] Ueb faqja e Diakonie Kosova
[129] Ueb faqja e Getting Competent
[130] Ueb faqja e Akademisë së Shkathtësive e Getting Competent
[131] Ueb faqja e Qendrës për Arsim të Kosovës
[132] Ueb faqja e Rrjetit të Edukatorëve Bashkëmoshatarë

përmes punëtorive dhe aftësimeve synon fuqizimin e të rejave dhe të rinjve për të qenë agjentë të ndryshimeve shoqërore.

"**Qendrat Rinore**" – janë të përhapura në të gjithë territorin e Kosovës (Ardhmëria-Klinë, Gjilan, Lipjan). Aktivitetet adresojnë të rinjtë dhe shkojnë nga arsimi joformal dhe ngritja e vetëdijes, tek ndërtimi joformal i kapaciteteve të shoqërisë civile dhe zbatimi i kurseve të aftësimit (kompjuter, gjuhë, matematikë, shkathtësi jetësore) konferenca dhe shkëmbime.

Gratë për Gratë Kosova[133] është një rrjet i cili mbështet ndërmarrëse femra me aftësime dhe konsulenca (aftësim profesional, prodhim i artizanatit, aftësim biznesi). Gratë e tjera trajnohen për avokim dhe si agjente ndryshimesh.

Gjatë viteve të fundit, shumë vëmendje i është kushtuar zhvillimit të sistemit të ofrimit formal të AAP-së, veçanërisht AAP-së fillestare. Shqyrtimi i mësipërm tregon se kërkohet angazhim i mëtejshëm, pasi sistemi ende përballet me sfida të mëdha. Ofruesit e tjerë publikë dhe privatë të arsimit për të rritur në fushën e AAP-së formale ose joformale, kryesisht targetojnë punëkërkuesit. Disa oferta përfshijnë edhe mundësi për zhvillim të vazhdueshëm profesional, i cili, megjithatë, nuk është ende i njohur gjerësisht. Ka ofrues të shpërndarë të aftësimeve dhe kurseve të bazuara në tarifa kryesisht në fushën e TIK, sektori i bukurisë, ndërtimi, shkathtësitë digjitale dhe administrimi i biznesit.

Avokuesi dhe ofruesi më i shquar i arsimit joformal në Kosovë është DVVI, duke promovuar një qasje holistike për krijimin e arsimit për të rritur që targeton nivele të ndryshme të administratës dhe grupe në shoqëri. Përveç kësaj, ekziston një numër i vogël i ofruesve jofitimprurës të arsimit joformal. Për sa i përket përmbajtjes, ofertat e tyre shtrihen në tema të ndryshme për zhvillimin profesional dhe personal, si dhe edukimin për demokracinë dhe qytetarinë. Sfida më e madhe për OJQ-të është mungesa e fondeve të qëndrueshme (siç shpjegohet në Kapitullin V). Në terren nuk ka asnjë rrjet sektorial të ofruesve të ARr-së, i cili mund të koordinojë ARr-në dhe të krijojë sinergji. Prandaj, ofertat e rralla nuk janë ende të lehta për t'u përdorur për publikun e gjerë.

[133] Ueb faqja e Gratë për Gratë Kosova

VII. Programet

Programet e arsimit dhe të të nxënit për të rritur në Kosovë mund të ndahen në tre kategori të veçanta:

- Arsimi bazë kompensues
- Programet e aftësimit profesional që çojnë drejt kualifikimeve profesionale dhe rritjes së tyre
- Programet e tjera të pavarura nga kualifikimi, por liberale në lëndën e tyre, siç janë pjesëmarrja në komunitet, edukimi qytetar dhe programet kulturore.

Arsimi bazë kompensues rregullohet në UA 12/2014 (me titull "Përjashtimet në moshë në rastin e regjistrimit në arsim dhe aftësim për të rritur").[134] Ai targeton të rriturit që e kanë braktisur sistemin e rregullt arsimor në moshë të hershme. Programet ofrohen nga shkollat publike nën mbikëqyrjen e MASHT-it. Arsimi kompensues ofrohet për klasat 1-9 të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta dhe klasat 10-13 të shkollës së mesme të lartë, përfshirë shkollat e AAP-së. Dy vjet arsim i rregullt mund të përfundohen brenda një viti shkollor kompensues. Nxënësit e regjistruar duhet të ndjekin 18 javë arsim dhe aftësim. Nëse grupi i pjesëmarrësve të regjistruar është më pak se 12, shkollat janë të detyruara të organizojnë të paktën mësim konsultativ ku nxënësit e rritur ndjekin vetëm 10% të orëve të kontaktit të parashikuara fillimisht. Shkollat zhvillojnë plane vjetore të punës që përfshijnë organizimin dhe zbatimin e arsimit kompensues për të rriturit, përfshirë kriteret e regjistrimit. Pas regjistrimit të kandidatëve, shkollat duhet të përgatisin dhe botojnë një kalendar vjetor me informacionin e mëposhtëm për kandidatët: orarin e mësimdhënies, kurrikulat e mësimdhënies, listën e mësimdhënësve të angazhuar, panelin e vlerësimit, orarin e provimeve, planin e praktikës profesionale dhe aktivitete të tjera relevante në lidhje me në ARr-në. Certifikatat dhe diplomat e marra përmes ARr-së janë të njëjta me ato të marra përmes një certifikimi përmes rrugës së rregullt të të nxënit.

Të rriturit e interesuar për të marrë kualifikim, rikualifikim ose zhvillim të mëtejshëm profesional, mund të marrin pjesë në **programet e aftësimit profesional** që rezultojnë në marrjen e kualifikimit në përputhje me KKK-në. Në Kosovë aftësimi profesional është kategoria më e madhe e masave të tregut aktiv të punës.[135] Ekzistojnë tre lloje të kualifikimeve në KKK që mund të fitohen në një mjedis joformal[136]: Kualifikimet Kombëtare Profesionale, Kualifikimet bazuar në Standardet Ndërkombëtare, dhe Kualifikimet e Përshtatura. Këto kualifikime ofrohen nga ofruesit publikë dhe privatë të aftësimeve, kompanitë, ndërmarrjet dhe shkollat e AAP-së, të cilat duhet të plotësojnë kriteret e akreditimit për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar kualifikimin e përcaktuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

Kualifikimet Kombëtare Profesionale (KKP) janë kualifikimet e rezultateve të të nxënit që zh-

[134] Udhëzimi Administrativ 12/2014 i MASHT-it për përjashtimet në moshë në rastin e regjistrimit në arsim dhe aftësim për të rritur

[135] Banka Botërore (2019)

[136] Kualifikimet e arsimit të lartë, kualifikimet e arsimit të përgjithshëm dhe kualifikimet e kombinuara kombëtare të AAP-së/të përgjithshme, jepen në mjedisin e arsimit formal.

villohen bazuar në standardet kombëtare profesionale (SP). Standardet kombëtare profesionale janë "deklarata të performancës së punës që pasqyrojnë aftësinë për t'i kryer me sukses funksionet e kërkuara në një profesion, si dhe zbatimin e njohurive, shkathtësive dhe të kuptuarit në një profesion".[137] Zakonisht, SP-të iniciohen dhe zhvillohen nga MASHT-i, MPMS-ja, AAAPARr-ja ose partnerët socialë. Për shkak të kufizimeve të buxhetit publik, procesi i zhvillimit të SP-ve financohet kryesisht nga donatorët. Standardet profesionale zhvillohen përmes analizës së thelluar të profesionit. Procesi përfshin vëzhgime të drejtpërdrejta të punëtorëve dhe punëtorive, së bashku me ekspertët profesionalë dhe punëtorët që vijnë nga fusha përkatëse. Prandaj, SP konsiderohen si lidhja e drejtpërdrejtë mes ofrimit të arsimit dhe nevojave të tregut të punës. Pas procesit të zhvillimit, SP-të i nënshtrohen një procesi të sigurimit të cilësisë dhe verifikimit të drejtuar nga AKK-ja. Kjo është për të siguruar që SP-të janë në përputhje me nevojat e sektorit. Pas aprovimit nga AKK-ja, SP-të më pas miratohen si Standarde Kombëtare Profesionale nga Këshilli për AAP. Pasi të autorizohen, ato mund të përdoren nga ofruesit për të zhvilluar KKP-të. KKP-të i bashkëngjiten ECVET, që do të thotë se kandidatët mund të grumbullojnë dhe transferojnë rezultatet e fituara të të nxënit në formë të krediteve: 1 ECVET është i barabartë me 20 orë të punës, një modul duhet të ketë të paktën 1 kredit për t'u validuar, aprovuar dhe regjistruar në KKK. Kreditet mund të vendosen në nivelet 2 deri në 5 të KKK-së. Në mënyrë që të ofrojnë, vlerësojnë dhe certifikojnë KKP, zhvilluesit e kualifikimeve duhet të plotësojnë kriteret dhe standardet e përcaktuara në KKK dhe nga AKK-ja. Veç kësaj, të gjithë ofruesit duhet të akreditohen si qendër certifikuese nga AKK-ja për të qenë në gjendje të ofrojnë KKP të validuara dhe të aprovuara. Certifikatat e lëshuara për nxënësit e rritur për kualifikimet kombëtare mbështeten nga AKK-ja. Ato mund të jepen për përfundimin me sukses të të gjithë kualifikimit duke u quajtur 'certifikatë kombëtare' ose për kualifikimin/modulin e pjesshëm duke u quajtur 'certifikatë e arritjeve'.

Deri më tani, 116 SP janë verifikuar nga AKK-ja dhe janë aprovuar nga AAPV si SP Kombëtare. Më shumë se 40 KKP janë validuar dhe aprovuar në KKK në fushën e shërbimeve (bukuri, administratë, rrobaqepësi, financa, ndërtimi, përpunimi i ushqimit dhe transporti dhe komunikimi)[138]. Deri më tani, AKK ka akredituar 56 ofrues publikë dhe privatë për t'i ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këto KKP.[139]

Kualifikimi i bazuar në Standardet Ndërkombëtare është një program kualifikimi i bazuar në standardet profesionale të aprovuara në vende të tjera përveç Kosovës. Këto SP mund të përdoren për zhvillimin e një kualifikimi vetëm nëse ato nuk janë të zhvilluara, nuk kanë sigurim të cilësisë ose aprovim në nivelin kombëtar. Ato duhet të marrin sigurim të cilësisë dhe të aprovohen nga një organ ndërkombëtar vlerësues. Zakonisht, këto SP mbulojnë sektorë që Kosova nuk është në gjendje t'i ndjekë për arsye zhvillimi, siç janë TIK. Për t'i përdorur këto SP për zhvillimin e

[137] Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (2011). Zhvillimi dhe Verifikimi i Standardeve Profesionale

[138] Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, pasqyra e Institucioneve të Akredituara për kualifikime në KKK

[139] Po aty.

kualifikimeve dhe regjistrimin e tyre në KKK, zhvilluesve të kualifikimeve u duhet aprovim zyrtar me shkrim nga zhvilluesit origjinalë ose organet kompetente. Në parim, këto kualifikime mund të vendosen në nivelet 2 deri në 5 të KKK-së dhe të kenë të bashkëngjitur një sistem kreditesh ekuivalent me ECVET. Ngjashëm me KKP-të, kualifikimi i dizajnuar nga SP-të ndërkombëtare duhet të validohet dhe aprovohet në KKK, dhe ofruesit duhet të plotësojnë kriteret dhe standardet e akreditimit për t'i ofruar, certifikuar dhe vlerësuar këto kualifikime. Certifikatat e lëshuara për nxënësit e rritur për kualifikimet bazuar në standardet ndërkombëtare, mbështeten nga AKK-ja.

Deri më sot, ka trembëdhjetë Kualifikime të bazuara në Standarde Ndërkombëtare në fushat e TIK dhe kontabilitetit dhe auditimit të validuara dhe aprovuara në KKK, ndërsa ka shtatë ofrues privatë të akredituar për t'i ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këto kualifikime.[140]

Kualifikimet e përshtatura dizajnohen në përputhje me nevojat operacionale të një organizate, agjencie ose ndërmarrjeje të veçantë. Ato shërbejnë për të arritur njohuri, shkathtësi dhe kompetenca të përgjithshme ose profesionale. Rezultatet e kualifikimeve të përshtatura janë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat bazuar në standardet e identifikuara nga organizata, agjencia ose ndërmarrja që kërkon kualifikimin. Në parim, këto kualifikime mund të vendosen në nivelet 2 deri në 5 të KKK-së dhe të kenë të bashkëngjitur një sistem kreditesh ekuivalent me ECVET. Ngjashëm me llojet e tjera të kualifikimeve në KKK, kualifikimet e përshtatura i nënshtrohen një procesi të validimit dhe aprovimit, dhe ofruesit që duan t'i ofrojnë, vlerësojnë dhe certifikojnë këto kualifikime duhet t'i nënshtrohen një procesi të akreditimit. Certifikatat e lëshuara për nxënësit e rritur për kualifikimet e përshtatura mbështeten nga AKK-ja.

Janë katër kualifikime të përshtatura të validuara dhe të aprovuara në KKK në fushën e Sigurisë Publike. Dy ofrues publikë janë të akreditуar për t'i ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këto kualifikime.[141]

Pavarësisht nga programet e lartpërmendura të NARr-it-së që lidhen me KKK-në, ekziston një numër i madh i programeve që çojnë në kualifikime por nuk janë të validuara dhe të regjistruara në KKK. Po kështu, ofruesit e programeve të tilla nuk i nënshtrohen sigurimit të jashtëm të cilësisë nga AKK-ja dhe as nuk janë të licencuar nga MASHT-i. Meqenëse këto programe dhe ofrues operojnë jashtë sistemit formal të arsimit formal dhe joformal, ata nuk janë pjesë e sistemeve publike të menaxhimit të informacionit, dhe kështu nuk ka të dhëna zyrtare të disponueshme në lidhje me shtrirjen dhe fushëveprimin e ofertës së tyre.

Përjashtim bëjnë programet e disa ofruesve publikë, siç janë QAP-të të menaxhuara nga Agjencia e Punësimit në kuadër të MPMS-së. Programet arsimore në QAP vendosen në nivelin 3 të KKK-së. Siç shpjegohet në Kapitullin VI, QAP-të targetojnë punëkërkuesit dhe ofrojnë një gamë të gjerë programesh që çojnë në kualifikime. Sidoqoftë, vetëm disa prej këtyre programeve janë të validuara dhe të vendosura në KKK (siç janë asistent administrativ, saldim dhe grimier). Për më tepër, deri më sot mungon një sistem i rregullt i vlerësimit të nevojave të tregut të punës që mund të kontribuojë për zbatimin e politikave të aftësimit. Edhe pse shumë programe janë dizajn-

[140] Po aty.

[141] Po aty.

uar për t'iu përshtatur nevojave të tregut të punës (në mënyrën më të përshtatshme në sektorët e ndërtimit dhe shërbimeve), shpesh, QAP-të nuk janë në gjendje t'i përmbushin kriteret dhe standardet e kërkuara të AKK-së për sa i përket burimeve njerëzore dhe pajisjeve. Në QAP zakonisht ofrohen profilet e mëposhtme profesionale: ndërtim, shërbime, kuzhinier, kamerier, auto-mekanik / auto-elektrik, hidraulik dhe pneumatik, saldim, administrim biznesi, elektronikë industriale, servis i teknikës së bardhë, TI, rrobaqepësi, parukeri, grim dhe furrtari.

Një pjesë e madhe e ofertës për arsimin për të rritur përbëhet nga programe joformale që targetojnë të rriturit por nuk synojnë kualifikime zyrtare dhe formale. Shembuj janë aftësimet për edukimin për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe tolerancën, kurse për integrimin në BE, mbrojtjen e shëndetit, ndërmarrësinë (shkathtësitë për biznese fillestare), mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin kulturor dhe ndërkulturor. Veç tyre, ka aftësime të tjera specifike profesionale që synojnë zhvillimin e mëtejshëm profesional. Pas përfundimit të këtyre programeve, pjesëmarrësve zakonisht u jepet një certifikatë simbolike e pjesëmarrjes. Këto forma të arsimit për të rritur janë të organizuara në formën e trajnimeve, konferencave, punëtorive, seminareve, debateve ose vizitave studimore për shembull. Meqenëse ato nuk çojnë në kualifikim, programet dhe ofruesit nuk i nënshtrohen sigurimit të cilësisë nga AKK-ja. Programet joformale të NARr-it-së ofrohen nga një gamë e gjerë ofruesish, siç janë organizatat joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare, kompanitë, ndërmarrjet, ofruesit publikë dhe privatë të aftësimeve, institutet, bibliotekat dhe odat (shih Kapitullin VI). Në përgjithësi, programet joformale janë shumë të decentralizuara dhe nuk ka programe në të gjithë shtetin që promovojnë pjesëmarrjen e të rriturve, përveç temave të punësimit dhe tregut të punës.

VIII. Pjesëmarrja dhe mospjesëmarrja

Analiza e hollësishme e pjesëmarrjes dhe mospjesëmarrjes në arsimin për të rritur në kontekstin kosovar është e vështirë për shkak të mungesës së një sistemi gjithëpërfshirës kombëtar të monitorimit dhe vlerësimit. Hendeku në të dhënat statistikore pengon zhvillimin e politikave kombëtare të bazuara në dëshmi si dhe harmonizimin e grupeve të targetuara të ofertave të arsimit për të rritur.

Për momentin, informacioni publik që ekziston në lidhje me njerëzit që marrin pjesë në programet e arsimit për të rritur është mjaft i fragmentuar. Shpesh, të dhënat janë veç për numrin e pjesëmarrësve dhe, herë pas here, për grupmoshat.

Raporti i vlerësimit afatmesëm për PSAK 2017-2021 pranon që mbledhja e të dhënave për pjesëmarrjen në arsimin për të rritur mbetet ende një sfidë.[142] Sidoqoftë, ai raporton se sistemi i menaxhimin të informatave të arsimit (SMIA) ka filluar të mbledhë të dhëna për arsimin për të rritur. Prandaj, gjatë vitit shkollor 2018/19, 1,912 të rritur ishin të përfshirë në arsimin e mesëm profesional, nga të cilët 636 ishin gra. Numrat e pjesëmarrjes mbetën të qëndrueshëm prej vitit shkollor 2015/16. Nuk ka asnjë informacion në lidhje me moshën e nxënësve. SMIA mbulon vetëm pjesëmarrjen e të rriturve në programe formale, nuk ofron të dhëna për përfshirjen e të rriturve në arsimin joformal. Nuk ka të dhëna të disponueshme as për numrin e orëve në programet e arsimit për të rritur (megjithëse 200,000 orë në vit janë përcaktuar si cak i PSAK), dhe raporti nuk mund të sigurojë as përqindjen e të rriturve që marrin pjesë në programet e të nxënit gjatë gjithë jetës.

Në vitin 2017, një raport hulumtimi në emër të MPMS-së, Agjencisë së Punësimit dhe DVVI, vlerësoi praktikat në zbatimin e programeve të arsimit për të rritur në QAP-të kombëtare.[143] Autorët zbuluan se në lidhje me grupmoshat, pjesëmarrja ishte mjaft e ekuilibruar. 37% e nxënësve ishin nën moshën 25 vjeç, 32% ishin mes 26 dhe 35 vjeç, dhe 30% ishin më të vjetër se 35 vjeç. Shumica e nxënësve kishin kualifikim të mëparshëm, 42% kishin arsimim paraprak në AAP, dhe 32% një certifikatë të arsimit të lartë.

Një raport mbi zbatimin e Strategjisë së Sektorit të Punësimit të MPMS-së ofron pasqyrën për grupin e përfituesve të shërbimeve të punësimit dhe MTAP-ve.[144] Kështu, 5.8% e të papunëve punëkërkues u trajnuan në QAP në vitin 2018. 2.3% e tyre ishin përfitues të aftësimit të kombinuar në QAP dhe kompani. 3.8% e të gjithë punëkërkuesve morën pjesë në MTAP. Grupi më i madh i përfituesve të MTAP (56%) ishte 25 deri në 29 vjeç, i ndjekur nga grupi prej 15 deri në 24 vjeç (31%).

Mbetet mjaft punë për të bërë për shtetin dhe palët e tjera të rëndësishme kombëtare të interesit për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave. Raporti i vlerësimit afatmesëm i PSAK mund të sigurojë të dhëna të progresit vetëm për njërin nga tre caqet

[142] Mehmeti, S. et al. (2019), f. 150

[143] Mehmetaj & Likaj (2017). Raporti i hulumtimit. Vlerësimi i Praktikave në Zbatimin e Programeve të Arsimit për të Rritur në Qendrat e Aftësimit Profesional.

[144] Qehaja, L. (2019)

e përcaktuara për arsimin për të rritur. Shpesh, vlera informative e të dhënave dëmtohet nga mungesa e të dhënave referuese, p.sh., që ilustrojnë raportin me të rriturve pjesëmarrës (mosha 25 deri 64 vjeç) dhe të rinjve nën moshën 25 vjeç. Në mënyrë që të mund të zhvillohen politika dhe programe të bazuara në dëshmi, mbledhja e të dhënave duhet të shtrihet përtej numrave të thjeshtë të pjesëmarrjes dhe të përfshijë informacione në lidhje me sfondin socio-ekonomik, veçanërisht moshën, dhe motivimin për të marrë pjesë.

Anketa për Arsimin për të Rritur në Kosovë

Me finalizimin e Anketës së parë për Arsimin për të Rritur në Kosovë në vitin 2021, iniciuar nga DVVI dhe DIE dhe zbatuar nga Instituti Riinvest për Hulumtime Zhvillimore, tani disponohet informacion më i saktë për nxënësit e rritur, motivimin e tyre për të marrë pjesë ose jo në arsimin për të rritur, dhe preferencat e tyre.[145] Anketa u administrua në përputhje me metodologjinë e përcaktuar të Anketës Evropiane për Arsimin për të Rritur.[146]

Anketa adresoi grupin e njerëzve në moshë pune, 18 deri 64 vjeç, dhe parashtroi pyetje për pjesëmarrjen në të nxënit formal, joformal dhe informal gjatë dymbëdhjetë muajve para anketës. Mes tetorit dhe dhjetorit 2020, 2,394 njerëz në Kosovë morën pjesë në anketë. Të dhënat janë përfaqësuese për popullatën kosovare.

Rezultatet e anketës tregojnë se në përgjithësi vetëm pak njerëz (33%) janë duke kërkuar informacion në lidhje me mundësitë e mëtejshme të të nxënit. Të rinjtë e moshës 18 deri në 24 vjeç janë më aktivë në hulumtim (45%). Ata janë më aktivë sesa grupmoshat më të vjetra (23% mes atyre të moshës 25 deri 44 vjeç dhe 4% mes atyre moshës 45 deri 64 vjeç). Në shumicën e rasteve (51%) njerëzit e gjetën informacionin e dëshiruar kryesisht përmes hulumtimit online, kolegëve dhe rrjeteve sociale. Punëdhënësit, organizatat e shoqërisë civile dhe autoritetet lokale rrallë kontaktohen për informacion në lidhje me mundësitë e Arsimit për të Rritur.

Tabela 2 më poshtë jep një tregues të statusit të pjesëmarrjes në arsimin për të rritur në Kosovë. Kjo tregon se vetëm një pjesë e vogël e pjesëmarrësve në anketë mbi moshën 18 vjeç kanë ndjekur një formë të arsimit formal (14%). Kjo është vlerë më e lartë se mesatarja e BE-27, dhe është e besueshme pasi që mostra e BE-së nuk përfshin personat 18 deri në 24 vjeç të cilët kanë më shumë gjasa të marrin pjesë ende në arsimin fillestar formal. Më shumë se 50% e pjesëmarrësve në arsimin formal treguan se nuk po punonin në kohën e aftësimit. Vetëm rreth 20% e të anketuarve thanë që aftësimi formal ishte zhvilluar kryesisht ose vetëm gjatë orëve të punës me pagesë.

Rëndësia e vogël e arsimit të vazhdueshëm në mesin e të rriturve Kosova bëhet e dukshme në shkallën e pjesëmarrjes në arsimin joformal. Vetëm 13% e të anketuarve kanë marrë pjesë në një formë të arsimit joformal brenda dymbëdhjetë muajve të fundit para anketës. Kjo është dukshëm më pak se mesatarja e BE-27.[147] Nga ana

[145] Riinvest (2021), Anketa për Arsimin për të Rritur në Kosovë (drafti prill 2021).

[146] Eurostat, Metadata Reference për Anketën për Arsimin për të Rritur

[147] Në këtë pikë nuk mund të përcaktohet nëse shkalla e ulët e pjesëmarrjes është pjesërisht për shkak të kufizimeve ndaj COVID-19.

tjetër, mbi tre të katërtat e të gjithë të anketuarve treguan se janë përfshirë në një formë të të nxënit informal, vlerë e cila është më shumë se mesatarja në vendet anëtare të BE-së.[148]

TABELA 2 Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin për të rritur në Kosovë krahasuar me mesataren e BE-27

	Kosovë (2020, mosha 18-64)	BE-27 (2016)[149], mosha 25-64 vjeç; Britania e Madhe nuk përfshihet)
arsimi formal	14%	5.0%
arsimi joformal	13%	41.4%
të nxënit informal	78%	59.5%

Burimi: Prezantim nga autorët bazuar në Riinvest (2021).

Të rriturit e rinj janë ata që i përdorin më shumë ofertat e arsimit për të rritur. Rezultatet e studimit tregojnë se nivelet e pjesëmarrjes në të tri format e arsimit për të rritur janë më të lartat për të rriturit e moshës 18-34 vjeç, dhe se pjesëmarrja zvogëlohet me moshën.

Për më tepër, rezultatet e studimit tregojnë se pjesëmarrja në ARr është e lidhur fort me të hyrat e familjes. Pjesëmarrja në arsimin për të rritur rritet me rritjen e të hyrave mujore të familjes. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në arsimin formal u gjet në mesin e të anketuarve me të hyra familjare më shumë se 2,000 euro. Pjesëmarrja në programet e arsimit joformal ka më shumë gjasa të ndodhë në ekonomitë familjare me të hyra mesatare prej 800 deri në 1,200 euro, ndërsa nivelet e pjesëmarrjes në arsimin informal dhe aktivitetet e të nxënit janë shpërndarë në mënyrë të barabartë për të gjitha nivelet e ty hyrave familjare.

Në përgjithësi, janë të vogla ndryshimet mes pjesëmarrjes së meshkujve dhe femrave. Ekziston një prirje e lehtë që me rritjen e moshës burrat të marrin pjesë në arsimin për të rritur më shpesh sesa gratë. Në grupmoshën 45 deri 54 vjeç për shembull, përqindja e burrave pjesëmarrës është 58%, krahasuar me 42% gra. Në grupmoshat më të reja gratë kanë më shumë gjasa të marrin pjesë (deri në grupmoshën 35-44 më shumë se 50% e të gjithë pjesëmarrësve në arsimin formal dhe joformal janë femra). Ky ndryshim gjinor është më i theksuar në fushën e arsimit dhe të nxënit informal, ku vetëm në grupmoshën 18-24 përqindja e pjesëmarrësve femra e tejkalon pjesën e pjesëmarrësve meshkuj.

Dallimet gjinore bëhen më të dukshme në përzgjedhjen e fushave të aftësimit formal. Në përputhje me modelet tradicionale të zgjedhjes së punësimit, gratë janë më të interesuara në programet e përgjithshme dhe kualifikimin për shëndetin dhe mirëqenien, shkenca shoqërore, gazetari, juridik dhe arsim, ndërsa burrat kanë më shumë gjasa të marrin pjesë në programet e arsimit formal në TIK, inxhinieri dhe bujqësi.

[148] Dallimi thelbësor mes niveleve të pjesëmarrjes në të nxënit informal në Kosovë dhe BE-27 mund t'u atribuohet ndryshimeve në formulimin e pyetjeve të studimit.

[149] ARRr-ja tjetër evropiane do të zhvillohet në vitin 2022.

Në fushën e arsimit joformal, të dhënat tregojnë se mes të gjitha aktiviteteve të arsimit joformal, pjesa më e madhe ndodh në lidhje me punën (51%). Përkatësisht, motivimi për të marrë pjesë në aktivitete të arsimit joformal është kryesisht i lidhur me punën. Në pothuajse 60% të rasteve njerëzit ndjekin arsimin joformal për të përmirësuar perspektivat e tyre të karrierës, për të përmirësuar kapacitetin e tyre për punë, ose për t'u përgatitur për një ndryshim të punës. 28% e të gjithë të anketuarve tregojnë se marrin pjesë nga motivimi personal ("për të marrë njohuri të dobishme në jetën time të përditshme", "për të rritur njohuritë e mia në një temë që më intereson", "për të takuar njerëz të rinj/për argëtim" ose "për ta bërë më mirë punën time vullnetare").

Sidoqoftë, vetëm në 25% të të gjitha rasteve aktiviteti i të nxënit financohet nga punëdhënësi dhe në 37% të rasteve aftësimi zhvillohet gjatë orarit të paguar të punës. 18.7% e të gjitha aktiviteteve të arsimit joformal drejtohen në aftësimet në punë. Shumica janë kurse (57%) dhe punëtori (18%). Vetëm 6% e aktiviteteve zhvillohen në formë të orëve private.

Në lidhje me të nxënit informal, të anketuarit më shpesh raportojnë se mësojnë duke përdorur kompjuterë, online ose offline (28%) dhe se mësojnë duke përdorur material të shtypur, si libra ose revista profesionale (27%) (shih Tabelën 3). Të anketuarit ka më pak gjasa të mësojnë nga anëtarët e familjes, miqtë ose kolegët, gjë që mund të jetë pjesërisht për shkak të rregulloreve të distancimit social gjatë pandemisë COVID-19 të pranishme gjatë 12 muajve të fundit para anketës.

TABELA 3 Pjesëmarrja në të nxënit informal sipas formës së të nxënit

Forma e të nxënit	Shkalla e pjesëmarrjes
Të nxënit duke përdorur kompjuterë (online ose offline)	28%
Të nxënit duke përdorur material të shtypur	27%
Të nxënit përmes televizionit / radios / videove	23%
Të nxënit duke vizituar qendrat e të nxënit (përfshirë bibliotekat)	9%
Të nxënit përmes vizitave udhëzuese në muze, lokacione historike ose natyrore ose industriale	8%
Të nxënit nga një anëtar i familjes, mik apo koleg	5%

Burimi: Prezantim nga autorët bazuar në Riinvest (2021).

Siç u përmend më lart, pjesëmarrja në të nxënit informal zvogëlohet me rritjen e moshës. Të dhënat tregojnë se të nxënit me kompjuter është ende më pak i zakonshëm për njerëzit mes 55 dhe 64 vjeç; në këtë grupmoshë 20% tregojnë se mësojnë duke përdorur kompjuterin, krahasuar me 29% mes grupmoshës 25-34. Në mënyrë të ngjashme, personat më të moshuar i frekuentojnë qendrat e të nxënit ose bibliotekat shumë më rrallë (3.9%) sesa të rinjtë (16.4%). Nga ana

tjetër, personat e moshuar kanë më shumë gjasa sesa të rinjtë të mësojnë duke përdorur material të shtypur ose përmes TV ose radio.

Të anketuarit e justifikojnë mospjesëmarrjen në aktivitete arsimore formale dhe joformale me arsye të ngjashme. Kryesisht, njerëzit nuk marrin pjesë sepse detyrimet e tyre familjare ose profesionale nuk lënë kohë për aftësim ose arsimim të mëtejshëm (një arsye e zgjedhur nga 22% e të anketuarve). Mospasja e nevojës personale ose të lidhur me punën për arsim të mëtejshëm është një arsye tjetër për mospjesëmarrje. Rreth 7% tregojnë se mundësitë e aftësimit dhe arsimimit janë shumë të shtrenjta.

Si përmbledhje, rezultatet nga AARr-ja në Kosovë sugjerojnë që pjesëmarrja e përgjithshme e të rriturve në arsim dhe të nxënit është e ulët, veçanërisht në arsimin joformal, ku Kosova është shumë prapa niveleve të pjesëmarrjes në BE. Shumica e të anketuarve në anketë nuk janë të interesuar në arsimimin dhe të nxënit e vazhdueshëm, pasi vetëm 33% kërkojnë informacion në lidhje me mundësitë e mëtejshme të të nxënit. Të dhënat e AARr-së tregojnë se pjesëmarrja në të gjitha format e arsimit dhe të nxënit lidhet me treguesit socio-ekonomikë, siç janë mosha dhe të hyrat e familjeve në drejtimin e pritur. Gjinia udhëzon në përzgjedhjen e fushave të arsimit formal, dhe të dhënat sugjerojnë se burrat kanë më shumë të ngjarë të angazhohen në aftësime të mëtejshme me rritjen e moshës. Në përgjithësi, detyrimet familjare dhe profesionale i detyrojnë njerëzit të mos marrin pjesë në programet e arsimit për të rritur. Ajo që nxit pjesëmarrjen e të rriturve në AJF është konteksti i punës (përmirësimi i njohurive të lidhura me punën dhe perspektivat e karrierës). Në të njëjtën kohë, individët e interesuar rrallë marrin mbështetje nga punëdhënësit e tyre (qoftë financiare apo në terma kohorë).

Mes popullatës së të rriturve, arsimimi është ende i lidhur kryesisht me arsimin formal, aftësimin e lidhur me punën, ri-aftësimin dhe certifikimin. Nëse qëllimi i aftësimit të mëtejshëm është gjetja e një pune ose ngritja në shkallët e karrierës, pjesëmarrësit zakonisht janë shumë të motivuar. Në këtë mënyrë, të dhënat nga AARr-ja kryesisht reflektojnë përshtypjet që u përcollën edhe në intervista. Marrë parasysh ndërlidhjen e ngushtë të ARr-së me AAP-në në Kosovë, gjetja ose mbajtja e punësimit është motivi kryesor, veçanërisht për të rinjtë, për të marrë pjesë në kurse të arsimit të mëtejshëm.[150] Deri më sot, jo shumë njerëz marrin pjesë në arsimin për të rritur me motivacionin "e vetëm" të vetë-zhvillimit personal.

Me rritjen e fleksibilitetit që kërkohet nga tregu i punës që ndryshon, të rinjtë kanë filluar ta kuptojnë se arsimi i vazhdueshëm dhe të nxënit e vazhdueshëm bëhen gjithnjë e më të nevojshme për të mbijetuar në tregun e punës. Për ta, ARr dhe të nxënit gjatë gjithë jetës do të luajnë një rol shumë më të madh në të ardhmen.

[150] Kjo u sugjerua edhe nga partnerë të intervistuar nga sektori privat.

IX. Personeli mësimdhënës dhe profesionalizimi

Për zhvillimin e plotë të një infrastrukture të të nxënit gjatë gjithë jetës në çdo sistem arsimor, kualifikimi andragogjik i arsimtarëve për të rritur është një element thelbësor. Rezoluta e Këshillit të BE-së për një agjendë të ripërtërirë Evropiane për të nxënit e të rriturve thotë se "përmirësimi i cilësisë së stafit të arsimit për të rritur, për shembull duke përcaktuar profile të kompetencave, duke krijuar sisteme efektive për trajnim fillestar dhe zhvillim profesional, dhe duke lehtësuar lëvizshmërinë e mësimdhënësve, trajnerëve dhe stafit tjetër të arsimit për të rritur" është i nevojshëm për të rritur cilësinë dhe efikasitetin e arsimit dhe aftësimit.[151] Kjo nënkupton pamjaftueshmërinë e caktimit të mësimdhënësve, të cilët janë trajnuar për t'u dhënë mësim fëmijëve, në programet e arsimit për të rritur. Për dallim nga fëmijët, nxënësit e rritur tashmë kanë njohuri dhe shkathtësi dhe mund t'u referohen përvojave të tyre. Më shumë sesa mësimdhënësit në nivelin fillor dhe të mesëm, arsimtarët e të rriturve duhet të marrin rolin e tyre si udhëheqës të grupeve, lehtësues dhe trajnerë, një domosdoshmëri që paraqet kërkesa të ndryshme për kompetenca personale dhe shoqërore, si dhe metodike dhe didaktike të arsimtarëve.

Sot, hapësirat e punës së arsimtarëve për të rritur përmbajnë një gamë të larmishme aktivitetesh didaktike dhe jodidaktike. Aktivitetet didaktike përfshijnë të nxënit dhe këshillimin dhe planifikimin arsimor, mësimdhënien, udhëzimin për të nxënit, zhvillimin e materialit të të nxënit dhe arsimor, dhe vlerësimin. Veç kësaj, arsimtarët për të rritur mund të angazhohen edhe në detyra të menaxhimit dhe marketingut, punë me marrëdhëniet me publikun, si dhe punë të komitetit për politika arsimore. Shumëllojshmëria e aktiviteteve dhe fushat e fokusit të secilit arsimtar për të rritur, bëjnë që vendosja e një përkufizimi gjithëpërfshirës të standardeve të profesionalizimit dhe kualifikimit në ARr është thelbësore dhe e vështirë në të njëjtën kohë.

Në përgjithësi, kualifikimi profesional individual i arsimtarëve për të rritur bazohet në arsimin formal shkencor, si dhe në aftësimin e mëtejshëm formal dhe joformal në didaktikë dhe metoda. Përvetësimi sistematik i njohurive dhe shkathtësive praktike të bazuara në teori zakonisht transmetohet përmes sistemit arsimor (i cili në mënyrë ideale ofron arsim universitar për mësimdhënës në lëndë të caktuara, si dhe aftësim teorik dhe praktik në didaktikë dhe metodologji për të punuar me të rriturit). Arsimi formal akademik mund të zgjerohet dhe konsolidohet më tej individualisht përmes të nxënit vetanak informal. Për shembull, nga përmbajtja e të nxënit profesional-shkencor nga ueb faqe, revista, gazeta dhe konferenca.

Një mjedis profesional i të nxënit gjatë gjithë jetës karakterizohet më tej nga ekzistenca e komiteteve për politika dhe shoqatave profesionale të cilat rregullojnë dhe drejtojnë procesin e licencimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional (ZHVP). Zhvillimi i sektorit mund të drejtohet nga standarde të përbashkëta dhe precize profesionale dhe përshkrime të ndërmjetësuara nga shoqëria të sjelljes së pritur brenda fushës (në kuptimin e kompetencave dhe etikës së dëshiruar).

Të kombinuar, zhvillimi profesional, standardet e përbashkëta (etike) dhe orientimi shoqëror kanë potencialin për ta rritur njohjen publike të vlerës së arsimit për të rritur për shoqërinë dhe për të

[151] Komisioni Evropian (2011)

kontribuar në profesionalizimin e përgjithshëm të kësaj fushe arsimore.[152]

Për sa i përket karakteristikave të lartpërmendura të një mjedisi profesional të arsimit për të rritur (të udhëhequr nga ligjet, arsimi i vazhdueshëm, etika dhe shkëmbimi), niveli i profesionalizimit dhe zhvillimit profesional të ARr-së në Kosovë mbetet mjaft i ulët, me gjithë politikat dhe rregulloret ekzistuese që e adresojnë çështjen. Problemi i zhvillimit të pamjaftueshëm profesional nuk ekziston ekskluzivisht në arsimin për të rritur, por ka të bëjë me të gjitha fushat e arsimit. Në vitin 2016, më shumë se gjysma e mësimdhënësve në arsimin e mesëm ishin të pakualifikuar, dhe shumica e mësimdhënësve të AAP-së nuk kishin asnjë kualifikim për mësimdhënie.[153] Për më tepër, fakti që shumë mësimdhënësve të AAP-së u mungon aftësimi pedagogjik dukej se ishte i pranuar përgjithësisht.

Sot, Ligji Nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur nuk ka një dispozitë specifike që do të kërkonte nga trajnerët e ARr-së të kalonin një minimum aftësimesh specifike për ARr. Ligji Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional është më konkret. Neni 24 i kushtohet personelit mësimdhënës dhe thotë se "personeli mësimdhënës[...] duhet të posedojnë kualifikime adekuate profesionale[të cilat] do të rregullohen përmes normativës që përpilon MASHT-i".

Ka pasur disa zhvillime në lidhje me politikën dhe peisazhin institucional rreth ZHVP-së. Në vitin 2013, 25 qendra të zhvillimit të vazhdueshëm profesional u krijuan në 22 komuna nga Qendra për Arsim e Kosovës, dhe shkollat u inkurajuan të përgatisin planet e zhvillimit të mësimdhënësve dhe të krijojnë së bashku ekipe profesionale në shkolla. Duke iu referuar UA 09/2014, çdo mësimdhënës nën moshën 51 vjeç është i detyruar të marrë pjesë në ZHVP gjatë shërbimit (100 orë në 5 vjet).[154] Mes viteve 2012 dhe 2017, 96% e të gjithë mësimdhënësve janë licencuar zyrtarisht.[155]

Në Planin Strategjik aktual të Arsimit 2017-2021, nevoja për zhvillim profesional të trajnerëve për të rritur pasqyrohet në Objektivin Strategjik 6: Arsimi dhe Aftësimi Profesional dhe Arsimi për të Rritur. PSAK e pranon se mungesa e një sistemi arsimor efikas dhe cilësor është një sfidë e madhe për Kosovën. Prandaj, zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për menaxhimin e arsimit për të rritur duhet të jetë një qëllim deri në vitin 2021. Ofrimi i mundësive të aftësimit për stafin menaxherial në nivelin qendror, komunal dhe shkollor, dhe aftësimi i personelit shkollor për zbatimin e arsimit për të rritur (që përfshijnë menaxhimin e shkollës, koordinatorët, mësimdhënësit, monitoruesit) paraqiten si aktivitete të mundshme.

Në vitin 2017, MASHT-i propozoi një paketë ligjore e cila përcakton kryesisht procesin e zhvillimit të mësimdhënësve, miratoi Kornizën e Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve dhe publikoi edicionin e dytë të katalogut të programeve të aftësimit. Në vitin 2018, kishte 314 programe të aftësimit të mësimdhënësve në dispozicion (shumë të mbështetur nga partnerë ndërkombëtarë), por

[152] Lattke, S. & Strauch, A. (2019). Korniza e kompetencave për arsimtarët për të rritur në mësimdhënien e GCED, Instituti i UNESCO-s për të Nxënit Gjatë Gjithë Jetës. UNESCO Qendra Azi-Paqësor e Arsimit për Mirëkuptimin Ndërkombëtar

[153] Likaj, R. (2016). Zhvillimi i vazhdueshëm profesional për mësimdhënësit dhe trajnerët profesionalë në Kosovë. Fondacioni Evropian për Trajnime, f. 8

[154] Po aty.

[155] Likaj, R. (2019). Zhvillimi i vazhdueshëm profesional për mësimdhënësit profesionalë dhe drejtorët në Kosovë 2018. Fondacioni Evropian për Trajnime

shumica e tyre targetuan mësimdhënësit e arsimit bazë.[156]

Në shkollat e AAP-së personeli i mësimdhënies përbëhet nga mësimdhënës dhe instruktorë. Teksa mësimdhënësit janë më tepër përgjegjës për edukimin teorik në një lëndë të caktuar, instruktorët ofrojnë ndihmë në aftësimet praktike. Mësimdhënësit në AAP zakonisht kualifikohen me bachelor tre ose katër vjeçar ose master (pas diplomës bachelor). Instruktorëve u duhet një diplomë mbi nivelin e mesëm dhe 5 vjet përvojë pune në fushën përkatëse. Mësimdhënësit në shkollat e AAP-së nuk janë nëpunës civilë por të punësuar direkt nga komunat. Në QAP-të, mësimdhënësit quhen trajnerë. Për dallim nga mësimdhënësit e AAP-së, trajnerët e QAP-së janë nëpunës civilë të punësuar nga APRK-ja. Shumica e trajnerëve kanë diploma universitare, sepse për të qenë nëpunës civil diploma universitare është parakusht për punësim. Sidoqoftë, siç shpjegohet nga një prej partnerëve të intervistuar, kërkesa e arsimit të lartë për trajnerët në QAP mund të paraqesë sfida praktike për punësimin, pasi mësimdhënësit me përvojë të mjeshtërisë zakonisht nuk posedojnë diploma universitare.[157] Nevoja e posaçme për kualifikim andragogjik mes trajnerëve ose mësimdhënësve për të rritur, në krahasim me kualifikimet pedagogjike, nuk është përfshirë në mënyrë të qartë në kornizën strategjike për zhvillimin profesional të mësimdhënësve në Kosovë.

Raporti "Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional për Mësimdhënësit Profesionalë dhe Drejtorët në Kosovë 2018" botuar nga Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF) vëren se gjatë vitit të parë të PSAK 2017-2021 "26.6% e mësimdhënësve të AAP-së morën të paktën 30 orë ZHVP" dhe rikujton në të njëjtën kohë se "këto nivele nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur objektivat e përcaktuara në PSAK" dhe se "ka pasur pak progres në lidhje me arsimin fillestar për mësimdhënësit e AAP-së".[158] Një përshtypje e ngjashme është përcjellë nga Raporti i BE-së për vitin 2020, i cili zbulon se "mësimdhënësit në qendrat e AAP-së kanë kualifikimet e nevojshme formale, por nuk janë të pajisur me mundësi të përshtatshme për zhvillim profesional".[159] Përveç kualifikimit të tyre bazë, mësimdhënësve u mungojnë shkathtësitë praktike dhe metodologjike. Sipas raportit afatmesëm të PSAK, nuk është zhvilluar asnjë aktivitet në lidhje me ofrimin e mundësive të aftësimit për stafin menaxherial në nivelin qendror, komunal dhe shkollor, dhe për aftësimin e stafit shkollor për zbatimin e arsimit për të rritur.

Raporti i ETF 2018 për ZHVP-në për mësimdhënësit e AAP-së në Kosovë për vitin 2018 identifikon pengesa të shumta që mund të shpjegojnë dobësinë e zhvillimit të mësimdhënësve në AAP dhe arsimin për të rritur:

- Nuk ka koordinim mes aktorëve kyç në nivelin shtetëror
- Mungesa e menaxhimit efektiv të burimeve, mungesa e fondeve për ZHVP në AAP nga qeveria
- Mungesa e vlerësimit gjithëpërfshirës të performancës së mësimdhënësve
- Menaxhimi joefikas i shkollave të AAP-së (menaxhim nga burra të moshuar pa përvojë, ndikim i fortë politik, fuqi e kufizuar e vendimmarrjes)

[156] Mehmeti, S. et al. (2019), f. 95

[157] Intervistë me përfaqësues të MPMS-së

[158] Likaj, R. (2019)

[159] Komisioni Evropian (2020), f. 85.

- Zhvillimi i kurrikulës për aftësimin e mësimdhënësve nuk përfshin organizatat e punëdhënësve
- Nevojat për aftësim nuk janë identifikuar
- Numër i kufizuar i ofruesve të aftësimit
- Me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, MASHT-i zhvilloi një standard profesional në nivelin 7 të ISCED për mësimdhënësit profesionalë, i cili duhet ende të aprovohet.[160]

Ofruesi kryesor i aftësimit të mësimdhënësve para shërbimit është Universiteti i Prishtinës me Fakultetin e Edukimit. Fakulteti i Edukimit aktualisht ofron diplomë master për mësimdhënësit e AAP-së "Master i Pedagogjisë për Shkollat Profesionale". Programi i studimit është i kufizuar në 40 vende të hapura në vit. Në vitin 2018, Fakulteti, në bashkëpunim me MASHT, UNICEF dhe KAPIE, zbatoi aftësime gjithëpërfshirëse për arsimtarët fillorë dhe të kopshteve në kuadër të projektit "Zhvillimi profesional i mësimdhënësve për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës".[161] Sipas një raporti në lidhje me "Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve në Kosovë", Fakulteti i Edukimit është autorizuar nga MASHT-i për të udhëhequr zhvillimin profesional të mësimdhënësve, një informacion i cili deri më tani ka mbetur pa ndonjë marrëveshje publike me shkrim.[162]

Kur flitet për aftësimin e mësimdhënësve në shërbim, KEC dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK)[163] ofrojnë aftësime për trajnerë për të nxënit e të rriturve. IPK-ja është një institucion i pavarur, publik që merret me hulumtime, aftësime, vlerësime, eksperimentime dhe inovacione në fushën e arsimit. Ndër objektivat e tjerë synon rritjen e ndjeshmërisë së shoqërisë kosovare për rëndësinë e të nxënit gjatë gjithë jetës. Ai ofron këshilla profesionale për MASHT-in dhe institucionet arsimore në fushat e zhvillimit të kurrikulës, standardeve arsimore, teksteve shkollore, vlerësimit, aftësimit të mësimdhënësve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore.

Financiarisht dhe teknikisht, një shtysë e madhe për profesionalizimin e stafit mësimdhënës në Kosovë vjen nga organizata joqeveritare dhe ndërkombëtare (shih Kapitullin X). Sidoqoftë, shumica e projekteve adresojnë mësimdhënësit në arsimin bazë dhe të mesëm.

Kontributi i veçantë në fushën e arsimit për të rritur sigurohet nga një sërë aktivitetesh të projektit të zbatuara nga DVVI.[164] Aftësimi i mësimdhënësve në metodologji dhe didaktikë të arsimit për të rritur është ndër pikat kryesore të punës së DVVI në Kosovë. Përqasja është pajisja e mësimdhënësve me kualifikim themelor pedagogjik dhe personel administrativ me njohuri mbi parimet e arsimit për të rritur që mund të zbatohen në arsimin joformal dhe në qendrat e aftësimit profesional.

DVVI Kosova promovon zbatimin e Curriculum GlobALE (CG), një "kurrikulë bërthamë ndër-kulturore për aftësimin e arsimtarëve për të rritur në të gjithë botën", e zhvilluar nga DIE dhe DVVI. Curriculum GlobALE përcakton shkathtësitë e nevojshme për të edukuar me sukses të rritu-

[160] Qeveria e Republikës së Kosovës (2019), f. 55

[161] Universiteti i Prishtinës, Vjetari 2019

[162] Mehmeti, S., Rraci, E. & Bajrami, K. (2019). Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë. Prishtinë: KEEN, f. 32

[163] Ueb faqja e Institutit Pedagogjik të Kosovës

[164] Alija, R. (2018). Të nxënit e të rriturve në Republikën e Kosovës

rit dhe përmban udhëzime dhe këshilla për trajnerët mbi didaktikën, metodat dhe vlerësimin. Kurrikula është përkthyer në gjuhën shqipe dhe u është shpërndarë ofruesve të arsimit për të rritur në Kosovë. Kohët e fundit DVVI ka publikuar pesë module për arsimin për të rritur në Kosovë.[165]

Në bashkëpunim me APRK-në, DVVI Kosova organizon rregullisht aftësime për modulet e CG-së për trajnerë nga QAP-të dhe QK-të. Ajo bashkëpunon edhe me Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës për ofrimin e aftësimeve. Profesorët e fakultetit rregullisht shërbejnë si trajnerë në kurse aftësimi të DVVI-së. Në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Universitetin e Prishtinës, DVVI Kosova ka siguruar aftësime për 57 trajnerë nga QAP-të.[166]

Marrë parasysh gjendjen aktuale të profesionalizimit në fuqinë punëtore të mësimdhënësve kosovarë, përqendrimi i përpjekjeve të shtetit për rregullimin e ZHVP-së në arsimin bazë dhe të mesëm është i arsyeshëm. Megjithëse ka hapësirë për përmirësim, ZHVP-ja në arsimin profesional ka marrë vëmendje në rritje, çka mund të konsiderohet si një hap i parë i rëndësishëm. Ajo që mungon deri më tani është të kuptuarit e përbashkët i standardeve profesionale dhe etike dhe orientimit shoqëror mes arsimtarëve për të rritur në sistemin formal dhe joformal të ARr-së, të kuptuar që thekson kërkesat e veçanta të profesionit të arsimit për të rritur. Me nxitje nga Ministria e Arsimit dhe palët e interesit me ndikim si DVVI, të kuptuarit e përbashkët mund të kontribuojë në profesionalizimin e kësaj fushe arsimore dhe të rrisë njohjen publike të vlerës së arsimit për të rritur për shoqërinë.

[165] Artikull në ueb faqen e DVV International, "Publikimi i pesë moduleve të Curriculum GlobALE"

[166] Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2015), f. 98

X. Konteksti ndërkombëtar

Në nivelin ndërkombëtar, përpjekjet më domethënëse për të përmirësuar arsimin dhe të nxënit e të rriturve vijnë nga institucionet e Kombeve të Bashkuara. Shembuj të shquar janë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të cilat targetojnë të nxënit dhe arsimin për të rritur si pjesë e OZHQ 4 "Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë", dhe Instituti i UNESCO-s për të Nxënit Gjatë Gjithë Jetës si dhe Konferencat e tij Ndërkombëtare për Arsimin për të Rritur (CONFINTEA). Meqenëse Kosova aktualisht nuk është anëtare e OKB-së, ajo nuk mund të marrë pjesë në programet e tyre për NARr.

Sidoqoftë, institucionet kosovare janë të përkushtuara ndaj OZHQ-ve dhe përpiqen t›i përmbushin ato si pjesë e përpjekjeve të tyre për integrim evropian.[167] Kosova mori pjesë në Akademinë Rajonale Andragogjike (ARA), një rrjet i institucioneve të arsimit për të rritur, i cili deri në vitin 2015 organizoi pesë takime ndërkombëtare shkëmbimi dhe aftësimi me përfaqësues nga rajoni i Evropës Juglindore. Rrjeti ishte krijuar si vazhdim i CONFINTEA VI. Për më tepër, Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) e mbështeti qeverinë për krijimin e strukturave menaxhuese që lejojnë integrimin e OZHQ-ve në kornizat kombëtare të planifikimit strategjik. Në vitin 2018 u krijua Këshilli Kombëtar për Zhvillim të Qëndrueshëm, i cili do të koordinojë aktivitetet e OZHQ. Megjithatë, planet dhe veprimet konkrete për të zbatuar OZHQ-të mbeten përgjithësisht të kufizuara. Nevoja e madhe për të arritur këtë është nënvizuar në raportin "Kosova dhe Agjenda 2030: nga retorika politike në veprime konkrete" hartuar nga Instituti Kosovar për Politika Zhvillimore (INDEP)[168]. Është vërejtur se "pavarësisht nga disa përpjekje për të ndezur shkëndijat e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), institucionet e Kosovës kanë vazhduar ta injorojnë rëndësinë e Agjendës 2030".

Në vitin 2020, Kosova mbetet ende një pranuese neto e Asistencës Zyrtare për Zhvillim (AZZH). Të dhënat për veprimtaritë e donatorëve ndërkombëtarë në Kosovë jepen në Statistikat e OECD-së për Asistencën.[169] Në vitin 2017, asistenca zyrtare për zhvillim për Kosovën arriti në 5.4% të GNI-së së saj. Në përgjithësi, shuma ka rënë kohët e fundit, por Kosova është ende në mesin e atyre vendeve me raportin më të lartë të AZZH për kokë. Me 157 milionë dollarë për AZZH bruto, institucionet e Bashkimit Evropian ishin kontribuuesit më të mëdhenj. Partnerët më të rëndësishëm dypalësh ishin Shtetet e Bashkuara, Gjermania dhe Zvicra, të ndjekura nga Suedia, Turqia, Austria dhe Luksemburgu. Një partner tjetër i rëndësishëm ndërkombëtar është OSBE-ja. Rreth 9% e të gjithë AZZH bilaterale i ishte dedikuar arsimit në vitin 2017.

Kontributi më i targetuar ndërkombëtar për avancimin e NARr-it në Kosovë sigurisht sigurohet nga DVVI, strategjia dhe programet e së cilës

[167] Ueb faqja e Agjencisë Evropiane të Mjedisit, informim "Profili i vendit i Kosovës - OZHQ-të dhe mjedisi"

[168] Kalldura, H. & Ejupi, B. (2019). Kosova dhe Agjenda 2023: nga retorika politike në veprime konkrete. Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

[169] OECD (2020). Vlerësimet e homologëve të bashkëpunimit për zhvillim nga OECD-ja: Austria 2020 - vizitë në terren në Kosovë

përshkruhen në detaje në Kapitullin VI. Partnerë të tjerë ndërkombëtarë aktivë në sektorin e arsimit zakonisht merren me arsimin për të rriturit si çështje anësore. Edhe pse i targetojnë të rriturit me projektet e tyre arsimore, në pjesën më të madhe organizatat ndërkombëtare nuk e përmendin arsimin për të rriturit si temë të qartë në prezantimet e projekteve të tyre.

Bashkimi Evropian menaxhon ndihmën financiare për Kosovën nën Instrumentin e Ndihmës së Para-Anëtarësimit II (IPA II). Mes viteve 2018 dhe 2020 u akorduan 41.5 milionë euro për sektorin e "Politikave të arsimit, punësimit dhe sociale".

Ndoshta instrumenti më i shquar i BE-së për të nxitur arsimin dhe të nxënit informal, lëvizshmërinë ndërkombëtare dhe shkëmbimin mes të rinjve në Evropë, është programi Erasmus+, i cili mbikëqyret nga Agjencia Ekzekutive Evropiane e Arsimit, Audiovizualit dhe Kulturës (EACEA).

Platforma e Rezultateve të Projektit Erasmus+ tregon se aktualisht ka 25 projekte të bazuara në Kosovë. Prej vitit 2015, 2.800 studentë dhe anëtarë stafi morën pjesë në shkëmbimet Erasmus+. Projektet Erasmus+ mbështeten nga Zyra Erasmus+ në Prishtinë dhe zyra e degës së saj në Mitrovicën e Veriut.

Ueb faqja KOSOVOPROJECTS.EU[170] jep pasqyrën e projekteve të financuara nga BE-ja të zbatuara në Kosovë. I vetmi projekt aktual i BE-së që adreson NARr-in informal në kuptimin e gjerë është projekti "Kultura për Ndryshim", zbatuar nga Qendra Multimedia në bashkëpunim me Institutin Goethe gjerman. Në kuadër të projektit, anëtarët e stafit nga organizatat kulturore përfitojnë nga ndërtimi i kapaciteteve dhe qytetarët nga ekspozimi ndaj aktiviteteve kulturore.[171]

Kohët e fundit është konkluduar projekti "Rrjeti i Arsimit në Kosovë për Punësim" (KEEN)[172]. Së bashku me Qendrën për Arsim të Kosovës si agjenci kombëtare zbatuese, BE-ja mbështet OSHC-të kombëtare për të monitoruar në mënyrë të qëndrueshme politikat kryesore kombëtare dhe lokale mbi arsimin, aftësimin dhe punësimin, dhe për të përmirësuar dhe vendosur lidhje mes programeve të arsimit dhe aftësimit dhe tregut të punës. Projekti u zhvillua mes viteve 2015-2019. Ndër të tjera, KEEN ka publikuar vlerësimin afatmesëm të PSAK 2017-2021 dhe një raport mbi strategjinë sektoriale të MPMS-së.

USAID[173] e ndihmon Kosovën prej 19 vitesh, dhe megjithëse ka një fokus të qartë tek të rinjtë, aktualisht zbaton disa projekte të cilat gjithashtu përmbushin qëllimet e arsimit për të rriturit në kuptimin e gjerë. Për shembull, nga viti 2017 deri në vitin 2022, USAID-i zbaton projektin «Mbështetja pas shkollës për adoleshentët" në bashkëpunim me KEC. Projekti, përveç ofrimit të mbështetjes së drejtpërdrejtë këshilluese për personat që largohen nga shkolla, ofron aftësim për zhvillim profesional dhe udhëzim për mësimdhënësit. Projekti "Angazhimi për Barazi" (2015-2020) i realizuar në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) fuqizon grupe të margjinalizuara dhe ka angazhuar "mbi 1.5 milion njerëz në edukimin qytetar mbi të drejtat pronësore të grave, gratë në qeverisje dhe ekonomi, paran-

[170] Ueb faqja e projekteve në Kosovë
[171] Ueb faqja e projektit Kultura për Ndryshim
[172] Ueb faqja e KEEN
[173] Ueb faqja e USAID-it, fakte për Kosovën

dalimin e ekstremizmit të dhunshëm, përmirësimin e situatës së popullatave të cenueshme dhe të drejtat e PAK". Për më tepër, USAID mbështet të nxënit joformal të të rinjve me projekte si "Dialogu i Rinisë së Kosovës" dhe "I takon Rinisë".

Ngjashëm me USAID-in, Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) është një partner i vjetër për Kosovën. Mes viteve 2014 dhe 2016, projekti "Mbështetje për qendrat e kompetencave në kontekstin e reformave të arsimit profesional dhe aftësimit në Kosovë" ofroi këshilla për krijimin e AAAPARr, e cila sot është përgjegjëse për mbikëqyrjen e sistemit të arsimit për të rritur në Kosovë. Projekti "Rinia, Punësimi dhe Aftësitë në Kosovë" (YES) (2017-2020)[174] synon të përmirësojë cilësinë e AAP-së. Ndër masat e tjera të projektit, ai promovon zhvillimin e një standardi kosovar për trajnerët brenda kompanisë, pas një programi pilot për zhvillimin e trajnerëve master dhe trajnerëve në kompani. Për më tepër, projekti krijoi "Platformën e të Nxënit Yes" online. Nga viti 2019 deri në vitin 2021, GIZ zbaton projektin "Zhvillimi i kapaciteteve në sektorin e arsimit bazë në Kosovë" (CDBE).[175] Projekti synon të trajtojë mangësitë në sektorin e arsimit përmes aftësimit të mësimdhënësve. Qasja është integrimi në kurrikulën e rregullt universitare i modeleve të suksesshme të zhvillimit profesional për mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave.

Me projektin "Drejtësia Sociale për Romët, Ashkalitë dhe Egjiptasit" (SORAE) (2020-2022) Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) synon të sigurojë qasje më të mirë në mundësitë arsimore për grupet e pakicave etike përmes krijimit të Qendrave të të Nxënit joformal. Projekti "EYE - Rritja e punësimit të të rinjve"[176] synon të rrisë punësimin e të rinjve përmes një sistemi aftësimi më të orientuar drejt tregut. Projekti EYE bashkëpunon me ofruesit e aftësimit joformal dhe institucionet e arsimit formal.

Agjencia Austriake për Zhvillim[177] i kushton arsimit 69% të shumës totale për financimin e projekteve në Kosovë. Fusha prioritare për ndërhyrjen austriake është arsimi i lartë; projekte të tjera siç janë "Përafrimi i arsimit dhe aftësimit me nevojat e tregut të punës" (ALLED) dhe "Punësimi i të rinjve përmes shkathtësive të zgjeruara në qendrën e aftësimit Meister" përqendrohen në arsimin dhe aftësimin profesional dhe përputhjen e arsimit me nevojat e tregut të punës.

Bashkëpunimi i Luksemburgut për Zhvillimin (LuxDev)[178] mbështet Kosovën me dy projekte madhore në sektorin e "Arsimit - Aftësimit Profesional dhe Qasjes në Punësim". Projekti "Mbështetje për Reformën e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) në Kosovë" (2018-2022), mbështet AAAPARr dhe DKA-të për të përmirësuar procesin e planifikimit financiar për shkollat e AAP-së. Si pjesë e projektit, LuxDev siguroi mbështetje financiare dhe asistencë teknike për zhvillimin e platformës udhëzuese për karrierë, platformën për informacion dhe të nxënit Busulla.COM[179] (GIZ dhe USAID gjithashtu ishin të përfshirë). Në vitin 2019, portalit iu dha çmimi "Shërbimi

[174] Ueb faqja e projektit YES
[175] Ueb faqja e GIZ-it projekti CBDE
[176] Ueb faqja e Projektit EYE të SDC-së
[177] Ueb faqja e Agjencisë Austriake për Zhvillim projektet në Kosovë
[178] Ueb faqja e LuxDev projektet në Kosovë
[179] Ueb faqja e platformës https://busulla.com

më i mirë publik i vitit në Kosovë".[180] Portali së shpejti do të sigurojë edhe informacion në lidhje me ofertat e mëtejshme të aftësimit në QAP. Për më tepër, projekti mbështeti zhvillimin e QK-së për TIK në Prishtinë për të shkuar përtej ofrimit vetëm të arsimit formal dhe drejt ofrimit të shërbimeve gjeneruese të të hyrave (siç janë kurse të shkurtra, arsim për të rritur dhe trajnim në punë).

LuxDev, në bashkëpunim me MASHT-in, zbaton projektin "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP), Rikualifikimin Profesional dhe Profesionin (ES-VET PRO)" (2020-2022) i financuar nga Komisioni Evropian. Partnerët duan të përmirësojnë cilësinë dhe relevancën për tregun e punës të programeve të arsimit dhe aftësimit, dhe të zhvillojnë ofrimin e njohjes së të nxënit paraprak.

Fondacioni Evropian për Trajnime (aktiv në Kosovë prej vitit 1999) bashkëpunon dhe plotëson punën në Kosovë të Komisionit Evropian dhe Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm.[181] Në fillimin e viteve 2000, ETF mbështeti Observatorin e Punësimit dhe Shkathtësive të Kosovës (OPSHK) për hartimin e një Strategjie të të Nxënit për të Rriturit për Kosovën, e cila kishte një perspektivë dhjetë vjeçare (2005-2015).[182] Sidoqoftë, shumë konsiderata mjaft serioze të përshkruara në punim duket se nuk kanë arritur asgjë në fund. Në vitin 2020, ETF u përqendrua në zhvillimin e rolit dhe kapacitetit të aktorëve kombëtarë me këshilla të politikave për të përmirësuar punësimin e grave dhe grupeve të cenueshme. Gjithashtu u dha mbështetje për të përmirësuar menaxhimin e sistemit të AAP-së. dhe aktivitetet vazhduan në zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe trajnerëve të AAP-së dhe drejt krijimit të një platforme të Qendrave të Ekselencës në Arsimin dhe Aftësimin Profesional. Kosova merr pjesë në Procesin ETF të Torinos, "një proces pjesëmarrës që çon në një analizë të bazuar në dëshmi të politikave të arsimit dhe aftësimit profesional [...] në një vend".

E udhëhequr nga interesi i saj për anëtarësim në BE, Kosova tashmë ka marrë pjesë në PISA-n e udhëhequr nga OECD-ja dhe në Studimin Ndërkombëtar të Trendeve në Matematikë dhe Shkencë (TIMSS). Deri më tani, nuk ka marrë pjesë ende në Anketën e OECD-së për Shkathtësitë e Të Rriturve (PIAAC) (shih Kapitullin VIII).

Edhe pse Kosova nuk është anëtare e OKB-së, ajo është e gatshme për të ndjekur zhvillimet ndërkombëtare në lidhje me ofrimin e arsimit cilësor dhe mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës, përfshirë arsimin për të rritur dhe AAP. Përpjekjet kombëtare pasqyrohen në ligjet, politikat dhe strategjitë relevante. Me ndihmën e konsiderueshme ndërkombëtare, zhvillimi i sektorit formal të AAP-së në Kosovë ka bërë përparim të dukshëm. Mbështetja ndërkombëtare për sektorin e arsimit për të rritur ka qenë më pak e targetuar. DVVI është e vetmja organizatë ndërkombëtare që vepron në Kosovë, e cila ia kushton të gjithë programin e saj nxitjes së arsimit për të rritur. Donatorë të tjerë e trajtojnë ARr-në pjesërisht përmes angazhimit të tyre në zhvillimin profesional të arsimtarëve të AAP-së, zhvillimin e kurrikulës dhe përputhjen e përmbajtjes së arsimit me nevojat e tregut të punës.

[180] ETF Jeto & Mëso 44/2019 artikulli "Udhëzimi për karrierën kalon online në Kosovë", f. 23

[181] Ueb faqja e ETF-së projektet e Kosovës

[182] Observatori i Punësimit dhe Shkathtësive të Kosovës (2004). Integrimi me Evropën: një strategji e të nxënit të të rriturve për Kosovën (2005 - 2015)

XI. Sfidat dhe zhvillimet në të ardhmen

Sfida kryesore për zhvillimin e ardhshëm dhe ofrimin e arsimit cilësor për të rritur lidhet me nivelin e politikave. Përkundër faktit se ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse janë në fuqi, ato në të vërtetë rregullojnë vetëm pjesën formale të ARr-së ose arsimit bazë kompensues. Edhe pse të nxënit gjatë gjithë jetës përcaktohet si term në legjislacion, arsimi për të rritur parashikohet vetëm si pjesë e AAP-së dhe nuk përfshin aktivitete të tjera joformale të të nxënit të të rriturve. Marrë parasysh situatën e përgjithshme ekonomike në Kosovë, është e arsyeshme që zhvillimi i kapitalit njerëzor është prioritet për shumë politikëbërës. Sidoqoftë, nuk duhet të neglizhohet vlera e shtuar e arsimit joformal për të rritur për zhvillimin shoqëror. Një parakusht themelor për njohjen e arsimit për të rritur në mesin e të gjitha palëve të përfshira të interesit, është njohja e arsimit për të rritur si një nën-sistem i veçantë dhe i pavarur i arsimit, më e rëndësishmja në dokumentet strategjike siç është Plani Strategjik i Arsimit i Kosovës.

Kur flitet për arsimin joformal, terminologjia e përshkruar në legjislacionin ekzistues nuk është në përputhje me terminologjinë e BE-së. Shumë programe kosovare për ARr quhen joformale, ndërsa sipas terminologjisë së BE-së ato duhet të konsiderohen formale, pasi ato ofrohen nga institucionet arsimore dhe të njohura në KKK. Në mënyrë që të shmanget konfuzioni konceptual mes politikëbërësve, partnerët nga sektori i biznesit dhe shoqëria civile, si dhe autoritetet pjesëmarrëse, në të ardhmen duhet të bëjnë përpjekje për ta specifikuar më tej terminologjinë e arsimit për të rritur për kontekstin kosovar.

Drejtimi i arsimit për të rritur aktualisht ndahet mes një numri të palëve të interesit, siç janë Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Agjencia e Punësimit dhe AKK-ja. Sidoqoftë, roli i sektorit të shoqërisë civile mbetet i nënvlerësuar. Një përfshirje më aktive e shoqërisë civile mund të ndihmojë në hapjen e interpretimit të ngushtë ekonomik të arsimit për të rritur drejt integrimit të perspektivës individuale, shoqërore dhe të qytetarisë gjithashtu. Prandaj, ekziston një nevojë për reformë në ARr duke filluar nga politika dhe legjislacioni. Duhet të shqyrtohen dhe vlerësohen cilësimet funksionale dhe rolet e palëve të interesit, dhe mekanizmat e zhvilluar, për të zbatuar politika cilësore të ARr-së me një perspektivë holistike të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Politikat e arsimit për të rritur ndikojnë në financimin e ARr-së, por jo në një mënyrë mundësuese; aktualisht ato duket se i kufizojnë mundësitë. Kur flitet për financimin publik, ka një mungesë të një vije buxhetore të veçantë për ARr, pasi në shkollat publike të AAP-së fondet shpërndahen si pjesë e buxhetit të përgjithshëm të AAP-së. Sipas dispozitave ligjore, shkollat e AAP-së mund të gjenerojnë të hyra përmes tarifave të shkollimit për kurset e tyre për të rritur. Sidoqoftë, legjislacioni në fuqi ndiqet nga procedura të ngurta administrative që pengojnë përdorimin e të hyrave vetanake të krijuara. QAP-të përballen edhe me sfida për shkak të mungesës së autonomisë financiare dhe mungesës së një vije buxhetore të veçantë për ofrimin e ARr-së. OJQ-të përballen me fonde të pakta dhe të paqëndrueshme, dhe shumë prej tyre kanë kapacitet të pamjaftueshëm për të aplikuar për fonde ndërkombëtare. Në përgjithësi, aftësia e sektorit për të planifikuar dhe zbatuar ARr pengohet nga kufizimet financiare dhe varet nga financimi i vazhdueshëm i donatorëve.

Deri më sot, monitorimi dhe menaxhimi i të dhënave në nivelin kombëtar në lidhje me ARr, është i paplotë. Në mënyrë që të lejohet planifikimi i bazuar në dëshmi dhe zhvillimi sistematik në të ardhmen, nevojitet një sistem gjithëpërfshirës i monitorimit dhe vlerësimit të arsimit për të rritur që mbulon të gjitha llojet e ofertave të ARr-së, përfshirë programet joformale nga sektori i shoqërisë civile.

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve mbetet një sfidë për të gjithë sektorin e arsimit, veçanërisht në fushën e arsimit për të rritur, ku rregullimi ekzistues është i paqëndrueshëm. Nga njëra anë, mësimdhënësve që japin arsim kompensues si pjesë e AAP-së u kërkohet teorikisht të kenë diplomë të nivelit universitar, kurse instruktorët duhet të paraqesin një diplomë të shkollës së mesme, me një specializim relevant dhe përvojë pune në fushën profesionale. Për më tepër, ata duhet të ndjekin aftësime gjatë punës, përfshirë aftësime pedagogjike dhe didaktike. Kërkesa e arsimit të lartë për trajnerët në QAP mund të paraqesë sfida praktike për punësimin, pasi mësimdhënësit me përvojë të mjeshtërisë zakonisht nuk posedojnë diploma universitare. Nga ana tjetër, jashtë mjedisit formal të shkollave të AAP-së dhe QAP-ve, arsimi për të rritur ofrohet kryesisht nga ekspertë të fushës pa ndonjë aftësim në didaktikë dhe metodologji të punës me të rriturit. Sfida është mungesa e të kuptuarit të përbashkët në lidhje me parakushtet profesionale të arsimtarëve për të rritur, cilësitë, kërkesat e zhvillimit dhe etikën. Mundësitë për zhvillim profesional duhet të garantohen përgjithësisht për të gjithë mësimdhënësit dhe trajnerët për të rritur, pasi ato janë një parakusht për sigurimin e cilësisë së ARr-së.

Pandemia COVID-19 i ka vënë një barrë shtesë sistemit tashmë të brishtë të arsimit për të rritur. Mes majit dhe dhjetorit 2020, ofruesit e ARr-së nuk ishin në gjendje të ofrojnë aftësime sy më sy për shkak të kufizimeve të pandemisë. Kudo që ishte e mundur dhe në varësi të specifikave të profilit profesional, aftësimet u kaluan online. Duke filluar nga shtatori 2020, arsimi në klasë ka rifilluar në tre faza në varësi të rajonit dhe numrit të infeksioneve. Ofruesit ishin në gjendje të rifillonin aktivitetet sy më sy por me një numër të kufizuar të nxënësve për klasë dhe duke respektuar masat e tjera parandaluese të kërkuara nga qeveria. Disa ofrues vazhduan në mënyrën e përzier të të nxënit (një javë në orë sy më sy dhe një javë tjetër duke ndjekur orë online). Në rast të rritjes së numrit të infeksioneve, ata janë të detyruar të kalojnë vetëm në aktivitete online. Sidomos për ofruesit më të vegjël të ARr-së, pandemia ka paraqitur një numër sfidash. Nga njëra anë, shumë ofruesve u mungon infrastruktura e nevojshme (siç janë PC ose laptopë) për të vazhduar me ofrimin online të kurseve të ARr-së. Shumica e materialeve arsimore janë të shtypura dhe jo të disponueshme online. Nga ana tjetër, stafit mësimdhënës i mungojnë shkathtësitë përkatëse të TIK-ut dhe shkathtësitë didaktike dhe pedagogjike për të menaxhuar orët online. Ofruesit privatë të ARr-së, si pjesë e AAP-së, janë kryesisht të prekur nga pandemia COVID-19 duke marrë parasysh mungesën e mbështetjes financiare nga qeveria.

XII. Konkluzionet dhe rekomandimet

Analiza e ligjeve, politikave dhe strukturave drejtuese në ARr në Kosovë tregon se zhvillimi i kapitalit njerëzor është fushë prioritare për qeverinë. Janë bërë shumë përpjekje për të zhvilluar struktura që lehtësojnë të kuptuarit dhe krahasueshmërinë e kualifikimeve, siç janë KKK dhe sistemi për NjNP. Këto procedura të sigurimit të cilësisë i bëjnë rezultatet e të nxënit transparente dhe u lejojnë nxënësve të përparojnë nëpër nivele të ndryshme të KKK-së, madje edhe në mënyrë të pandërprerë, çka është e rëndësishme për nxënësit e rritur. Por, ndërlidhja e ngushtë e ARr-së me sektorin e AAP-së mbart rrezikun e shoqërimit të ARr-së në mënyrë të njëanshme me AAP-në formale dhe zhvillimin profesional fillestar. Kështu që rekomandohet fuqimisht që të shpalosen mundësitë për një sistem më vete të arsimit për të rritur, i cili e realizon konceptin e të nxënit gjatë gjithë jetës dhe nuk e kufizon aftësimin e mëtejshëm në arsimin dhe aftësimin fillestar ose kompensues. Një hap i parë është specifikimi i terminologjisë për ARr në ligje dhe dokumente themelore. Një hap i dytë mund të jetë përfshirja e ARr-së si kapitull i veçantë në Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës ose zhvillimi i një strategjie specifike të ARr-së. Rezultatet e Studimit të Arsimit për të Rritur dhe anketa e vitit 2021 duhet të konsultohen dhe analizohen për të siguruar që rishikimet e ardhshme legjislative dhe vendimet e politikave të bazohen në dëshmi.

- → Të definohet të kuptuarit e përbashkët qartësisht i dallueshëm i ARr-së.
- → Të promovohet përfshirja e ARr-së si kapitull i veçantë në PSAK dhe të vlerësohen mundësinë e zhvillimit të një strategjie specifike të arsimit për të rritur.
- → Të sigurohet politikëbërje e bazuar në dëshmi duke i konsultuar dhe përfshirë rezultatet nga anketat më të fundit të popullatës dhe projektet e praktikave më të mira.

Nga pikëpamja historike, qëllimi politik i ARr-së ka qenë gjithmonë ulja e niveleve të larta të papunësisë. Teksa Kosova ka bërë progres në instalimin e një kornize gjithëpërfshirëse legjislative, interpretimi kombëtar i koncepteve të NGjGjJ-së dhe ARr-së nuk ka evoluar në mënyrë të konsiderueshme drejt tejkalimit të kufijve të moshës dhe promovimit të arsimit dhe të nxënit jokomercial. Numri i ofruesve jofitimprurës të AJF-së, të cilët ofrojnë kurse për zhvillim profesional dhe personal, si dhe edukim për demokraci dhe qytetari, është ende i vogël. Gjatë dekadës së ardhshme, të gjitha palët e interesit duhet të bëjnë përpjekje për të ndërtuar një infrastrukturë solide të ARr-së joformal dhe informal. Duhet të ndërmerren hapa për të zgjeruar fushëveprimin e programeve të AJF-së përveç punësimit dhe masave të tregut të punës, me më shumë shkathtësi të përgjithshme në edukimin financiar dhe digjital, edukimin politik dhe qytetar dhe zhvillimin personal.

Veç kësaj, në ndërtimin e kapaciteteve mund të kontribuojnë edhe bashkëpunimi dhe rrjetëzimi ndërmjet aktorëve të rinj dhe të vendosur në këtë fushë. Mundësimi i ofruesve që të shkëmbejnë praktikat më të mira, mundësitë e financimit dhe përmbajtjen relevante të të nxënit, do t'i forcojnë profilet e ofruesve dhe do të rrisë cilësinë e ofertave të ARr-së. Në mënyrë që të krijohet një treg transparent dhe konkurrues për ofertat e ARr-së në Kosovë, një duhet të vendoset dhe të vihet në dispozicion të qytetarëve regjistër i ofruesve formalë dhe joformalë të ARr-së.

- → Të aktivizohet dhe njihet puna e ofruesve të aktiviteteve joformale dhe informale të NARr-it përmes fushatave të targetuara të vetëdijesimit.
- → Të promovohet bashkëpunimin më i ngushtë mes palëve të interesit dhe formimi i rrjeteve.
- → Të forcohen profilet e ofruesve në arsimin për të rritur dhe të krijohet një regjistër i ofruesve të ARr-së.

Në lidhje me financimin, peisazhi i ofruesve në Kosovë do të përfitonte nga ulja e kufizimeve dhe rritja e transparencës së informacionit. Për ta bërë sektorin e ARr-së në Kosovë të pavarur dhe të qëndrueshëm në planin afatgjatë, shkollave të AAP-së dhe QAP-ve duhet t'u jepet më shumë pavarësi financiare në gjenerimin dhe menaxhimin e të hyrave vetanake. Në mënyrë që të jenë më të qasshme për publikun e gjerë, programet e AJF-së dhe ofruesit e tyre përkatës kanë nevojë për burime të besueshme financimi. Rekomandohet të informohen ofruesit e ARr-së në mënyrë proaktive për mundësitë e financimit kombëtar dhe ndërkombëtar, të cilat mund të rrisin sigurinë e tyre financiare. Kërkohet bashkëpunim dhe shkëmbim më i mirë i burimeve ndërmjet ministrive të ndryshme të përfshira në financimin e ARr-së. Në mbarë vendin, është e nevojshme të ndahet buxhet më i madh nga burimet publike për siguruesit e ARr-së (për shembull në formën e një sistemi të bazuar në kuponë ose bursa për nxënësit e pafavorizuar). Qeveria kombëtare mund ta njohë dhe respektojë angazhimin e jashtëzakonshëm ndaj ofrimit të ARr-së përmes skemave të stimujve tatimorë.

- → Shkollave të AAP-së dhe QAP-ve t'u lejohet më shumë pavarësi financiare në gjenerimin dhe menaxhimin e të ardhurave vetanake.
- → Të komunikohet në mënyrë proaktive me ofruesit e ARr-së me informacion në lidhje me mundësitë e financimit ndërkombëtar.
- → Të monitorohen dhe koordinohen shpenzimet publike dhe private për ARr nëpër ministri.
- → Të zvogëlohet pabarazia sociale dhe arsimi për të rritur të bëhet më i qasshëm dhe i përballueshëm për të gjithë, për shembull përmes kuponëve të të nxënit ose bursave për individë dhe stimujve tatimorë për punëdhënësit dhe ofruesit e shërbimeve.

Ky studim tregon se arsimi për të rritur në Kosovë është ende i përqendruar kryesisht në aktivitete e të nxënit formal, të cilat lidhen me mjedisin e punës. Rekomandohet që kur vendosen dhe zbatohen masat e ARr-së t'i jepet më shumë hapësirë zhvillimit të proceseve joformale, informale dhe të vetë-drejtuara. Të rriturit duhet të inkurajohen të marrin përgjegjësi për zhvillimin e tyre personal gjatë gjithë jetës së tyre. Në mënyrë që të promovohet gjithëpërfshirja dhe diversiteti në ARr në Kosovë, duhet të rritet qasja dhe përfshirja aktive e pjesëmarrësve të moshës mesatare dhe të moshuar, grave dhe grupeve të cenueshme. Monitorimi sistematik i përfshirjes dhe motivimit për të marrë pjesë në të gjitha format e ARr-së do të ndihmonte në krijimin e programeve që u përgjigjen nevojave të grupit të targetuar dhe mund të ndihmonin në nxitjen e kërkesës për të nxënit dhe arsimin gjatë gjithë jetës, në veçanti në lidhje me përmbajtjen e të nxënit jo profesional. Mbledhja e rregullt e të dhënave për pjesëmarrjen dhe mospjesëmarrjen duhet të shtrihet përtej numrit të pjesëmarrësve dhe të përfshijë informata në lidhje me sfondin socio-ekonomik (veçanërisht moshën) dhe motivimin personal.

- → Të rritet vetëdijesimi i qytetarëve në lidhje me avantazhet e ARr-së joformale të vazhdueshme për zhvillimin personal, social dhe ekonomik.
- → Të rritet qasja dhe përfshirja aktive në ARr e pjesëmarrësve të moshës mesatare dhe të moshuar, grave dhe grupeve të cenueshme.
- → Të vendoset monitorim i rregullt dhe sistematik i pjesëmarrjes dhe motivimit në të gjitha format e ARr-së, veçanërisht arsimin joformal.

Për ta profesionalizuar mësimdhënien në ARr në të ardhmen, duhet të theksohet më shumë rëndësia e cilësisë së mësimdhënies dhe karakteristikave të veçanta dhe nevojave të nxënësve të rritur. Shpesh aftësimi i mësimdhënësve nuk përfshin një këndvështrim andragogjik që konsideron kërkesa të veçanta për të nxënit e të rriturve. Ofruesit e ARr-së dhe palët e interesit politike duhet të zhvillojnë të kuptuarit e përbashkët të standardeve profesionale dhe etike në mësimdhënien për të rritur, i cili duhet të jetë mjaftueshëm fleksibël për të përfshirë diversitetin e ARr-së dhe kërkesat që rezultojnë për mësimdhënësit dhe trajnerët e ARr-së (p.sh. parakushtet për punësim në QAP). Të kuptuarit e përbashkët të andragogjisë që promovohet në mënyrë aktive nga palët e interesit publike, mund të kontribuojë në profesionalizimin e këtij sektori arsimor dhe të rrisë njohjen publike të vlerës së mësimdhënies për të rriturit.

- → Të zhvillohet të kuptuarit e përbashkët të andragogjisë dhe kompetencave dhe cilësive të dëshiruara të mësimdhënësve të ARr-së.
- → Të zgjerohet disponueshmëria dhe oferta e programeve të aftësimit të arsimtarëve për të rritur, për shembull në universitete ose përmes aftësimeve të bazuara në punë.

Krahasuar me kontributet e huaja në zhvillimin fillestar të AAP-së, mbështetja ndërkombëtare për sektorin e arsimit për të rritur është më pak e targetuar. Donatorët ndërkombëtarë mund të kontribuojnë në një qasje më të unifikuar ndaj ARr-së duke i harmonizuar intervenimet e tyre drejt qëllimeve strategjike kombëtare dhe duke i regjistruar dhe etiketuar qartësisht si programe për të rritur aktivitetet relevante për ARr-në.

- → Të përafrohen projektet ndërkombëtare me qëllimet kombëtare zhvillimore.
- → Të regjistrohen, etiketohen dhe vizualizohen aktivitetet e ARr-së të financuara nga donatorë ndërkombëtarë, veçanërisht nëse ARr është vetëm një aktivitet i pjesshëm në kuadër të një projekti më të madh.

Referencat[183]

1. Alija, R. (2018). Të nxënit e të rriturve në Republikën e Kosovës. http://pro.acs.si/gm2018/doc/Ramadan_Alija_GM2018_Biograd.pdf

2. Aliu, L. (2018). Analiza e Sistemit Arsimor në Kosovë. Prishtinë: Friedrich-Ebert-Stiftung. http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/15185-20190220.pdf

3. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2015). Ligji Nr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 2, 8 janar 2016, Prishtinë. http://www.pppkosova.org/repository/docs/35.%20LAW_NO._05_L-018_ON_STATE_MATURA_EXAM.pdf

4. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2013a) Ligji Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 7, 26 mars 2013, Prishtinë. https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/ligji-per-aftesimin-profesional-2013-eng.pdf

5. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2013b) Ligji Nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 2, 21 janar 2013, Prishtinë. https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/ligji-per-arsimin-dhe-aftesimin-per-te-rritur-ne-republiken-e-kosoves-2013-eng.pdf

6. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2011). Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17, 16 shtator 2011, Prishtinë. https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/03-ligji-per-arsimin-parauniversitar-anglisht.pdf

7. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008). Ligji Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare. https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/11-ligji-kualifikimeve-2008-03-l-060-en.pdf

8. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2005). Ligji Nr. 02/L-24 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur. http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L24_en.pdf

9. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2002). Ligji Nr. 2002/2 për Arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë. Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Nr. 8, 15 dhjetor 2006, Prishtinë. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2428

10. Bertelsmann Stiftung (2018). BTI Raporti i Vendit - Kosova. Gütersloh: Bertelsmann Stiftung. https://bti-project.org/content/en/downloads/reports/country_report_2018_RKS.pdf

[183] Të gjitha vegzat janë qasur më 26 mars, 2021.

11. CEDEFOP (2019). Inventari Evropian i Kosovës në KKK 2018. https://www.cedefop.europa.eu/files/kosovo_-_european_inventory_on_nqf_2018.pdf

12. CEDEFOP (2014). Terminologjia e politikës evropiane për arsimin dhe aftësimin (botimi i 2të). https://www.cedefop.europa.eu/files/4117_en.pdf

13. Danuza, T., Mehmeti, F. & Saqipi, B. (2016). Raporti i Referencës i KEK-ut i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve të Kosovës. https://akkks.rks-gov.net/uploads/kosovo_eqf_referencing_report_2016.pdf

14. Observatori i Punësimit dhe Shkathtësive të Kosovës (2004). Integrimi me Evropën: një strategji e të nxënit të të rriturve për Kosovën (2005 - 2015). http://notes1.etf.europa.eu/WebSite.nsf/Pages/CA-4F86A26D64F516C1256E8D0052D329/$-FILE/SEE_ADULT+LEARNING+STRATEGY_KS_04_EN.pdf

15. Komisioni Evropian (2020). Raporti për Kosovën 2020. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

16. Komisioni Evropian (2017). Vështrim i përgjithshëm i sistemit të arsimit të lartë në Kosovë. https://eacea.ec.europa.eu/sites/eacea-site/files/countryfiche_kosovo_2017_0.pdf

17. Këshilli Evropian (2016) REKOMANDIMI I KËSHILLIT, i 19 dhjetorit 2016 për Drejtimet e Rritjes së Kualifikimeve: Mundësi të reja për të rriturit. https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32016H1224(01)&from=EN

18. Këshilli Evropian (2011). Rezoluta e Këshillit për një agjendë të ripërtërirë evropiane për të nxënit për të rritur. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian C372/1. https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32011G1220(01)&from=EN

19. Këshilli Evropian (2002). REZOLUTA E KËSHILLIT e 27 qershorit 2002 për të nxënit gjatë gjithë jetës. Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane C 163/1. https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2002:163:0001:0003:EN:PDF

20. Eurostat (2020a). Vendet e zgjerimit - statistikat e financave. https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement_countries_-_finance_statistics#Government_deficit_and_debt

21. Eurostat (2020b). Vendet e zgjerimit - statistikat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Enlargement_countries_-_information_and_communication_technology_statistics#Fixed_telephone_lines

22. Eurostat (2020c). Vendet e zgjerimit - statistikat e tregut të punës. https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement_countries_-_labour_market_statistics#Activity_rates

23. Eurostat (2020d). Vendet e zgjerimit - zhvillimet e fundit ekonomike. https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement_countries_-_recent_economic_developments#Gross_domestic_product

24. Eurostat (2020e). Statistikat mbi migracionin, lejet e qëndrimit, shtetësinë dhe azilin për vendet e zgjerimit, botimi 2020. https://ec.europa.eu/eurostat/documents/4031688/10361659/KS-03-20-002-EN-N.pdf/26f0dc16-4a08-2707-f8d5-8b1b84794169?t=1578923591000

25. Eurostat (2016). Manuali i klasifikimit të aktiviteteve të të nxënit (CLA) botimi 2016. https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/7659750/KS-GQ-15-011-EN-N.pdf/978de2eb-5fc9-4447-84d6-d0b5f-7bee723?t=1474530646000

26. Krasniqi, G. (2019). Kosovë. Qendra Ndërkombëtare Suedeze për Demokraci Lokale (ICLD). https://icld.se/app/uploads/2020/02/Kosovo-.pdf

27. Qeveria e Republikës së Kosovës (2019). Procesi i Torinos 2018–2020 Kosova - Raporti Kombëtar. https://openspace.etf.europa.eu/sites/default/files/2019-10/TR-Preport_2019_Kosovo_EN.pdf

28. Qeveria e Republikës së Kosovës (2017). Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021. https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ANG-STRATEGJIA_PËR_PËRFSHIRJEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALI_NË_SHOQËRINË_KOSOVARE_2017-2021.pdf

29. Qeveria e Republikës së Kosovës (2016). Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH). http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf

30. Judah, T. (2019). Fati demografik i Kosovës duket shumë i njohur. Portali Reporting Democracy. https://balkaninsight.com/2019/11/07/kosovos-demographic-destiny-looks-eerily-familiar/

31. Kalldura, H. & Ejupi, B. (2019). Kosova dhe Agjenda 2023: nga retorika politike në veprime konkrete. Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP). https://indep.info/wp-content/uploads/2019/07/SDG_ENG.pdf

32. Kastrati, A. (2016). Roli i arsimit për formimin e identitetit mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës: Zbatimi i qasjes së verbër ndaj dallimeve për vendosjen e regjimit të shtetësisë në një shoqëri multi-kulturore. Gazeta Evropiane e Shkencave Sociale, Edukimit dhe Hulumtimit, 3(1), f. 146-153. http://journals.euser.org/files/articles/ejser_jan_apr_16/Kastrati.pdf

33. Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019a). Anketa e Fuqisë Punëtore 2019. https://ask.rks-gov.net/media/5412/labour-force-survey-2019.pdf

34. Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019b). Rezultatet e anketës mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit 2019. https://ask.rks-gov.net/media/5271/tik-2019-ang.pdf

35. Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018). Statistikat e Arsimit në Kosovë. https://ask.rks-gov.net/media/4146/stat-e-arsimir-2017-2018ang.pdf

36. Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF-i (2014). 2013-2014 Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë* Anketa e Grupimeve me Tregues të Shumëfishtë, Raport Përmbledhës. https://mics-surveys-prod.s3.amazonaws.com/MICS5/Europe%20and%20Central%20Asia/Kosovo%20under%20UNSC%20res.%201244%20%28Roma%2C%20Ashkali%2C%20and%20Egyptian%20Communities%29/2013-2014/Summary/Kosovo%20%28UNSCR%201244%29%20%28Roma%2C%20Ashkali%2C%20and%20Egyptians%29%202013-14%20MICS%20Summary_English.pdf

37. Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011). Treguesit kryesorë të arsimit 2011. https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/askdata__Census%20population__Census%202011__1%20Summary%20tables/2%20census35.px/?rxid=6c75a9aa-627c-48c6-ae74-9e1b95a9c47d

38. Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF-i (2020). Anketa e Grupimeve me Tregues të Shumëfishtë 2019-2020, Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë, Raporti i Gjetjeve të Anketës. Prishtinë: UNICEF. https://mics-surveys-prod.s3.amazonaws.com/MICS6/Europe%20and%20Central%20Asia/Kosovo%20under%20UNSC%20res.%201244%20%28Roma%2C%20Ashkali%2C%20and%20Egyptian%20Communities%29/2019-2020/Survey%20findings/Kosovo%20%28UNSCR%201244%29%20%28National%20and%20Roma%2C%20Ashkali%20and%20Egyptian%20Communities%29%202019-20%20MICS-SFR_English.pdf

39. Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Banka Botërore (2019). Varfëria e Konsumit në Republikën e Kosovës. https://ask.rks-gov.net/media/4901/poverty-statistics-2012-2017.pdf

40. Lattke, S. & Strauch, A. (2019). Kompetencave për arsimtarët për të rritur në mësimdhënien e GCED, Instituti i UNESCO-s për të Nxënit Gjatë Gjithë Jetës; UNESCO Qendra Azi-Paqësor e Arsimit për Mirëkuptimin Ndërkombëtar. https://uil.unesco.org/sites/default/files/doc/adult-education/competencyframework.pdf

41. Likaj, R. (2019). Zhvillimi i vazhdueshëm profesional për mësimdhënësit profesionalë dhe drejtorët në Kosovë 2018. Fondacioni Evropian për Trajnime. https://openspace.etf.europa.eu/sites/default/files/2020-01/Kosovo%20CPD%20survey%202018_rev.pdf

42. Likaj, R. (2016). Zhvillimi i vazhdueshëm profesional për mësimdhënësit dhe trajnerët profesionalë në Kosovë. Fondacioni Evropian për Trajnime. https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/m/484071EDB588DA0CC1257FCD005FB852_CPD%20Kosovo.pdf

43. Likaj, R., Danuza, T., Jaha, A. & Kadiru, B. (2015). Sfidat dhe arritjet në arsimin për të rritur në Kosovë. http://pro.acs.si/documents/gm2015/pdf/GM2015_dr_Rame_Likaj.pdf

44. Llapi, G. & Peterson, C. (2015). Arsimi i ndërprerë: Kosova 1980-1999. Punim i prezantuar në Para-Konferencën Ndërkombëtare (të 64-t, Oklahoma City, OK, 15-17 nëntor 2015) të Komisionit për Arsimin Ndërkombëtar për të Rritur (CIAE). https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED570511.pdf

45. Llunji, V. (2013). Sfidat e arsimit për të rritur në Kosovë. https://core.ac.uk/download/pdf/143966298.pdf

46. Mavrak, M. (2018). Programi i Socializimit Ligjor - Manual për Arsimin për të Rritur. PH international: Sarajevë.

47. Mehmetaj, M. & Likaj, R. (2017). Raporti i hulumtimit. Vlerësimi i Praktikave në Zbatimin e Programeve të Arsimit për të Rritur në Qendrat e Aftësimit Profesional. https://www.dvv-international.ge/fileadmin/files/caucasus-turkey/Kosovo/Resources/RESEARCH_RAPORT-MPMS-DVV-Verzioni_Final_eng.docx

48. Mehmeti, S., Boshtrakaj, L. & Mehmeti, F. (2019). Vlerësimi Afatmesëm: Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017 - 2021 Prishtinë: KEEN. http://kosovoprojects.eu/wp-content/uploads/2020/02/Implementation-of-Kosovo-Education-Strategic-Plan.pdf

49. Mehmeti, S., Rraci, E. & Bajrami, K. (2019). Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë. Prishtinë: KEEN, https://www.keen-ks.net/site/assets/files/1467/zhvillimi_profesional_i_mesimdhenesve_ne_kosove_eng.pdf

50. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (2019). Strategjia për Rininë 2019-2023. https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Strategy_for_Youth_2019-2023.pdf

51. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2016). Plani Strategjik i Arsimit i Kosovës 2017-2021. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/KOSOVO_EDUCATION_STRATEGIC_PLAN.pdf

52. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2015). Raporti i Vlerësimit – Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016. https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/02/raport-vleresimi-psak-2011-2016-eng-web.pdf

53. Ministria e Financave dhe Transfereve (2019). Buletini Vjetor 2019 për Borxhin Publik. https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FA8401C2-A349-4490-B3AA-829465182EEB.pdf

54. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (2017). Plani i Veprimit: Rritja e Punësimit të të Rinjve 2018-2020. https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/08/Plani-i-Veprimit_Punesimi-i-te-Rinjeve_ENG-1.pdf

55. Möllers, J., Traikova, D., Herzfeld, T., & Bajrami, E. (2017). Studim mbi migracionin rurale dhe migracionin e kthimit në Kosovë, Punim Diskutimi, 166. Halle (Saale): Instituti Leibniz i Zhvillimit Bujqësor në Ekonomitë në Tranzicion (IAMO). https://www.econstor.eu/bitstream/10419/168315/1/896161803.pdf

56. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (2020). Korniza Kombëtare e Kualifikimeve. https://akkks.rks-gov.net/uploads/national_qualification_framework_handbook_2020.pdf

57. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (2018). Udhëzime dhe Programi për Njohjen e Koordinatorëve, Mentorëve dhe Vlerësuesve të të Nxënit Paraprak. https://www.dvv-international.ge/fileadmin/files/caucasus-turkey/Kosovo/Resources/AKK-Udhzuesi-Eng__3_.pdf

58. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (2017). Politikat dhe procedurat për njohjen e të nxënit paraprak (NjNP) në Republikën e Kosovës. https://akkks.rks-gov.net/uploads/policy_and_procedures_for_recognition_of_prior_learning_rpl.pdf

59. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (2011). Zhvillimi dhe Verifikimi i Standardeve Profesionale. https://akkks.rks-gov.net/uploads/developing_and_verifying_occupational_standards.pdf

60. OECD (2020). Vlerësimet e homologëve të bashkëpunimit për zhvillim nga OECD-ja: Austria 2020 - vizitë në terren në Kosovë. https://read.oecd-ilibrary.org/development/oecd-development-co-operation-peer-reviews-austria-2020_c3aef350-en#page1

61. OECD (2019). Rezultatet e PISA 2018 - Përmbledhje të Kombinuara Ekzekutive. https://www.oecd.org/pisa/Combined_Executive_Summaries_PISA_2018.pdf

62. Qehaja, L. (2019). Zbatimi i Strategjisë Sektoriale të MPMS-së në vitet 2018 dhe 2019 - Raporti i Vlerësimit Afatmesëm. Prishtinë: KEEN. http://kosovoprojects.eu/wp-content/uploads/2020/02/Implementation-of-MLSW-Sectorial-Strategy-in-2018-and-2019.pdf

63. Quirezi, B. (2015). Emigrimi nga Kosova i vitit 2015 drejt Bashkimit Evropian: kush, pse dhe si. Prishtinë: Friedrich-Ebert-Stiftung. https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/13857.pdf

64. Riinvest (2021). Anketa për Arsimin për të Rritur në Kosovë (drafti), prill 2021. E papublikuar.

65. Schweighöfer, B. (2019). Arsimi për të Rinjtë dhe të Rritur në Agjendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Bon: DVV International. http://www.anc.edu.ro/wp-content/uploads/2021/02/DVV19002_Studie_SDG_WEB.pdf

66. UNDP (2016). Raporti për Zhvillimin Njerëzor të Kosovës 2016. http://hdr.undp.org/sites/default/files/human_development_report_2016.pdf

67. UNESCO UIL (2016). Raporti i 3të Global për të Nxënit dhe Arsimin për të Rritur. https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000245913

68. UNESCO UIL (2015). Rekomandimi për të Nxënit dhe Arsimin për të Rritur. https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000245179

69. UNESCO UIL (2014). Alfabetizmi dhe shkathtësitë bazë si themel për të nxënit gjatë gjithë jetës. http://www.ngo-unesco.net/en/pdf/PPP_UIL.pdf

70. UNESCO UIL (2012). Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit ISCED 2011. http://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-isced-2011-en.pdf

71. UNHCR (2019). Fakte për Kosovën. https://www.unhcr.org/see/wp-content/uploads/sites/57/2019/05/Fact-sheet-Kosovo-9-May-2019.pdf

72. UNHCR (2018). Profilizimi i Personave të Zhvendosur Brenda Kosovës. https://www.unhcr.org/see/wp-content/uploads/sites/57/2018/11/UNHCR_KOS_Profiling_English_Pages.pdf

73. Misioni i OKB-së në Kosovë (1999). Rezoluta e Kombeve të Bashkuara 1244. https://unmik.unmissions.org/united-nations-resolution-1244

74. Viertel, E. (2019). Politikat për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor në Kosovë - Vlerësimi i Procesit të ETF të Torinos. https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2020-03/04_trp_etf_assessment_2019_kosovo_160320.pdf

75. Banka Botërore (2020). Perspektiva Makro e Varfërisë Kosovë tetor 2020. http://pubdocs.worldbank.org/en/993701492011106034/mpo-ksv.pdf

76. Banka Botërore (2019). Raporti i Vendit për Kosovën 2019: Gjetjet nga anketa e shkathtësive drejt punësimit dhe produktivitetit. Uashington, DC: Banka Botërore. http://documents1.worldbank.org/curated/en/209751557432399449/pdf/Kosovo-Country-Report-Findings-from-the-Skills-towards-Employment-and-Productivity-Survey.pdf

77. Banka Botërore (2018). Nëse Kosova vepron tani, fëmijët e saj të lindur sot mund të jenë më të shëndetshëm, më të pasur, më produktivë. Njoftim për Shtyp, 11 tetor 2018. https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2018/10/11/if-kosovo-acts-now-its-children-born-today-could-be-healthier-wealthier-more-productive

78. Banka Botërore (2017). Republika e Kosovës Diagnostikimi Sistematik i Vendit. https://elibrary.worldbank.org/doi/pdf/10.1596/26573

79. Zymberi, F. et al. (2018). Analizë dhe hulumtim për kualifikimet e arsimit të nivelit 5 në shkollat e AAP-së në Republikën e Kosovës. https://www.google.com/url?sa=t&rct=-j&q=&esrc=s&source=web&cd=&ved=2ahUKEwia78-dq8nvA-hUyM-wKHVa-D1wQFjAAegQIBRAD&url=http%3A%2F%2Fwww.dvv-international.ge%2Ffileadmin%2F-files%2Fcaucasus-turkey%2FKosovo%-2FResources%2FResearch_-_Level_5_of_qualifications_in_vocational_secondary_schools_in_Kosovo.docx&usg=AOvVaw3D82LaVRIgbHDSMcbCmaGt